



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Shkenca Kompjuterike”

Universiteti Polis

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Elson AGASTRA

Dr. Elior VILA

Elson Agastra
Elior Vila

Shtator / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Polis
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kërkimit Shkencor
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në " Shkenca Kompjuterike "
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 815, datë 21.12.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 8 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 18 studentë; 2020-2021 34 studentë; 2021-2022 60 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "POLIS" është një institucion privat i arsimit të lartë i krijuar si person juridik me vendim gjykatë Nr. 35386, datë 04.04.2006, licensuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 698, datë 11.10.2006, akredituar për herë të parë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 227, datë 22.07.2009 dhe akredituar periodikisht me vendimin e fundit të Bordit të Akreditimit Nr. 113, datë 15.12.2017 me afat vlefshmërie deri më 14.12.2023.

Për të siguruar respektimin e plotë të dispozitave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statuti Universitetit POLIS është miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit POLIS me Nr. 13, datë 13.06.2016 dhe është aprovuar bazuar në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 281, datë 19.05.2017. Misioni dhe vizioni i Universitetit "POLIS" është që të jetë një institucion ekselent në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencor të aftë për të adresuar nevojat e tregu dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij.

Aktualisht Universiteti POLIS përbëhet nga tre njësi kryesore dhe secili prej tyre ka tre njësi bazë të organizuara si në vijim [Aneks 53 Organigrama_POLIS 2021-2022]:

Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn, që përbëhet nga:

- Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri;
- Departamenti Art dhe Dizajn;
- Qendra kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn.

Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, që përbëhet nga:

- Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban;
- Departamenti i Mjedisit;
- Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë.

Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim, që përbëhet nga:

- Departamenti i Kërkimit Shkencor;
- Departamenti i Kërkimit të Aplikuar;
- Qendra e Burimeve dhe Informacionit.

Programi i studimit i ciklit të parë, Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", në Universitetin "POLIS" ofrohet nga njësi bazë, Departamenti i Kërkimit Shkencor, pjesë integrale e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim. Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë në fuqi, programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është hapur bazuar në Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 815, datë 21.12.2018 për "Hapjen e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike në Universitetin POLIS" dhe ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2019-2020. Qëllimi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është që të ofrojë mundësinë e kualifikimit dhe zotërimin e disiplinës së shkencave kompjuterike duke u siguruar studentëve një sfond të mjaftueshëm akademik dhe shkencor për të vijuar më tej studimet dhe thellimin e njohurive në programe të njëjta ose të ngjashme të cikleve të tjera.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”.

Bazuar në Urdhrin Nr. 4, datë 14. 01. 2022, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, për procesin e akreditimit e programeve, Universiteti “POLIS”, grupi i vlerësimit përbëhet nga: Prof. Asoc. Elson Agastra, dhe Dr. Elior Vila. Gjatë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Janar 2022 nga Universiteti POLIS. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti i “POLIS”, për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti “POLIS”, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 për “Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 ‘Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

GVJ së bashku me koordinatoren e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli, vizitoi Universitetin POLIS në datat 21 dhe 22 Shkurt 2022. GVJ zhvilloi diskutime me Rektoren, Zv Rektoret dhe Dekanin e Fakultetit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJBSC), stafin akademik të Departamentit si dhe me pedagogë të angazhuar në programin e studimit. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat leksionëve dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. GVJ, në shkrimin e raportit dhe kërkesat specifike të secilit prej standardeve dhe kriterëve, ka përdorur të dhëna të marra nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe i korreluar me takimet gjatë vizitës. Për të njëjtat çështje, pjesë e standardeve, GVJ ka marrë informacion nga më shumë se një takim. Si shembull, në lidhje me mbështetjen e stafit për kërkimin shkencor, si të dhëna janë marrë jo vetëm ato të ofruara nga organet drejtuese, por edhe nga takimi me stafin akademik dhe njëkohësisht edhe evidencat e vëna në dispozicion në DVV. E njëjta procedurë është ndjekur për të gjitha kriteret për të qenë objektiv në hartimin e raportit dhe vlerësimin e përmbushjes së standardeve. Normalisht, aty ku të dhënat përputhen

mes burimeve të ndryshme, ato janë përmendur pozitivisht. Aty ku të dhënat, për të njëjtën çështje, të marra nga burime të ndryshme brenda institucionit, nuk përputhen, GVJ i ka cituar të gjitha informacionet, duke vënë në dukje faktin që këto të dhëna nuk rakordojnë mes tyre.

Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti Polis është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.07.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 45/16 Prot, datë 12.07.2022. Universiteti Polis përcjell në ASCAL më datë 22.07.2022, me anë të shkresës me Nr. 548 Prot, datë 22.07.2022, "Komentet lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm".

GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit "POLIS" për secilin prej standardve, sqaron si më poshtë:

Shënim:

RVJ është një dokument publik, i hartuar për vlerësimin e programit të studimit dhe jo të emrave të përveçëm të aktorëve të përfshirë në këtë program studimi. Ne si GVJ, për të ruajtur etikën e hartimit të raportit, nuk përmendim emra të përveçëm të stafit akademik, ndihmës akademik apo administrativ, sikurse emra të përveçëm të aktorëve të tjerë të nevojshëm për të argumentuar komentet përkatëse. Megjithatë, për të qartësuar institucionin, aty ku është e nevojshme, dhe pa përdorur emër të përveçëm, do të përdorim në komentet më poshtë emërtime si "pedagogu X", ku "X" është numri rendor i përdorur nga institucioni në hartimin e tabelës 4 në RVB dhe e paraqitur në "Aneks 25 Tabela me ngarkesën e stafit Bsc. ShK". Në këtë mënyrë, institucioni mund të kontrollojë korrektësinë e përgjigjeve të hartuara nga GVJ, nëse lind e nevojshme për të verifikuar përgjigjet e paraqitura.

Koment i Universitetit POLIS:


Standardi 1

OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

- **Standardi I.3, Kriteri 2:**

a) GVJ citon: "Aneks 16 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit", që duhej të përmbante këtë informacion, në të vërtetë paraqet objektivat formuese të programit të studimit, si dhe strukturat akademike përgjegjëse. Në të nuk është paraqitur asnjë studim tregu apo të dhëna statistikore në lidhje me kërkesën e punëdhënësve të ndryshëm për specialist të formuar në këtë program studimi".

Programi është licensuar në përputhje me kërkesat e udhëzimit përkatës për hapjen dhe riorganizimin e programeve të reja dhe miratuar nga MAS në (2018). Pjese e procesit të vlerësimit dhe licencimit nga MAS është edhe studimi i tregut të punës. Dhe me gjithë zhvillimin e shpejtë të kësaj fushë, kjo nuk e zhvlerëson informacionin e dorëzuar në momentin



e aplikimit. Për më tepër si një institucion me eksperience dhe bashkëpunime të ngushta me aktore të kategorive të ndryshme vendase dhe të huaja (institucione shtetërore, organizata, kompani, institucione homologe, etj) na bën të jemi vigjilentë si dhe ti kushtojmë rëndësi marrjes së feedback-ut që vjen nga drejtime të ndryshme të tregut të punës. Kjo metodologji e fituar me programet të cilat ofrohen nga POLIS për më shumë se 15 vjet aplikohet edhe për programin Shkenca Kompjuterike. Si një institucion privat, ne jemi të interesuar që të ofrojmë edukim relevant për tregun, jo vetëm për të përmbushur standardet e cilësisë dhe kërkesat e organeve monitoruese por për të përmbushur kërkesat e brendshme të institucionit për të ofruar programe të qëndrueshme (nga pikëpamja e impaktit por dhe asaj financiare).

Përgjigje e GVJ:

Komenti i cituar më sipër, i referohet mungesës së dokumentacionit në DVV. Kujtojmë se dosja e vetë vlerësimit dhe dokumentacionet në të janë të përgatitur dhe të paraqitur nga vetë U_POLIS për vlerësimin e jashtëm. Ne si GVJ, nuk e paragjykojmë institucionin dhe mënyrën e tij të menaxhimit. Megjithatë, në DVV nuk është paraqitur një dokument që në përmbajtje të ketë informacion rreth studimit të tregut përpara hapjes së këtij programi. Kjo pavarësisht, se dokumenti "**Aneks 16 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit**", nga emërtimi duket sikur përmban këtë informacion, në realitet paraqet tjetër informacion.

Në komentin më sipër, institucioni pretendon se e ka dorëzuar këtë dokumentacion në momentin e aplikimit për hapjen e këtij programi në ministrinë përgjegjëse për arsimin, por GVJ dhe ASCAL, nuk kanë qasje në dokumentacionin e dorëzuar në ministri në momentin e hapjes, prandaj kërkohet që ky dokumentacion të vihej në dispozicion në dosjen e vlerësimit të jashtëm. Institucioni duhej të kontrollonte përmbajtjen e dokumentacionit të paraqitur përpara vënies në dispozicion për vlerësimin e jashtëm. Megjithatë, edhe gjatë vizitës, Ju kërkua disa herë ta rishikonin në tërësi dokumentacionin e paraqitur në DVV, pasi kishte mospërputhje të emërtimeve të dokumentacioneve me përmbajtjen e tyre. *(shih përgjigjen e GVJ për Standardin I.5, Kriteri 3 në vijim)*

Mospërputhje, që një pjesë Ju vunë në dukje gjatë vizitës, dhe u korrigjuan, por jo të gjitha, sikurse e vërteton edhe mungesa e këtij dokumentacioni apo të tjera pasaktësi, të cila janë cituar edhe nga GVJ në "Standardit VI . Sigurimi i cilësisë së programit të studimit".

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës. Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

b) GVJ citon: "*Kryesisht, takimet janë të fokusuar në kompani apo punëdhënës të lidhur ngushtësisht me fushën e arkitekturës, inxhinierisë së mjedisit apo ndërtimit dhe planifikimit urban*"

Bazuar në llojshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit që universiteti disponon, vërtetojmë se, gama e kompanive/punëdhënësve me të cilët U_POLIS ndërvepron është në përputhje me strategjinë ndërdisiplinore të Fakultetit Kërkim për Zhvillim, si nga pikëpamja e fokusit profesional ashtu edhe e peshës në tregun e produkteve dhe/ose shërbimeve të TIK duke i dhënë fryme modelit të studimit multidisiplinar, e cila edhe në Strategjinë e Ministrisë së Arsimit dhe

Sporteve 2021-2026 konstatohet si një pikë e dobët, pasi siç përcaktohet në këtë të fundit "ka një numër fare të vogël të programeve të studimit ndërdisiplinore, duke mos reflektuar nevojat që ka tregu i punës".

Përgjigje e GVJ:

Institucioni ka hequr nga konteksti frazën e më sipërme: Ajo i referohet takimit me përfaqësues të zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës.

Përfaqësuesit e kësaj zyre, janë personel akademik të U_POLIS, dhe fusha e tyre akademike ishte pikërisht në fushën e "arkitekturës, inxhinierisë së mjedisit apo ndërtimit dhe planifikimit urban", fushë të cilën e njihnin shumë mirë për mbështetjen e studentëve. Takimi me këtë zyrë, u zhvillua paralelisht me një tjetër grup të vlerësimit të jashtëm, po i udhëhequr nga ASCAL, që po vlerësonte një program studimi në fushën e Arkitekturës. Për këtë qëllim, i sugjerojmë institucionit, që për çdo paqartësi apo rezervë të shprehur për punën e GVJ të këtij programi studimi, të mund të shikojë shënimet e mbajtura nga të dy përfaqësuesit e ASCAL në këtë takim. Megjithatë e përmbledhur thelbi i këtij takimi si vijon:

Disa prej diskutimeve me përfaqësuesit e kësaj zyre, të cilat çuan GVJ të hartojë komentin e cituar nga U_POLIS janë:

- Gjatë takimit me këtë zyrë, dhe pyetjeve rreth këshillimit të karrierës për studentët e profilit "Shkenca Kompjuterike",
 - o Kjo zyrë nuk ishte në gjende të jepte informacion përtej faktit se ky program nuk ka akoma një brez studentësh të diplomuar.
 - o Kjo zyrë, nuk ishte në gjendje të jepte më shumë informacion rreth këshillimit të karrierës për këtë program studimi, dhe shtoi se janë pedagogët e këtij programi studimi që janë më afër me studentët dhe ata i këshillojnë më shumë
 - Këtu, ndërhyrja e GVJ të këtij programi, por e plotësuar edhe nga anëtarët e GVJ të programit tjetër me të cilët ky takim u zhvillua paralelisht ishte. I gjithë personeli i institucionit, patjetër që angazhohet në mbështetje të studentëve, por kjo nuk zëvendëson rolin e zyrës të dedikuar për këtë qëllim.
- Rreth pyetjes nëse kjo zyrë mbledh apo përpunon të dhëna rreth nevojave të tregut të punës për këtë profil studimi pasi bazohet pikërisht në këshillimin e karrierës?
 - o Përgjigja ishte se kjo zyrë nuk ka një informacion të tillë. Megjithatë, bazuar edhe në bashkëpunimet që U_POLIS ka me kompani/punëdhënës, kjo fushë studimi është shumë e kërkuar.
 - o Përfaqësuesit e kësaj zyre përmendën dy kompani kombëtare, që në takimet që zhvillojnë me U_POLIS, paraqesin nevojat e tyre për formimin e studentëve të këtij profili. (Emërimet e kompanive të përmendura janë ato me indeksin 3 dhe 9 në "Aneks 32 Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit".
 - Në këtë pikë, ne si GVJ, duke qenë edhe njohës të tregut të punës në këtë fushë, si nga ana akademike ashtu edhe ajo profesionale, vumë në dukje, se profili i kompanive të përmendura prej tyre, është në një profil shumë specifik dhe të ngushtë të ciklit të studimeve në "Shkenca Kompjuterike". Pra nevojat e këtyre kompanive për specialist, realisht nuk paraqesin tregun kombëtar/ndërkombëtar për specialist të këtij programi studimi. Ato paraqesin vetëm një kërkesë shumë specifike për nevojat e tyre për specialist në fushën e IT.

Pra, e vërtetuar me fakte në takimin me këtë zyrë, dhe jo opinione të GVJ, zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, nuk ka njohje të profilit të këtij programi studimi.

Duke qenë se ky takim u zhvillua paralelisht me përfaqësuesit e kësaj zyre, së bashku me përfaqësues të ASCAL dhe një GVJ për një program në fushën e Arkitekturës, ne si GVJ, ndoqëm edhe të njëjtat diskutime për programin tjetër. Diskutimet me GVJ (Grupi tjetër paralel) për programin në fushën e Arkitekturës, përgjigjet e përfaqësuesve të U_POLIS tregonin një mirëfunksionim në fushën e arkitekturës, inxhinierisë së mjedisit apo ndërtimit dhe planifikimit urban.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh.

Përgjigje rreth komentit të U_POLIS për profilin ndërdisiplinor:

- Profili ndërdisiplinor i ndjekur në tërësi nga institucioni POLIS, është kuptuar nga GVJ dhe e gryojmë shumë pozitive, në veçanti edhe hartimin e qendrës “*Innovation Factory*” me profil ndërdisiplinor. Ku njohuritë e studentëve të këtij programi studimi, gërshetohen me ato të profileve të tjera të institucionit duke ngritur grupe pune të përbashkëta. Në këtë kontekst, programi i studimit bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është komplementar në njohuri me ato të ofruara nga programe të tjera, çka ne e vlerësojmë shumë pozitive, dhe e kemi përmendur edhe në raport dhe përgëzuar institucionin gjatë vizitës.
- Pikërisht, në këtë rol komplementar, programi i studimi duhet të analizohet me shumë kujdes nga institucioni për të evituar që kërkesa specifike të një profili ndërdisiplinor (si gjuha e programimit “R”) të diktojnë formimin e të gjithë programit. Kjo pikë, duhet të shikohet me kujdes, pasi rrezikon që kërkesat e një punonjësi specifik të diktojnë modifikime të programit të studimit, duke devijuar formimin nga profil “bachelor”, drejt një profili profesional.

Komente të përgjithshme, që vlejné për hartimin e të gjithë raportit:

- Pyetjes se a i përgjigjet ky program studimi nevojave të tregut të punës, dhe se si nevojat e tregut reflektohen në këtë program, nëse është e nevojshme, nuk u diskutuan vetëm në takimin me zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, ato u diskutuan edhe gjatë takimeve të tjera në institucionin. Në veçanti me drejtuesin e njësisë bazë dhe me drejtuesin e njësisë kryesore, koordinatorin e programit të studimit por edhe në takimin me stafin akademik, që përfshinte staf me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme të angazhuar në këtë program studimi.
- Diskutimet janë realizuar për të kuptuar realisht se si institucioni vepron për këtë pikë, dhe ne si GVJ, të mos bazonim raportin tonë në vetëm përgjigjet e specialistëve të një zyre të caktuar.
- Kjo praktikë është ndjekur për të gjitha argumentet e trajtuar gjete vizitës, dhe jo vetëm për këtë standard (shih përgjigjet e komenteve në vijim).

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

**Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh.
RVJ nuk ndryshon**

Koment i Universitetit POLIS:

c) GVJ citon: "Gjatë takimit me organet drejtuese të njësisë kryesore dhe asaj bazë, përgjegjëse për programin e studimit, si dhe me koordinatorin e programit të studimit, u vu re, se kishin një njohje të ulet, dhe jo të plate të programit të studimit, kërkesave dhe nevojave të tregut në lidhje me këtë fushë" si dhe "Njohje jo e plotë e fushës së programit të studimit, vërehej edhe në interpretimin e nevojave të tregut të punës bazuar vetëm në sugjerime apo nevoja të disa prej punëdhënësve, të cilat pasqyrohen si nevoja globale për të diktuar ndryshimet e planeve mësimore".

Sa i përket faktit që formimi i Dekanit dhe Drejtuesit të Departamentit nuk përkon plotësisht me fushën e programit të studimit, dëshirojmë te theksojmë se kjo vjen si pasoje e qasjes ndërdisiplinore të fakultetit ofruar të programit siç u shpjegua më sipër. Për më tepër përgjegjësia për aspektet përmbajtjesore të programit qëndron me koordinatorin e programit të studimit që është staf akademik me përvojë në këtë fushë. Gjykojmë gjithashtu që kjo pikë është tërësisht subjektive për sa kohe parashtrohet në formën e një konstatimi pa ofruar argumente mbështetës siç mund të ishin psh elementet përbërës të kurrikulës dhe/ose niveli i punësimit të të diplomuarve (përkundrazi, raportojmë se 16/16 studentet që sapo mbyllën programin e studimit janë tashme të punësuar).

Përgjigje e GVJ:

Bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, dhe në veçanti, Neni 23, pika 1: citojmë:

[...]

1. Fakulteti është njësi kryesore që bashkë-rendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë.

[...]

Bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, dhe në veçanti, Neni 25, pika 1 dhe 2: citojmë:

[...]

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.

2. Departamenti mund të krijohet edhe nga fakultete të ndryshme të një IAL-je për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor. Në këto raste, funksionimi dhe varësia e këtij departamenti përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Ky departament nuk merret në konsideratë, për efekt të përmbushjes së standardeve të institucionit.

...]

Për sa më sipër, programi i studimit “Shkenca Kompjuterike” ofrohet në një njësi kryesore (Fakultet) me qasje ndërdisiplinore, dhe OK. Por formimi i këtij programi studimi është me karakter specifik dhe ofrohet në një njësi bazë (departament) i cili **duhet të përfshijë fusha kërkimore të përafërta** dhe grupon disiplinat mësimore respektive.

Në rastin konkret, departamenti ofron dy programe studimi që nuk janë të përafërta:

1. Bachelor në Shkenca Kompjuterike
2. Doktraturë në Arkitekturë

Kjo ishte një nga diskutimet e para të zhvilluara me drejtuesit e fakultetit dhe departamentit, pra si kjo njësi bazë koordinon zhvillimin e këtyre dy programeve të studimit që janë objektivisht shumë të ndryshme mes tyre.

Megjithatë, nuk është objekt i këtij GVJ të vlerësojë njësinë bazë dhe atë kryesore, pasi kjo është pjesë e vlerësimit institucional. Megjithatë, lutemi të rishikoni edhe një herë RVJ në Standardin I.4. Por ofrimi i programeve jo të përafërta dhe formimit të drejtuesve të departamentit dhe fakultetit, rezulton në gjetjet e paraqitura në raport. Megjithatë, për të qartësuar edhe më tej institucionin, Ju lutem, gjeni shpjegimet më poshtë.

- Edhe pse e kuptojmë pozicionin e U_POLIS dhe përkushtimin e tij në ngritjen e këtij programi studimi, e gyojmë të pa vend komentin më mësipërm rreth subjektivitetit të GVJ në hartimin e raportit. Për këtë qëllim, Ju lutem shikoni shënimet në vizitë të mbajtura nga koordinatori institucional i ASCAL, shënime të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqesin bisedimet me të gjithë aktorët në U_POLIS gjatë vizitës dy ditore të GVJ.
- Komenti rreth subjektivitetit të raportit të hartuar nga GVJ, për këtë çështje, nuk është bazuar mbi punësimin e studentëve, të cilët në periudhën e vizitës në institucion ishin akoma duke zhvilluar semestrin e dytë të vitit të fundit, madje nuk kishin zhvilluar akoma praktikën mësimore
- Bisedimet me drejtuesit, kanë qenë të fokusuar mbi përmbajtjen e programit, syllabuset e lëndëve, procedurave që ndiqen për ndryshime, praktikat e studentëve etj.
- Gjatë këtyre takimeve, drejtuesit nuk kanë mundur të qartësojnë zgjidhjet dhe zgjedhjet e bëra në hapjen e këtij programi studimi apo nevojat për ndryshime në të, apo të sqarojnë objektiva e zhvillimit afatmesëm të këtij programi. Përmendim këtu pyetjen përse nuk ka të parashikuara aktivitete laboratorike në planin mësimor. Dhe përgjigja është, kështu kanë sugjeruar ekspert të jashtëm.

Pyetje të ngjashme rreth nevojës për modifikimin e planit mësimor, nga drejtuesi i njësisë bazë dhe asaj kryesore i përgjigjen se: gjykohen nga koordinatori i programit të studimit ose ekspert të jashtëm kur është e nevojshme.

- Koordinator i programit të studimit, staf akademik me kohë të plotë në institucion dhe me formim në fushë të këtij programi studimi (pedagogu 3), eksperiencia e tij është shumë e kufizuar. Koordinator është me gradën Master i Shkencave, të fituar në shtator 2017. Ka një eksperiencë didaktike rreth 1.5 vite në një institucion tjetër të arsimit të lartë (tetor 2017 – maj 2019), ku gjatë kësaj periudhe ka qenë i angazhuar edhe në kompani si inxhinier (*referencë CV e pedagogut 3*).

- Në Maj 2019 bëhet pjesë e stafit të U_POLIS. (*referencë CV e pedagogut 3 të paraqitur në DVV*), ku në këtë periudhë U_POLIS (e përmendur edhe në komentet vijuese nga vet U_POLIS), nuk ka patur të angazhuar një numër të lartë të personelit akademik me formim në fushë specifike të këtij programi studimi, nga ku të mund të përftonte përvojë.
 - o Për sa më sipër, “përvoja” e koordinatorit, edhe pse është me formimin në fushën specifike të këtij programi studimi (Inxhinier Telekomunikacioni), eksperiencia e tij është e ulët, sikurse e kemi paraqitur edhe në standardin I.4, kriteri 1. Roli i tij, edhe bazuar në ligjin 80/2015, në të gjithë aktivitetin didaktik, mund të jetë (ketë qenë) vetëm Asistent Lektor, por kjo gjë nuk ka rezultuar pranë U_POLIS, i cili e ka angazhuar edhe si Lektor (*referencë Tabela 12.1*), ku për lëndën ku është angazhuar ky pedagog, nuk ka patur të angazhuar asnjë pedagog tjetër (sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga U_POLIS), çka rezulton se të gjithë aktivitetin didaktik, Leksione/Seminare etj., janë mbuluar vetëm nga ky pedagog (*shih përgjigjet në komentet në vijim*).
 - o Megjithatë ne si GVJ, e vlerësojmë pozitivisht përkushtimin e koordinatorit, pasi sikurse U_POLIS e paraqet në komentin më sipër, por edhe ne si GVJ e kemi paraqitur në Standardin VI.2, kriteri 2 ku citojmë [*...Gjatë vizitës në institucion u vu re, se koordinatori i këtij programi studimi kishte një njohje të mirë të aktiviteteve didaktike, administrative të lidhura me këtë program studimi...*]
 - o Eksperiencia e ulët e koordinatorit, nuk i mundëson një vlerësim tërësor dhe objektiv të ndryshimeve të propozuara.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës. Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh.

RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

d) GVJ citon: "*kërkesat e një punëdhënësi specifik, për formime të caktuara në fushën e shkencave kompjuterike, bazuar në nevojat specifike të atij punëdhënësi, nuk duhet të konsiderohen si nevoja globale për të diktuar ndryshime kurrikulare, përveçse rasteve kur ato nevoja përkohë me studime më të thelluara të tregut të punës dhe me objektivat formuese të vet programit"*

Theksojmë se, U_POLIS ka marrëdhënie të ngushte me disa kompani sipas listës së ofruar në anekset 32 dhe 34 i RVB-se. Këto marrëveshje mund të ishin kontrolluar nga ekspertët gjatë vizitës në institucion, por po i sjellim sërish si dokumentacion mbështetës bashkëlidhur kësaj shkrese.

Në RVB për efekt ilustrimi kemi përmendur një prej tyre, dhe kjo nuk nënkupton që kemi plotësuar kërkesën e vetëm 1 kompanie. Nevojat e tregut të punës në vend janë nevoja që nuk lidhen (orientohen) vetëm me një apo dy kompani ose punëdhënës potencial, por janë të lidhura me trendin e punësimit në sektorin e TIK-u për të cilin Shqipëria aktualisht nuk ka potencial të ndikojë tregjet rajonale/globale por nëpërmjet programeve të studimit (referuar dhe programit

të studimit në fjalë) dhe qasjes strategjike ndërsektoriale të përgatitet për të përqsur zhvillimin social-ekonomik në përputhje me trendët globale. Gjithashtu, krahas lendeve të detyrueshme që janë pjesë e planit mësimor, studenteve iu organizohen vazhdimisht workshope, me qëllim thellimin e njohurive dhe njohjen me zhvillimet më të fundit të teknologjisë, duke ditur se ritmi i zhvillimit të së cilës është aq dinamik.

Përgjigje e GVJ:

Komenti i sipër cituar nga institucioni, vjen si një përmbledhje e takimeve me

- Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës
- Drejtuesin e njësisë kryesore (Dekani)
- Drejtuesin e njësisë bazë (përgjegjësi i departamentit)
- Koordinatorin e programit të studimit
- Stafin akademik të përfshirë në këtë program studimi (shih komentet në vijim)

Pyetjes se si stafi ka qenë i angazhuar në hartimin e këtij plani mësimor dhe njohurive që përçohen në çdo lëndë si vijim të formimit tërësor të studentit. Stafi u përgjigj që nuk kanë qenë të angazhuar, dhe këto janë hartuar nga ekspert të jashtëm të institucionit. *Përgjigje e dhënë nga "Pedagogu 6", pedagog me profil në fusha të këtij programi studimi dhe i angazhuar në U_POLIS që në hapje të këtij programi studimi.*

Gjatë takimit me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, në veçanti, stafi që vjen nga përvoja në kompani, vihej re se sugjeronin ndryshime në planin mësimor, duke sugjeruar lëndë të reja të cilat plotësojnë nevojat e studentëve të kërkuar në kompanitë ku ata janë të angazhuar. Përmendim këtu propozimin për shtimin e një lënde të re ku të mësohet gjuha e programimit "R", apo atë për "Sigurinë kibernetike".

Gjuha "R", është specifike për një treg të caktuar të shkencave informatike. Kjo nuk mund të shtohet në planin mësimor pa një analizë të mirëfilltë për nevojat objektive për këtë lëndë, apo lëndë të ngjashme. Ne si GVJ e gjykojmë shumë pozitive këtë frymë të propozimeve të ndryshimeve bazuar në kërkesat e aktorëve profesional, por këto kërkesa duhet të rishikohen nga institucioni për të vlerësuar nëse janë në fokusin e këtij programi dhe se si ato duhet të paraqiten apo gërshetohen nga ana didaktike në funksion të objektivave të vetë programit.

Pasi, nëse sugjerimet e lëndëve, zbatohen në planin mësimor pa një analizë të mirëfilltë didaktike (analiza bëhet vetëm nga koordinatori i programit), rrezikon që formimi i studentëve të ngjajë më shumë një formimi profesional e cila i orienton studentët drejt tregut të punës specifik, por jo drejt formimit të tyre tërësor bachelor.

Pyetjes në takimin me stafin akademik, përse kjo lëndë sugjerohet dhe mendohet se është e nevojshme për këtë profil, u shpjegua se njëri prej stafit (me kohë të pjesshme) e përdor gjerësisht në kompaninë ku është i angazhuar dhe se është trend i fushës së Informatikës.

Në të vërtetë, kjo lëndë është gjerësisht e përdorur në përpunime statistikore dhe informatikë grafike, por si kjo gjuhë programimi ka shumë të tjera, dhe ndoshta edhe më të kërkuara nga tregu i punës, këtu përmendim Python, Java, Javascript etj. Gjuhë që kanë një përdorim edhe më të gjerë se ajo specifike e gjuhës "R". Gjithashtu, është sugjeruar shtimi i një lëndë rreth sigurisë së rrjetave të telekomunikacionit, çka edhe ne si GVJ e gjykojmë si nevojë e tregut të punës. Por niveli dhe njohuritë që duhet të përçohen në këtë lëndë, kërkon një koordinim me tërësinë e njohurive të fituara nga studentët e këtij programi studimi përpara zhvillimit të kësaj lënde. Çka, nga ana e autoriteteve drejtuese, mungonte si njohuri dhe mundësi koordinimi. Kjo

lihej në dorë të vetëm koordinatorit të programit të studimit, të cilën e përsërisim, ka një njohje të mirë të vet programit, por nuk ka eksperiencë të mjaftueshme për të vlerësuar ndryshime në këtë nivel. Kjo nuk mund të realizohet as nga titullari i lëndës, i cili padyshim është një aktor kryesor në hartimin e syllabusit, por duhet një gërshetim në nivel njësie bazë me të gjitha njohuritë në tërësi të studentëve, mënyrave të përcimit të dijeve dhe në funksion të objektivave formuese në tërësi. Pra me aktorët që kanë njohjen në tërësi të programit të studimit (ekspertët e jashtëm të angazhuar nga institucioni në këtë rast).

Për të mbështetur këtë nevojë për analizën e propozimeve për modifikime të planit mësimor, dhe bazuar edhe në njohjen e autoriteteve drejtuese të këtij programi studimi, janë bërë sugjerimet që U_POLIS i ka paraqitur në komentimin vijues më poshtë.

Pra, komenti i cituar, dhe ndoshta jo i kuptuar korrektësisht nga institucioni, nuk qëndron në numrin e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve që U_POLIS ka me kompani, por me analizën e nevojave të tyre për ti paraqitur në lëndë apo module në këtë program studimi.

Ne si GVJ e gjejmë pozitive mënyrën e operimit të institucionit me workshope dhe takime me aktorë të tregut të punës, madje e kemi përmendur si një praktikë pozitive edhe në draf-RVJ (shih Standardin III.1, III.2, III.7 etj).

Pra për sa më sipër, puna e GVJ, në hartimin e raportit ka qenë voluminoze, objektive dhe korrekte në analizën e të gjithë të dhënave dhe ndërthurjes së tyre në funksion të cilësisë në tërësi të shërbimeve të ofruara nga institucioni.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

e) GVJ citon: *"institucioni të përfshijë në organizimin e këtij programi studimi, profesionistë dhe akademik me eksperiencë në hartimin e programeve të studimit, por edhe që të kenë njohje në tërësi jo vetëm të rezultateve dhe njohurive që studentet duhet të përftojnë në përfundim të këtij cikli studimi, por edhe se si ato të arrihen me shpërndarje e tyre në aktivitete didaktike (leksione, seminare, laboratorë, etj.) si dhe në vite akademike"*

Lidhur me opinionin që ka të bëjë me ekspertizën e stafit të këtij programi studimi, shprehemi se stafi administrativ/akademik i angazhuar në hartimin e programit të studimit në fjalë është staf me eksperiencë të gjatë në tregun në rritje të TIK dhe ka eksperiencën e duhur jo vetëm për të kuptuar rëndësinë e programit, por dhe për të reflektuar në aspektin organizativ dhe akademik trendet e kohës, me gjithë vështirësitë dhe sfidat që përballlet fusha e TIK në Shqipëri. (Tab. Nr.2 dhe nr 4. tek Tabela Përmbledhëse)

Përgjigje e GVJ:

Institucioni, ndoshta nuk e ka kuptuar tërësisht komentimin e shkruajtur në RVJ duke e nxjerrë atë nga konteksti i të gjithë kriterit. Rekomandimi i mësipërm, bazohet në praktikën që institucioni ka ndjekur deri më tani në hapjen dhe mbarëvajtjen e këtij programi studimi.

Sikurse u përmend në përgjigjet më sipër, bazuar në takimet e realizuara në U_POLIS në hartimin e këtij programi studimi, është marrë mbështetje nga specialist të jashtëm nga

U_POLIS dhe nuk është përdorur ekspertiza e brendshme e U_POLIS, sikurse citohet në komentin më sipër. Kjo rezulton edhe nga mungesa e ekspertizës së brendshme në fushën e këtij programi studimi. Për korrektesë dhe vërtetësi informacioni sqarojmë se tabelat e cituara nga institucioni më sipër janë:

- Tabelat 2 paraqet stafin akademik dhe ndihmës akademik të njësisë bazë, Departamenti i Kërkimit Shkencor për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022
- Tabela 4 paraqet ngarkesën (orë mësimore) të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitin 2021-2022.

Analizat e këtyre dy tabelave, janë shqyrtuar me kujdes nga GVJ, dhe të përmbledhura janë paraqitur pikërisht në RVJ në Standardi I.4, kriteri 1. Megjithatë, një analizë të paraqitur edhe në takimin me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, po e risjellim në vijim:

Nga tabela 2.1, viti akademik 2019-2020 (viti i parë i hapjes së këtij programi studimi), anëtarët e njësisë bazë janë 9 formimi i të cilëve është:

Formimi	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Arkitekt/Inxh. Ndërtimi/ Inxh. Mjedisi/ Histori Arti (Arkitekturë)	6	4	3
Shkenca Sociale	1	1	-
Informatikë	1	1	1
Elektronikë/Telekomunikacion	-	1	2 ose 4 [#]
Fizikë	1	-	-
Matematikë	-	-	2
Raporti në profil/jashtë profilit	1/9	2/7	3/8 ose 5/10[#]

[#]Për shpjegimin e kësaj ndarje, shihni përgjigjet në Standardi I.4, Kriteri 1 më poshtë në vijim.

Pra formimi i anëtarëve të njësisë bazë, në vitin e parë të hapjes së këtij programi studimi, nuk janë në fushën e këtij programi. Përtej eksperiencës së tyre profesionale, akademike dhe menaxheriele, të cilën ne si GVJ nuk e gjejmë dhe sa nuk e paragjykojmë, madje e respektojmë, ata nuk kanë formim në fushën specifike të programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike.

Referuar, stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, që në hapje e deri në vitin akademik 2021-2022 të paraqitur në tabelën 4, në takimin me ta, edhe pse mund të kenë përvojën dhe njohuritë, nuk kanë qenë të angazhuar në shqyrtimin e këtij programi studimi. Ata, edhe pse profesionist të fushave përkatëse, janë të fokusuar kryesisht vetëm në lëndën/modulin ku janë të angazhuar, pa patur një panoramë të plotë të programit të studimi.

U_POLIS, ka qenë koshient për këtë mangësi, dhe ka marrë ekspertizë të jashtme në hartimin e këtij programi studimi, çka ne si GVJ e vlerësojmë shumë pozitive, pasi plotëson mungesat e brendshme me ekspert të jashtëm në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Pikërisht në këtë kontekst është edhe sugjerimi i paraqitur në RVJ, pra praktika e ndjekur tashmë në hapje, të ndiqet sërish në propozimet e modifikimit të këtij programi, ose të rritet ekspertiza e brendshme për këtë qëllim.

Pra, për sa më sipër, vërejmë se institucioni, nuk ka kuptuar plotësisht sugjerimin më sipër, dhe e ka nxjerrë atë nga konteksti i të gjithë standardit. Komenti qëndron dhe bazohet në tërësinë e komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura më sipër.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh.

RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

• **Standardi I.4, Kriteri 1:**

a) GVJ citon: "*Dosja pranë zyrës së burimeve njerëzore, nuk përmbante të gjithë të dhënat si për staf PAE të parashikuar nga institucioni*"

Për sa i përket konstatimit të bërë në fund të këtij kriteri vërtetojmë që nuk qëndron si evidentim pasi përmbajtja e dosjeve të stafit akademik në marrëdhënie pune PAE dhe ai në marrëdhënie PAK nuk mund të kenë ligjërisht të njëjtat dokumenta në dosje. Përmbajtja e dosjeve të stafit janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Kodit të Punës por edhe me aktet ligjore të U_POLIS, kjo është saktësuar edhe në Aneksi 44 i RVB-se dhe gjithashtu gjatë vizitës në ambientet e Universitetit vlerësuesve të jashtëm u është shpjeguar në detaje procesi i rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve, sipas llojeve të marrëdhënies së punës.

Përgjigje e GVJ:

Hartimi i raportit, sikurse e kemi përmendur që në fillim, nuk bazohet vetëm në një gjetje, por në korrelimin e të dhënave nga shumë burime.

Në veçanti, gjatë takimit me stafin akademik, ku Pedagogu 18 ishte prezent, u kërkua sqarim rreth statusit të punësimit pasi nuk përputhej me atë të shkruajtur në CV, por nuk u morr një përgjigje shteruese. Në këtë diskutim u përfshinë disa pedagog, ku ndër më kryesorët ishte "pedagogu 21", dhe përgjigja e përmbledhur ishte: **Për sa kohë ligji e lejon dy-punësimin, dhe pedagogu respekton angazhimin në mësimdhënie të marrë në institucion, edhe gjatë fundjavës, institucioni e konsideron atë si PAE.**

Megjithatë, duke mos qenë GVJ në rolin e juristit, apo të ekspertëve të zyrës së punës (nuk është në tagrin e GVJ të luaj rolin e zyrës së punës apo institucioneve të tjera ligj-zbatuese), e kemi marrë të vërtetë pohimin e pozicionit të punës si PAE.

Në vijim të takimeve në U_POLIS ishte edhe ajo në zyrën e burimeve njerëzore.

Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, u kërkua të vihej në dispozicion në mënyrë rastësore dy dosje për staf të kategorisë "lektor" dhe një për staf "asistent lektor" të angazhuar në këtë program studimi.

Na u vendos në dispozicion nga punonjësi i zyrës, në mënyrë rastësore, dosja e "Pedagogut 17", "Pedagogut 18" dhe "Asistent lektore" e angazhuar në lëndën "Bazat e të dhënave". Gjatë shqyrtimit të këtyre tre dosjeve, u gjetën disa mos përputhje (*shih shpjegimet vijuese*), u kërkuar një dosje tjetër, dhe për këtë na u vendos në dispozicion dosje e drejtuesit të njësisë bazë, i cili nuk është i angazhuar në këtë program studimi, por përmbajtja e dosjes së tij ishte e plotë.

– Gjetjet në dosjen e pedagogut 17:

- **Mungonte dokumenti mbi “Organizimin e kohës së punës” pranë U_POLIS**
 - Sipas rregulloreve të brendshme, ku dokument plotësohet përpara fillimit të vitit akademik, ose gjithsesi përpara fillimit të angazhimit të stafit.
 - Është dokument që pranohet prej drejtuesit të njësisë bazë dhe miratohet prej drejtuesit të njësisë kryesore.
 - **Shpjegimi nga U_POLIS për këtë mangësi është se është harruar të plotësohet.**
- **Nuk kishte leje nga punëdhënësi për angazhim**
 - **sipas U_POLIS nuk duhet të ketë pasi është full-time në U_POLIS**
 - Sipas GVJ, Pedagogu 17, të paktën në fillim të vitit akademik, sipas CV të dorëzuar rezultoi i punësuar prej vitit 2010 e deri më tani, pranë “kompanisë 1” (*shih shpjegimet shteruese në vijim*).
- Gjetjet në dosjen e pedagogut 18:
 - **Mungonte dokumenti mbi “Organizimin e kohës së punës” pranë U_POLIS**
 - E njëjta gjetje dhe koment si për pedagogun 17 më sipër.
 - **Nuk kishte leje nga punëdhënësi për angazhim**
 - **sipas U_POLIS nuk duhet të ketë pasi është full-time në U_POLIS**
 - Sipas GVJ, Pedagogu 18, të paktën në fillim të vitit akademik, sipas CV të dorëzuar rezultoi i punësuar prej vitit 2004 e deri më tani, pranë “kompanisë 1” (*shih shpjegimet shteruese në vijim*).
- Gjetjet në dosjen e Asistent Lektorit:
 - **Dokumenti mbi “Organizimin e kohës së punës” pranë U_POLIS, për këtë staf ishte në dosje, por i plotësuar me angazhim akademik që nuk janë të parashikuara në këtë program studimi.**
 - Dokumenti i mësipërm, i pranuar nga drejtuesi i departamenti (firmosur prej tij) dhe i miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore (firmosur dhe vulosur prej tij), pranonin angazhimin e këtij stafi në aktivitete didaktike, që për lëndën përkatëse nuk janë të parashikuara në planin mësimor.
 - Sipas U_POLIS, i cili u njoftua direkt për këtë detaj, u shpjegua (*shih shpjegimin e detajuar në vijim*) se ishte gabim njerëzor.
 - Sipas GVJ, një dokument me tre firma, (Asistent lektori, përgjegjësi i departamentit dhe Dekani), të jetë me pasaktësi të dukshme, tregojnë edhe një herë se drejtuesi i njësisë bazë, ka një njohje të ulët të aktiviteteve didaktike të parashikuara në këtë program studimi.
 - Sipas GVJ, në tërësi, njësitë përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë nuk kanë mekanizma për të zvogëluar gabimet njerëzore.
- Gjetjet në dosjen e Drejtuesit të Departamentit (jo i angazhuar si staf në këtë program studimi):
 - Dosja ishte e plotë dhe përmbante:
 - CV
 - Kontratë
 - Deklaratë
 - Organizimin e kohës së punës
 - Diplomë + listë notash

- Ekuivalentim nga ministria përgjegjëse për arsimin (diplomë e fituar jashtë Shqipërisë)
- Librezë shëndetësore
- Librezë pune

Shpjegime më të detajuara për mospërputhjet:

- "Pedagogu 18", është **paraqitur** si staf me kohë të plotë (*full-time*) në U_POLIS, pra PAE për vitin 2021-2022 (*shih Tab. 2 në RVB për vitin 2021-2022*)
- Në CV-në e paraqitur në DVV, rezulton se ky personel akademik është angazhuar në "kompaninë 1" prej vitit 2004 e në vijim.
- Prej vitit 2015 e në vijim, është në pozicionin e "Drejtorit të divizionit IT" në "kompaninë 1" (e njëjta ku punon prej vitit 2004).
- Pozicioni i punës si "Drejtor i Divizionit IT" në kompaninë 1, është një pozicion pune me kohë të plotë (*full-time*), kjo në dijeninë e GVJ-së.
- Sipas legjislacionit në fuqi, është i lejuar punësimi në më shumë se një punëdhënës, por vetëm një punësim mund të jetë me kohë të plotë, të tjerat mund të jenë me kohë të pjesshme. Të paktën kjo është sipas njohurive që anëtarët e GVJ-së kanë, por pa patur tagrin e një interpretimi të mirëfilltë juridik (nuk është në tagrin e GVJ-së).
- GVJ, dedukton se Pedagogu 18, pranë U_POLIS është i punësuar me "**Kohë të pjesshme**" dhe duhet të konsiderohet në kategorinë PAK, dhe jo PAE sikurse është paraqitur në DVV. Kjo të paktën deri më Janar 2022, datë e dorëzimit të DVV nga U_POLIS në ASCAL.
 - o Megjithatë, duke mos patur informacion të konfirmuar dhe të saktë për llojin e punësimit të "Pedagogut 18", edhe pse u kërkua, ne si GVJ, në raport i kemi paraqitur të dy alternativat që gjetëm, pra atë që U_POLIS thotë si PAE, dhe atë që ne si GVJ kuptojmë si PAK.

I njëjti diskutim vlen edhe për gjetjet në dosjen e "Pedagogut 17".

Për sa më sipër, puna e GVJ, në hartimin e raportit ka qenë voluminoze, objektive dhe korrekte në analizën e të gjithë të dhënave dhe ndërthurjes së tyre në funksion të cilësisë në tërësi të shërbimeve të ofruara nga institucioni.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh.

RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

b) GVJ citon: " Vetëm 2 nga 7 staf PAE për vitin akademik 2020-2021 në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, kanë formimin në fushën specifike, nga të cilët, një me kualifikimin Prof. Dr, dhe një me Msc" si dhe "Mungesa e stafit akademik PAE me përvojë në fushën specifike të programit të studimit vërehej edhe gjate vizitës"

Për të qenë korrekte në këtë vlerësim duhet mbajtur parasysh se në vitin akademik 2020 - 2021 programi studimit kishte vetëm 2 vite aktive dhe me gjithë mobilizimin për rekrutim të stafit, risjellim në vëmendje që ishim në mes të pandemisë dhe të gjitha kufizimeve të imponuara prej saj. Në vitin pasardhës 2021-2022 janë tashme 6 nga 11 anëtarë të departamentit me

formim specifik në këtë fushë: 1 Prof. Dr.; 2 Dr; 2 kDr dhe 1 staf ndihmës akademik. Nga 5 anëtarët e mbetur 2 janë me formim në Matematike: 1 Prof. Asoc. Dr. dhe një Doc. Kujtojmë që kriteri minimal ligjor për stafin efektiv pranë një departamenti është 7 nga të cilët 3 me grada e tituj.

Përgjigje e GVJ:

Citimi i paraqitur nga U_POLIS, ka bashkuar dy paragraf dhe i ka nxjerr ato nga konteksti.

Komenti i paraqitur nga U_POLIS si përgjigje e citimi, përkon plotësisht me atë që GVJ ka hartuar në RVJ, dhe më konkretisht e ka shkruajtur direkt mbas citimit të përmendur më sipër dhe e risjellim për korrektesë si vijon:

[...]

Ne si GVJ, vlerësojmë pozitivisht përpjekjen e institucionit në rritjen e numrit të stafit akademik PAE me formimin në fushën specifike të programit të studimit. Në veçanti, për vitin aktual akademik (2021-2022), stafi akademik PAE si anëtar i njësisë bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, është rritur dhe me formim më specifik në fushën e programit të studimit. (Tabela 2 në RVB).

...]

Pra, GVJ, vetëm ka vënë në dukje gjetjet e vitit akademik 2020-2021 dhe më pas përgëzon punën e U_POLIS për rritjen e stafit në vitin 2021-2022. Në asnjë rast nuk është diskutuar kriteri minimal ligjor i formimit të njësisë bazë, pasi ai ka qenë gjithmonë i garantuar, edhe me dyshimet rreth punësimit të dy anëtarëve të personelit akademik. (shih përgjigjen e citimit më sipër po për këtë kriter), pra kriteri ligjor i njësisë bazë është përmbushur.

Megjithatë, bazuar në “Aneks 19 Organigrama e stafuar”, “Pedagogu 17” është cituar si staf në “Departamentin e Kërkimit të Aplikuar”, duke përmbushur kështu kriterin minimal ligjor për së paku tre anëtar me tituj dhe/ose grada. Nëse “Pedagogu 17”, është efektivisht staf i “Departamentit të Kërkimit Shkencor” sikurse kuptohet nga tabela 2.3, atëherë departamenti i “Kërkimit të Aplikuar” (jo pjesë e këtij vlerësimi) nuk përmbush kriteret ligjore për të qenë njësi bazë.

Pra, komenti i U_POLIS përkon plotësisht me atë që GVJ ka shkruajtur në raport, dhe nuk ka informacione shtesë apo korigjuese të atyre të shkruajtur.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, është i njëjtë me atë të hartuar nga GVJ, nuk shton, apo saktëson atë të shkruajtur nga GVJ në raport. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

• Standardi I.4, Kriteri 3:

GVJ citon: "Gjatë takimit në vizitë, vërehej edhe nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, një njohje shumë e mirë e fushës specifike për profilin e studimit doktorat, por një njohje minimale e fushës specifike të programit të studimit nën shqyrtim"

Fakulteti Kërkim për Zhvillim në vetvete është një fakultet ndërdisiplinor (qasje kjo e cila shkon në përshtatje me Strategjinë 2021-2026, e cila nxit fushat ndërdisiplinore, duke e

konsideruar atë si pikë të dobët deri tani), rrjedhimisht dhe njësitë bazë janë të tilla. Kjo mund të shikohet qartë nga programet që këto njësi ofrojnë. Konkretisht pranë Departamentit të Kërkimit Shkencor, ofrohet një nga programet më të rëndësishëm dhe më cilësore të universitetit, ai i ciklit të tretë Doktraturë. Ky program ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës në Itali, çka bën që jo vetëm njësitë bazë por dhe ajo kryesore të kalojnë çdo vit procesin e akreditimit nga ministria përgjegjëse për arsimin në Itali. Gjithashtu, pranë kësaj njësie do të ofrohen edhe dy programe të tjera të rëndësishme Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike, si dhe Master Ekzekutiv në Restaurim.

Ky ndërdisiplinaritet bën të mundur që në krye të njësisë bazë të kemi të angazhuar staf i cili bën pjesë në një nga këto fusha . Pasi departamenti përveç: pjesës shume të rëndësishme akademike, ka një përgjegjësi shumë të madhe edhe në kontekstin administrativ, kjo na ka bere ti besojmë drejtimin e kësaj njësie një prej akademikëve me eksperiencë shume vjeçare dhe të shumëllojshme në arsimin e larte jo vetëm vendas por dhe të huaj. Shiko gjithashtu sqarimet e ofruara në vijim për Standardin II.2, Kriteri 1.

Përgjigje e GVJ:

Citimi i pjesës së RVJ të hartuar nga GVJ, konfirmohet si i saktë, edhe me përgjigjen/komentin e institucionit më sipër.

Pra institucioni konfirmon që drejtuesi i departamentit ka një njohje shumë të mirë të fushës së Arkitekturës ku ndiqet edhe studimi i ciklit të tretë. Por nuk sqaron njohjen e ulët të fushës së këtij programi studimi, aq më tepër që edhe në njësinë bazë përkatëse, numri i stafit akademik me kohë të plotë, me formim në këtë fushë, është i ulët.

Njëkohësisht, referuar dokumentacionit të depozituar nga U_POLIS, në veçanti “*Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme, neni 8, neni 18, neni 21*” janë pikërisht këta dy drejtues (sidomos drejtuesi i departamentit) të cilët kanë përgjegjësinë e programit të studimit dhe çdo ndryshimi të propozuar në të.

Madje, janë pikërisht këta drejtues që paraqesin nevojat për staf akademik dhe formimet e kërkuara prej tyre, për të plotësuar nevojat e këtij programi studimi me staf akademik të kualifikuar. Megjithatë, kjo njohje e ulët, është e dokumentuar edhe në takimin në zyrën e burimeve njerëzore (*shih përgjigjen e GVJ për citimin nga Standardi I.4, Kriteri 1, më sipër*), ku në dosjen e një Asistent Lektor, të angazhuar në këtë program studimi, më konkretisht si Asistent Lektor në lëndën “Database Design Concept”, në marrëveshjen e angazhimit akademik, të miratuar nga drejtuesi i departamentit (e firmosur prej tij), e miratuar nga drejtuesi i fakultetit (e firmosur dhe vulosur prej tij), Asistenti Lektor, do të zhvillonte “Labororë” në këtë lëndë. Por kjo lëndë, bazuar edhe planit mësimor, nuk parashikon zhvillimin e këtij aktiviteti didaktik. Kjo gjetje, Ju vu në dukje menjëherë përgjegjëses së zyrës, dhe njëkohësisht edhe koordinatorit të programit të studimit, ku të dy nuk kishin një përgjigje për këtë dokument.

Vetëm mbas konsultimit të koordinatorit me organe të tjera brenda institucionit (nuk kemi informacion me kë u konsultua), na shpjegoi, që është dokument i hartuar nga Asistent Lektor, pavarësisht se ka miratimin e dy drejtuesve, dhe është gabim njerëzor dhe do të korrigjohet menjëherë.

Gabimet njerëzore janë kudo prezente, por mekanizmat e cilësisë ndërtohen që këto gabime të zvogëlohen. Për këtë janë bërë edhe komentet përkatëse në Standardin VI. që trajton në tërësi mekanizmat e sigurimit të cilësisë.

Pra, të dy drejtuesit, që sipas akteve rregullatore të brendshme, kanë përgjegjësinë e këtij programi studimi, nuk kanë njohje të kësaj fushe, por edhe të organizimit të programit të studimit në tërësi në aktivitetet formuese (leksione, seminare, laborator, etj.).

Për sa i përket vlerësimit nga institucione të huaja (Itali), kjo nuk është pjesë e vlerësimit të këtij programi studimi, pasi është në fushë tjetër, dhe nivel tjetër kualifikimi. Kjo gjithsesi nuk justifikon mos-njohjen e një prej fushave të ofruara nga departamenti, edhe pse në nivel bachelor. Megjithatë, U_POLIS, në këtë proces vlerësimi, nga GVJ është vlerësuar përputhshmëria me standardet e cilësisë kombëtare në fuqi sipas udhëzimeve ASCAL, dhe gjithashtu përputhshmërinë me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë dhe aktet e tij rregullatore.

Për sa i përket ndërdisiplinaritetit, mund ti referoheni shpjegimeve të dhëna në përgjigje të komentit "c" për Standardi I.3, Kriteri 2 më sipër.

Citimi dhe komenti përkatës, këtu i paraqitur nga institucioni, edhe një herë, nuk gjen asnjë pasaktësi apo mos-korrektësi në punën e GVJ.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk sqaron njohjen e ulët (fakt) të drejtuesve për këtë program, sikurse është cituar në raport. Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

- **Standardi I.5, Kriteri 3:**

GVJ citon: "*Gjatë shqyrtimit të DVV, nga GVJ janë gjetur disa pasaktësi në emërtim të dokumentacionit dhe përmbajtjes së tij par edhe në dokumentacion që nuk i përkisnin këtij programi studimi*"

DVV është emërtuar në përputhje me Anekset e dorëzuara së bashku me RVB- ne, kjo është konfirmuar me dosjen fizike të dorëzuar në ASCAL, por dhe me dosjen fizike që ekspertëve ju vu në dispozicion në momentin kur zhvilluan vizitën në institucion. Gjithashtu theksojmë se, lista e dokumentacionit të DVV-së (anekseve) të dorëzuar është me e madhe se ajo e kërkuara, kjo si rrjedhojë e mënyrës unike se si çdo institucion mban dokumentacionin. Që do të thotë, një aneks i kërkuar nga ASCAL, në POLIS mund të gjendet në dy dokumentet, ose e kundërta. Por, të gjitha këto ndryshime të vogla në emërtime janë paraqitur në formë të detajuar në listën përfundimtare në fund të RVB-së.

Përgjigje e GVJ:

Ky citim është për kriterin 3 që kërkon nga GVJ vlerësimin si më poshtë:

[...]

Standardi I.5, Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve

...]

Nga sa më sipër, kërkohet nga GVJ të vlerësojë nëse institucioni ka hartuar raporte, dhe për këtë i referohemi dokumentacionit në DVV. Nga lista e dokumenteve të paraqitur, dokumenti

me emërtimin “**Aneks 35 Raporti i fundit periodik mbi marrëveshjet**” duhet të përmbajë këtë informacion.

Ky dokument (*Aneks 35*), nuk paraqet asnjë raport për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, por paraqet informacion komplet tjetër (shih analizën në vijim).

Në asnjë dokument tjetër nuk paraqitet një raport për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të institucionit.

Kjo është shpjeguar në kriterin e cituar në RVJ, megjithatë, institucioni duket i pa qartë në komentin që ne si GVJ kemi hartuar. Për të qartësuar edhe një herë institucioni, edhe pse Ju evidentua gjatë vizitës se dosja elektronike e dorëzuar në sistemin e ASCAL paraqiste pasaktësi. Në vijim, disa prej dokumenteve të paraqitur që, sikurse e kemi shkruajtur, dhe e vënë në diskutim nga institucioni “*Gjatë shqyrtimit të DVV, nga GVJ janë gjetur disa pasaktësi në emërtim të dokumentacionit dhe përmbajtjes së tij por edhe në dokumentacion që nuk i përkisnin këtij programi studimi.*”

- **Aneks 16 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit**
 - o Ky dokument nuk paraqet “Studimin e tregut të punës para hapjes së programit”
 - o Është ekstrakt nga një dokument më i madh
 - o Paraqet “**Objektivat Formuese dhe karakteristikat e programit të studimit**”
- **Aneks 28 Te dhënat tabelore përmbledhëse për personelin akademik**
 - o Ky dokument nuk ka asnjë tabelë apo përmbledhje të pretenduar sipas emërimit
 - o Paraqet vetëm linke në faqe facebook dhe linkedin
 - o Paraqet **njoftime rreth aktiviteteve informuese, leksione të hapura apo workshope të organizuar nga U_POLIS**
- **Aneks 35 Raporti i fundit periodik mbi marrëveshjet**
 - o Ky dokument nuk paraqet raport mbi marrëveshjet
 - o **Paraqet një procesverbal të mbajtur në një takim të koordinatorit të programit të studimit me disa student të këtij programi për problematikën e zhvillimit të leksionit online.**

Disa prej dokumenteve ku përmbajta, krahasuar me dokumente të tjerë në dosje, nuk përputhen, edhe pse duhet:

- “**Aneks 19 Organigrama e stafuar**” nuk rakordon me “**Aneks 24 Te dhënat për personel akademik Bsc. Shk** (tabelat 2 në RVB)”
 - o Aneks 19 paraqet Departamentin e Kërkimit shkencor me **10 anëtarë** (përfshi edhe stafin ndihmë akademik) për vitin 2021-2022, ndërsa Aneks 24 e paraqet atë me **11 anëtar** (përfshi edhe stafin ndihmë akademik) për vitin 2021-2022.
- “**Aneks 25 Tabela me ngarkesën e stafit Bsc. ShK** (Tabela 4 në RVB)” nuk rakordon me “**Tabelën 12.3 në RVB**” për të njëjtin vit akademik 2021-2022
 - o Sipas Tab.12.3, në lëndën “Hyrje në Telekomunikim dhe Rrjeta Kompjuterike” angazhohen dy personel akademik (Pedagogu 3 (Msc) dhe Pedagog 15 (Dr.)), ndera në Tab. 4, për këtë lëndë ka zhvilluar ngarkesë vetëm “Pedagog 3” me kualifikimin Msc.
 - Lëndë e cila zhvillohet në semestër të parë, në vitin e dytë. Pra në periudhë që ishte e mbyllur si aktivitet didaktik në kohën e vizitës së GVJ në U_POLIS, dhe nuk mund të jetë parashikim, por realizim.

- E njëjta situatë për shumë lëndët në të cilat, në tabelën 12 që paraqet “**Planin Mësimor të Lidhur me Personelin Akademik Përkates**”, nuk përputhen me ato të tabelës 4 që paraqet “**Ngarkesën e plotë mësimore në të gjitha programet e studimit për stafin e angazhuar në këtë programi studimi**, për të njëjtin vit akademik.
 - Madje, në tabelën 12.3 paraqitet edhe personel akademik, i cili nuk figuron fare në tabelën 4. Kjo gjetje është vënë në dukje edhe në raport, më konkretisht në standardin IV.2, kriteri 4.

Lënda	Të dhëna Tab. 12.3	Të dhëna Tab. 4
Shkrim Akademik	Dr. dhe Msc	Msc.
Anglisht	Dr. dhe Msc	Msc.
Web Programming	Prof. Dr. dhe Msc	Msc.
Inxhinieri Software	Dr. dhe Msc	Msc.
Arkitektura e Kompjuterave	Dr. dhe Msc	Msc.
Sistemet Operative	Dr. dhe Msc	Msc.
Data science	Dr. dhe Msc	Msc.
Multimedia Design	Dr. dhe Msc	Msc.
Rrjete Kompjuterike 2	Dr. dhe Msc	Msc.
Gjuhë Programimi Java	Prof. Dr. dhe Msc.	Msc.
Web Programing 2	Prof. Dr. dhe Msc.	Msc.
App Programing	Dr. dhe Msc.	Msc.
Metoda të Kërkimit Shkencor	Dr. dhe Msc.	Msc.

Edhe dokumente të tjera të kërkuara nga ASCAL, që korrektësisht, sikurse përmend komenti i institucionit më sipër, mund të gjenden në një apo disa dokumente të U_POLIS, janë referuar në dokumentin që duhet ti përmbajë, por që në të vërtetë dokumenti i referuar nuk e ka atë informacion, ose nuk e ka të plotë, si për shembull:

- **Aneksi 39. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies**
 - Ky dokument, në përmbajtje ka vetëm një referencë në një dokumente tjetër në dosje.
 - Dokumenti i referuar: **Aneks 9 Rregullore Didaktike**
 - Kjo rregullore, është e përgjithshme dhe nuk paraqet të dhëna specifike për metoda inovative në mësimdhënie. Megjithatë, **në këtë rast, kjo nuk është mangësi, pasi jo detyrimisht institucioni duhet të ketë një rregullore të tillë.**

Në dosje janë paraqitur edhe dokumentacion që nuk i përket këtij programi studimi, ku edhe këto, u vunë në dukje, që në momentin e parë të takimit në U_POLIS.

- **Aneks 52.1 Tabela 11_Ndryshimet ne matrica ARK 16-22**
 - Informacion që nuk i përket këtij programi studimi.
 - Paraqet ndryshime në planin mësimor për programin **MSc i Integruar Arkitekturë dhe Dizajn Urban viti akademik "2016-2017 me 2021-2022"**
- **Aneks 52.2 Vendim senati miratim plani FAD**
 - Informacion që nuk i përket këtij programi studimi.
 - Paraqet vendime për miratimin e planeve mësimore, strukturës, rregulloreve për programet e studimit në **Fakultetin e Arkitekturës dhe Dizajn Urban (FAD)**
- **Syllabuset e lëndëve**

- Informacion që nuk i përket këtij programi studimi
- **Janë syllabuse të programeve të studimit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn Urban.**

Syllabuset e lëndëve për këtë program studimi, u kërkuan fizikisht në institucion në fillim të vizitës, dhe na u vendosën në dispozicion menjëherë në formë fizike, dhe më pas u ngarkuan nga U_POLIS edhe në sistemin elektronik të ASCAL.

Ngatërimi i syllabuseve, është një gabim njerëzor, sikurse edhe ne si GVJ jemi të ndërgjegjshëm që mund të ndodhi, dhe për këtë qëllim i sugjeruam institucionit të rikontrollonte të gjithë dosjen e dorëzuar në format elektronik për këtë program studimi pasi kishte pasaktësi të tjera (një pjesë e tyre i përmendëm më lartë). Megjithatë, sikurse e kemi sugjeruar në këtë kriter, institucioni duhet të krijojë mekanizma të brendshëm të sigurimit të cilësisë që edhe këto gabime njerëzore të reduktohen.

Por për korrektësinë e procedurës së punës të ndjekur nga GVJ, ky kriter është vlerësuar maksimalisht, pra “Përmbushet Plotësisht”, pavarësisht komentit dhe sugjerimit të shkruajtur në këtë kriter.

Kjo pasi, këtu po vlerësohen kriteret e **“Standardit I.5: Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit”.**

Standard që institucioni e plotëson, dhe për këtë e kemi vlerësuar si të **“Përmbushur Plotësisht”.**

Komenti dhe gjetjet e më sipërme, janë pjesë e proceseve dhe procedurave për sigurimin e cilësisë, ku së paku, dosja duhet të ishte kontrolluar nga një person i dytë, të paktën mbas vënies në dukje nga GVJ në vizitë. Gjë që nuk ka ndodhur, pasi dosja nuk është azhurnuar (përveç dokumenteve të kërkuar në mënyrë eksplicite nga GVJ).

Prandaj këto gjetje dhe të tjera të ngjashme në standarde të tjera, që i përkasin proceseve dhe procedurave për garantimin e brendshëm të cilësisë, janë rimarrë në standardin VI që analizojnë sigurimin e cilësisë në tërësi. Këto gjetje, janë analizuar në Standardin VI, së bashku me shkaqet që mund të kenë çuar në këto pasaktësi, dhe janë hartuar edhe sugjerimet përkatëse që të evitohen në të ardhmen.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh.

Ky kriter ka qenë i vlerësuar maksimalisht nga GVJ që në fillim, pasi edhe gjetjet e paraqitura më sipër, nuk vlerësohen në këtë kriter, por në kritere të tjera në vijim të RVJ-së. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

Standardi 2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Faqe 23 nga 129

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TE STUDIMIT TE CIKLIT TE PARE BACH ELOR

• Standardi II.1, Kriteri 5 :

GVJ citon: "Vihet re në planin mësimor, është se të gjitha lëndët/modulet parashikojnë shpërndarje të krediteve dhe ngarkesës respektive vetëm në dy tipologji të aktiviteteve formuese, përkatësisht leksione dhe seminare. Kjo shpërndarje ngarkese dhe kreditesh përkatëse nuk përputhet me format e vlerësimit referuar syllabuseve të lëndëve"

Në lidhje me këtë argument theksojmë se, programi është licencuar me dy tipologji (leksion dhe seminar) dhe patjetër që në përfundim të akreditimit mund të shtojmë në planin mësimor edhe tipologjinë "laboratorë", por fakti që nuk janë të ndara në planin mësimor nuk do të thotë se nuk zhvillohen punë laboratorike, përkundrazi zhvillohen në mënyrë intensive madje kemi shtuar vitet e fundit dy laboratorë shumë të rëndësishëm dhe me donatore të Bashkimit Europian të cilët kanë besuar tek ky program i ofruar nga U POLIS .

Gjithashtu programi është hartuar duke përcaktuar qartë në veprimtaritë formuese sipas VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar.

Përgjigje e GVJ:

Komenti i U_POLIS më sipër, është i njëjtë me atë që GVJ ka parashtruar në të gjithë Kriterin 5 të standardit II.1. Madje që fjalia e parë e hartuar në RVJ për këtë kriter citojmë: [...Programi i studimit është i organizuar në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018...]

GVJ, e ka përmendur në këtë standard, se Laboratorët dhe detyrat e kursit, pavarësisht se nuk janë të saktësuara as si kredite dhe as si orë në auditor, ato realisht zhvillohen. Madje, kjo është përmendur edhe në Kriterin 5 edhe në kriterin 6 të standardit II.1 (shih RVJ).

Pra, komenti i sjellë nga U_POLIS rreth shkrimit të këtij standardi në RVJ, nuk plôtëson informacionin ekzistues dhe as nuk sjell pasaktësi (pasi nuk ka) në atë që GVJ ka hartuar pasi si komenti i U_POLIS i përmbledhur në një paragraf, ashtu edhe shkrimi i GVJ në dy faqe, kanë të njëjtën përmbajtje.

Megjithatë, vlerësimi tërësor i Standardit II.1 (ku përsihet edhe kriteri 5 i cituar më sipër) është gjykuar si "Përmbushet kryesisht" (pra jo maksimal), pasi në tërësi, mungesa e ndarjes së saktë të aktiviteteve laboratorike, nuk lejon monitorimin sasior dhe cilësor të përçimit të dijeve në ato lëndë që e kanë të nevojshme këtë aktivitet. Nga ana tjetër nuk lejon vlerësimin e mjaftueshmërisë së ambienteve laboratorike për të gjitha lëndët dhe grupet mësimore që i përdorin ato. Megjithatë, bazuar edhe në komentet e përcjella nga institucioni, dhe kuptimin prej tij të nevojës së ndarjes së aktiviteteve didaktike në kreditet dhe orët përkatëse, sikurse është shpjeguar gjerësisht në këtë standard në RVJ, gjykojmë që vlerësimi i këtij standardi të ndryshojë nga "Përmbushet Kryesisht" në "Përmbushet Plotësisht". duke paraqitur edhe rekomandimet përkatëse.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, është i njëjtë me atë të hartuar nga GVJ në RVJ.

RVJ ndryshon, Shkalla e përmbushjes së Standardit II.1 ndryshon nga "Përmbushet Kryesisht" në "Përmbushet Plotësisht".

Vlerësimi tërësor i Standardit II. (Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit), nuk ndryshon, pasi në RVJ është gjykuar nga GVJ si “Përmbushet plotësisht”

Koment i Universitetit POLIS:

• **Standardi II.2, Kriteri 1:**

GVJ citon: " *Megjithatë, gjatë shqyrtimit të kualifikimeve, gradave dhe titujve akademik për organet drejtuese, vërehet së Dekani i njësisë kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, ka vetëm gradën shkencore "Doktor", pra i përket kategorisë "Lektor"*

Statuti i Universitetit POLIS, i miratuar me MAS me Urdhër Nr. 281 datë 19.05.2017 ne nenin 19, pika 1 citon se: "Drejtuesi i njësisë kryesore duhet të jetë personal akademik me kohë të plotë dhe të ketë të paktën gradën shkencore Doktor". Në këtë aspekt ne kemi respektuar rigorozisht Statutin e U_POLIS . (Aneksi 2 i RVB-se).

Në vijim të kësaj pike, duam të theksojmë së drejtuesi i njësisë kryesore Dr. Skënder Luarasi, ka kryer që në nivelin Bachelor e deri në PhD në shkollat më prestigjioze ndërkombëtare si Yale University dhe MIT, madje studimet e tij janë fokusuar në Dizajn Parametrik duke ndërthurur disiplinën e arkitekturës me paradigmen e Teknologjisë së Informacionit. Në këtë kuptim, në jemi shumë krenare për këtë formim kaq të spikatur të drejtuesit të fakultetit i cili është aktualisht ne proces aplikimi për titullin Prof. Asoc.

Përgjigje e GVJ:

Citimi i sjellë nga U_POLIS, është sjellë jo i plotë nga draft-RVJ, pasi në vijim të atij citimi në RVJ, ne si GVJ kemi përmendur që ky pozicion dhe kualifikim janë në përputhje me statutin e U_POLIS. Për korrektesë të hartimit të kësaj përgjigje, po risjellim edhe një herë atë të shkruajtur në draft-RVJ të plotë

[...]

Megjithatë, gjatë shqyrtimit të kualifikimeve, gradave dhe titujve akademik për organet drejtuese, vërehet së Dekani i njësisë kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, ka vetëm gradën shkencore "Doktor", pra i përket kategorisë "Lektor" (shih nenin 59 të ligjit 80/2015 për Kategoritë e Personelit Akademik)

Zgjedhja e Dekanit nga kategoria "Lektor", është në përputhje me nenin 19 të Statutit të Universitetit POLIS ku sanksionohet:

[... Drejtuesi i njësisë kryesore duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë i Universitetit POLIS dhe të ketë të paktën gradën shkencore Doktor...].

Statuti i Universitetit është miratuar me Urdhër Nr, 281, datë 19.05.2017 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Bazuar në nenin 42 të Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, drejtuesi i njësisë kryesore (Dekani) është personel akademik i kategorisë "Profesor".

Për sa më sipër, ka një mospërputhje midis kualifikimit të drejtuesit të njësisë kryesore dhe ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, por është në përputhje me Statutin e Institucionit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.



Ne si GVJ nuk jemi në gjendje të vlerësojmë përputhshmërinë ligjore të këtij kriteri. Për sa më sipër, sugjerojmë Bordin e Akreditimit të vlerësojë këtë kriter bazuar edhe në akreditimin institucional të vitit 2017 i cili është në datë më të vonshme sesa miratimi i Statutit nga ministria përgjegjëse për arsimin.

....]

Pra komenti i sjellë nga U_POLIS më sipër përkon plotësisht me atë të shkruajtur nga GVJ në RVJ.

Përtej komentit të paraqitur nga institucioni rreth Standardi II.2, Kriteri 1, në tërësi, ky standard është vlerësuar maksimalisht nga GVJ, pra si “PËRMBUSHET PLOTËSISHT”.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, vetëm vë në dukje atë të shkruajtur në RVJ nga grupi i vlerësimit të jashtëm. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

- **Standardi II.5, Kriteri 1:**

GVJ citon: "Referuar tabelave në RVB, në auditor zhvillohen në total 1692 orë mësimore për të tre vitet akademike. Nga këto, 456 orë janë realizuar nga staf PAK, pra 27% dhe pjesa tjetër prej 73% është realizuar nga staf PAE. Referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, rezultojnë një mospërputhje e të dhënave në tabelën 2 në RVB që përmbledh stafin akademik të departamentit përgjegjës për programin e studimit, dhe referuar Aneks 19 Organigrama e stafuar, shpërndarja e stafit në njësi bazë nuk përputhet mes tyre"+

Referuar tabelave në RVB ritheksojmë se, nga total i orëve 1874 janë 456 orë të zhvilluara nga stafi me kohe të pjeshme saktësisht është 27 %, pra me pak se 30%.

Ndërsa, dokumentacioni i referuar në DVV ku pretendohet se Tabela 2 (për vitin akademik 2021 - 2022) dhe Aneksi 19 i Organigramës së stafuar nuk përputhen, nuk është e vërtetë pasi përputhen plotësisht, saktësisht tabela nr. 2 paraqet stafin i cili, është angazhuar për vitin akademik 2021- 2022 (PAK dhe PAE), ku PAE jo domosdoshmërisht duhet të jetë vetëm nga një departament por angazhohen edhe staf i departamentit tjetër nga i njëjti fakultet sepse siç kemi theksuar edhe me lart Fakulteti ku programi i Bsc Shkencave Kompjuterike bënë pjesë, është multidisiplinar. (Aneksin 19 dhe Tabela 2 për vitin akademik 2021 -2022).

Përgjigje e GVJ:

Shpërndarja e ngarkesës midis stafit PAE/PAK e sjell si koment nga U_POLIS, përkon me atë të shkruajtur në RVJ nga grupi i vlerësimit të jashtëm. Megjithatë, sikurse është përmendur disa herë, në dokumentacioni e paraqitur ka pasaktësi.

Në rastin konkret, *tabela 2* paraqet stafin akademik të njësisë bazë për tre vite akademike, 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 dhe jo stafin e angazhuar në këtë program studimi sikurse silllet gabimisht në komentin më sipër nga U_POLIS.

“Aneks 19 Organigrama e stafuar” paraqet në tërësi stafin akademik të U_POLIS të ndarë në njësi bazë dhe ato kryesore, përtej asaj përgjegjëse për këtë program studimi.

Nga krahasimi i dy dokumentave të mësipërm, shohim se “Pedagogu 17”, në tabelën 2 për vitin 2021-2022, paraqitet si staf PAE i “**Departamentit për Kërkim Shkencor**”, ndërsa në aneks 19, për të njëjtin vit akademik paraqitet si staf PAE i “**Departamentit të Kërkimit të Aplikuar**”. (shih përgjigjet e përgatitur nga GVJ për Standardi I.5, Kriteri 3 më sipër)

Ky pedagog, anëtar i cilës njësi bazë në U_POLIS bënë pjesë???

Aq më tepër, që pedagogu 17 dhe pedagogu 18, në gjykimin e dokumentacionit në dispozicion duhet të jenë të kategorisë PAK dhe jo PAE të paraqitur nga institucioni.

Nëse “pedagogu 17”, i supozuar si PAE, nëse është staf i Departamentit të Kërkimit Shkencor, atëherë Departamenti i Kërkimit të Aplikuar, nuk përmbush kriteret ligjore për të qenë njësi bazë, pasi do të ketë më pakë se tre anëtar me tituj/grada (shih aneks 19).

(shih përgjigjet e përgatitur nga GVJ për Standardi I.4, Kriteri 1 më sipër)

Pra për sa më sipër, hartimi i raportit, dhe në veçanti pjesa e cituar më sipër, janë të sakta dhe përkojnë me gjetjet reale në vizitë në U_POLIS.

Vlerësimi në tërësi i Standardit II.5, është konsideruar jo maksimal, por “Përmbushet Kryesisht”, pasi ka edhe pasaktësi midis tabelave 12.3 dhe tabelës 4 apo midis tabelës 10 dhe tabelës 12.1 etj. Pasaktësitë janë në lidhje me orët reale të paraqitura si të zhvilluara për secilën lëndë të cilat nuk përkojnë me numrin e grupeve mësimore dhe krediteve, por edhe me stafin e angazhuar si lektor dhe asistent lektor në zhvillimin e tyre. (shih përgjigjet e përgatitur nga GVJ për Standardi I.5, Kriteri 3 më sipër)

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

• Standardi II. 5, Kriteri 5:

GVJ citon: "Për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 nuk ka angazhuar personel ndihmës akademik., Vetëm në vitin akademik 2021- 2022, në njësinë bazë, është punësuar një personel ndihmës akademik në ndihme të zhvillimit të aktiviteteve të këtij programi studimi"

Për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 nuk ka patur të angazhuar personel ndihmës akademik, pasi dhe numri i studenteve ka qenë më i ulët, si dhe mos të harrojmë se mësimi në këto vite është zhvilluar kryesisht online si pasojë e pandemisë. Me rritjen e numrit të studenteve, u pa e nevojshme angazhimi i stafit ndihmës akademik. (Aneksi 27 i RVB-se).

Përgjigje e GVJ:

Citimi i sjellë për rivlerësim me komentin e U_POLIS më sipër, plotëson me informacion atë të hartuar nga GVJ. Informacion që është gjithsesi cituar nga GVJ edhe në standarde të tjera.

Komenti i sjellë nga U_POLIS, nuk paraqet pasaktësi në punën e GVJ apo në draft-RVJ të hartuar.

Megjithatë, ky informacion, i vërtetë dhe i konfirmuar edhe gjatë vizitës, do të shtohet në RVJ si informacion plotësues në Standardin II.5, kriteri 5. Ky informacion, i njohur edhe më parë nga GVJ dhe i cituar në kritere të tjera, nuk shton të dhëna që mund të sjellin ndryshime në vlerësimin e standardit II.5.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, është plotësues, dhe do të shtohet në RVJ. RVJ ndryshon për këtë kriter (plotësohet), por vlerësimi i standardit II.5 nuk ndryshon.

Koment i Universitetit POLIS:

Standardi 3

MËSIMDHËENIA, MËSIMNXËNIA, VL RËSIMI DHE KOMPETENCAT

- **Standardi III.3, Kriteri 9 :**

GVJ citon: "*në Dosjen e Vetëvlerësimit, nuk është paraqitur një dokumentacion i mirëfilltë apo një shembull konkret të platformave elektronike të përdorura nga institucioni apo organizimin e tyre të unifikuar.*"

Konfirmojmë së, në Dosjen e Dokumentacionit të Vetëvlerësimit (Aneksi 46 i RVB-së) përmendin dokumentacionin, manualin e depozituara për këto platforma.

Përgjigje e GVJ:

Citimi i sjellë për rivlerësim nga U_POLIS me komentin përkatës, është plotësues. Në DVV janë paraqitur dy dokumente, përkatësisht "Aneks 46.1 Manual Përdorimi për plotësimin e pyetësorit" dhe "Aneks 46.2 MANUAL_PEDAGOGU", të cilat GVJ i ka shqyrtuar gjerësisht.

Këto dy dokumente, përmbajnë përkatësisht:

- i pari, një dokument me tre faqe, tregon procedurën që studenti duhet të ndjekë për të plotësuar një pyetësor në sistemin PITAGORA;
- i dyti një dokument me 3 faqe, i hartuar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar) për qasje në sistemin PITAGORA.

Por nuk paraqitet një informacion rreth mënyrës se si ndër veprojnë studentët me pedagogët, studentët me studentët, pedagogët me pedagogët sekretaria mësimore, departamenti për planet mësimore apo programet e lëndëve etj.

Megjithatë, ne si GVJ, kemi njohuri të mëparshme nga përdorimi i sistemit PITAGORA dhe sistemeve të tjera online të përdorura në U_POLIS, prandaj edhe e kemi vlerësuar këtë standard maksimalisht (Përmbushet Plotësisht). Kjo falë njohurive tona, dhe jo sipas dokumentacionit të ofruar nga institucioni.

Dokumentet e cituara në komentin e U_POLIS, janë përmendur gjerësisht në Standardin IV nga GVJ, çka tregon se GVJ i ka shqyrtuar me seriozitet të gjithë dosjen e vetë vlerësimit, dhe

janë cituar aty ku efektivisht përmbajtja e tyre është provë vërtetësie për kriteret apo standardet specifike.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, është plotësues, dhe do të shtohet në RVJ.

RVJ ndryshon për këtë kriter (plotësohet me informacion), por vlerësimi i standardit III.3 nuk ndryshon, pasi është maksimal, pra “Përmbushet Plotësisht”

Koment i Universitetit POLIS:

- **Standardi III.4, Kriteri 1 :**

GVJ citon: " *vërejmë se funksionimi i tyre nuk është i mjaftueshëm apo i koordinuar brenda institucionit*"

Strukturat për promovimin dhe përmirësimin e cilësisë janë:

Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, përbërja e të cilit është parashikuar në Statutin e Universitetit POLIS, dhe miratohet çdo vit me fillimin e vitit akademik, bashkë me organet kolegjiale të Universitetit. (Aneksi 2 i RVB-se), Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë.

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, përbërja e së cilës është dërguar së bashku me RVB- në por njëkohësisht është e shfaqur edhe në faqen zyrtare të universitetit edhe në linkun e vendosur në brendësi të raportit, aktiviteti i secilës operon në përputhje me rregulloren e NJBSC-së (Aneks 30 i RVB-së) dhe (Aneks 37 i RVB-së)

Përgjigje e GVJ:

Citimi i sjellë nga U_POLIS, është sjellë jo i plotë nga draft-RVJ, pasi një paragraf më sipër citimit të sjellë, në RVJ, ne si GVJ kemi cituar dy njësitë e përmendura në komentin më sipër.

Pra, komenti i U_POLIS për këtë kriter, nuk gjen pasaktësi në hartimin e raportit nga GVJ, dhe jo vetëm, por përshkruan po të njëjtat informacione të shkruajtur nga GVJ në draft-RVJ.

Për korrektesë të hartimit të kësaj përgjigje, po risjellim edhe një herë atë të shkruajtur në draft-RVJ të plotë si vijon (duke evidentuar në **bold** citimin e sjellë për rivlerësim nga U_POLIS):

[...]

Bazuar në organigramën e institucionit, vërejmë disa struktura që në fokus kanë promovimin dhe sigurimin e cilësisë. Ndër të cilat përmendim:

- *Koordinatori për Burimet Njerëzore, Kualifikim Stafit & Sigurimi i Cilësisë;*
- *Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë;*
- *Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë;*

*Struktura/zyra në varësi hierarkike të Rektoratit. Megjithëse Institucioni ka në organikë tre struktura që në fokus kanë promovimin e cilësisë, **vërejmë se funksionimi i tyre nuk është i mjaftueshëm apo i koordinuar brenda institucionit.***

...]

Pra GVJ dhe një herë, ka vepruar në mënyrë shumë objektive dhe korrekte në hartimin e draft-RVJ, çka përputhet plotësisht me komentin e sjellë nga U_POLIS më sipër.

Megjithatë, Standardi III.4, Kriteri 1, kërkon nga GVJ vlerësimin e: *“Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.”*

Pra në përgjigje të kërkesave të këtij kriteri, në formë të përmbledhur kemi:

- Institucioni ka njësi për sigurimin e cilësisë?
 - o Përgjigja e GVJ = PO
- Këto njësi koordinojnë punën në kuadër të përmirësimit të cilësisë?
 - o Përgjigja e GVJ = JO plotësisht

Komenti dhe diskutimi i sjell nga U_POLIS për raportin e shkruajtur në draft-RVJ është për faktin e njërive për sigurimin e brendshëm, çka ne si GVJ e kemi shprehur qartazi që janë prezente. U_POLIS nuk ka sjell asnjë koment rreth faktit (jo pozitiv) që këto njësi nuk operojnë të sinkronizuara mes tyre. Këto njësi operojnë kryesisht në hartim raportesh për gjetje të mundshme, dhe më pas ato i raportohen organeve drejtuese, por nuk ka një mekanizëm, apo procedurë të dokumentuar që këto njësi të bashkërendojnë punën për zvogëlimin e gjetjeve.

Për këtë është shprehur qartë në RVJ, dhe institucioni nuk ka sjellë komente për këtë çështje, çka tregon edhe një herë punën korrekte të GVJ.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

- **Standardi III.4, Kriteri 5:**

GVJ citon: *"Në DVV, informacioni i vënë në dispozicion është shumë i pakët për të vlerësuar në tërësi shkallën e përmbushjes së kriterëve cilësore për stafin e angazhuar në këtë program studimi. "*

Për sa i përket mënyrës se trajnimit të personelit akademik dhe përmirësimit të aftësive të mësimdhënies, janë vënë në dispozicion gjithë projektet që universiteti POLIS me qëllim dhënien e informacionit konkret se në cilat trajnime, workshope kombëtare dhe ndërkombëtare stafi ka patur mundësi të marrë pjesë (Aneksi 17 i RVB-së)

Përgjigje e GVJ:

Citimi i sjellë nga U_POLIS, është jo i plotë nga draft-RVJ. Për korrektesë të përgjigjes, por risjellim edhe një herë citim të plotë nga draft-RVJ:

[...]

Në DVV, informacioni i vënë në dispozicion është shumë i pakët për të vlerësuar në tërësi shkallën e përmbushjes së kriterëve cilësore për stafin e angazhuar në këtë program studimi. Megjithatë, vërehet se institucioni mbështet kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik me mbështetjen e zhvillimit të punimeve doktrale në institucione partnere. Falë edhe projekteve institucionale si koordinator apo edhe si anëtar, Universiteti Polis trajnon stafin e tij. Në veçanti, falë pjesëmarrjes në projektin DRIVE (Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo), pjesë e platformës Erasmus+ CBHE, Universiteti POLIS ka

...]

Citimi i sjellë nga U_POLIS për rivlerësim, qëndron në faktin se sikurse e kemi përmendur në draft RVJ, dhe përkon plotësisht me komentin e U_POLIS të sjellë më sipër, institucioni mbështet stafin për kualifikim. Por, ne si GVJ, nuk gjetëm në DVV dokumentacion që të tregonte mbështetjen e stafit të angazhuar në këtë program studimi. Pra të dhënat në dosje, për këtë kriter, janë të përgjithshme për U_POLIS, por mungojnë ato specifike për këtë program studimi dhe stafin e angazhuar në të.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga U_POLIS dhe me komentin e tij më sipër.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, është tashmë pjesë e draft-RVJ, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

Standardi 4

BURIM ET NJ EREZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PER REALIZIMIN E PROGRAMIT TE STUDIMIT

- **Standardi IV.1 , Kriteri 1:**

GVJ citon: " gjatë vizitës në institucion, u vu re se procedurat e parashikuara në aktet rregullatore të brendshme, Jo gjithmonë kanë rezultuar në mbajtje të saktë të dokumentacionit"

Dokumentacioni i mbajtur në Zyrën e Burimeve Njerëzore është në përputhje të plotë jo vetëm me kërkesat e legjislacionit në fuqi por dhe me kërkesat ekstra që universiteti ka vendosur për dokumentacionin e nevojshëm që arkivon për stafin akademik. Koncretisht, Aneksi Kontratën, Dëshminë e Penalitetit, etj. (Aneksi 44), dy kërkesa të cilat janë tregues i rëndësisë që U_POLIS i kushton cilësisë kualifikimit, por dhe caktimit të objektivave të punës për stafin e angazhuar në mësimdhënie dhe jo vetëm.

Përgjigje e GVJ:

Një përgjigje shteruese për për këtë argument është paraqitur në përgjigjen e dhënë për Standardin I.4, Kriteri 1 më sipër. Referohuni gjetjeve të paraqitur në atë përgjigje.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

- **Standardi IV.2, Kriteri 4:**

GVJ citon: "të dhënat e kësaj tablele, nuk përputhen me ato të analizuara për të njëjtin vit akademik"

Në bazë të Rregullores së Përgjithshme në dosjet e stafit arkivohen lista e dokumenteve sipas Aneksit 44 . Sqarohet se, për këtë çështje GVJ-së ju vendos në dispozicion dhe kontratat e stafit në fjale. Nuk mund të themi që është e paqarte forma e angazhimit të stafit në universitet si PAE apo PAK. Pasi çdo staf ka një kontratë ligjore dhe një dosje personale dokumentacioni e cila justifikon çdo lloj pretendimi të kësaj natyre.

Përgjigje e GVJ:

Përgjigje shteruese, është dhënë në RVJ, ku të gjitha tabelat e përmendura janë cituar, duke i krahasuar njëra me tjetrën dhe duke vënë në dukje që nuk përputhen.

Për plotësim dhe qartësim të U_POLIS, disa prej pasaktësive të tabelave janë sjellë edhe në përgjigjen për Standardi I.5, Kriteri 3 më sipër. Megjithatë, mjafton të shohim, qoftë edhe nga ana sasiore, për vitin akademik 2021-2022, sipas tabelave kemi një raport të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi si PAE/PAK si vijon:

- Tab. 6.3: 13 PAE dhe 8 PAK
- Tab. 7.1: 13 PAE dhe 8 PAK
- Tab. 12.3 16 PAE dhe 8 PAK
- Tab. 4 14 PAE dhe 7 PAK

Pra realisht, sa staf PAE janë angazhuar në këtë program për vitin 21-22? 13, 14 apo 16????

Po staf PAK? 7 apo 8?

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

- **Standardi IV.4, Kriteri 2:**

GVJ citon: "nuk ishte e qartë nëse dy prej stafit akademik të angazhuar pranë njësisë bazë "Departamenti i Kërkimit Shkencor" për vitin akademik 2021-2022, dhe të angazhuar si staf akademik në këtë program studimi, të paraqitur si PAE, efektivisht ishin staf PAE apo PAK."

Statusin PAE apo PAK të stafit akademik e përcakton kontrata e punësimit reflektuar (e lidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi). Kjo faktohet në evidencat financiare (ndalesat, taksat, etj), dhe në ngarkesën e tyre në mësimdhënie. Angazhimi i tyre profesional në kohën e mbetur në kompani të ndryshme është jo vetëm i lejuar ligjërisht por dhe i inkurajuar (brenda kuadrit ligjor dhe kriterëve të arsimit të lartë) në një disiplinë si kjo ku nevoja për ti pajisur studentet me njohuri praktike dhe aftësi të kërkuara sot në tregun e punës. Në këto kushte, nuk ka pse të ketë asnjë paqartësi nga ana e vlerësuesve.

Përgjigje e GVJ:

U_POLIS ka gabuar në emërtimin e këtij citimi, ai nuk i përket “Standardi IV.4, Kriteri 2” por i përket Standardi IV.2, Kriteri 4.

GVJ, nuk ka rol në vlerësimin e përputhshmërisë së institucionit me legjislacionin përkatës të punësimit apo atë tatimor. Kjo është në tagrin e organeve përkatëse ligj-zbatuese. Gjithsesi, ne besojmë se institucioni i përmbush këto detyrime ligjore. Ne si GVJ vlerësojmë përputhshmërinë e dokumentacionit në lidhje me standardet e cilësisë dhe atë të akteve ligjore dhe nën ligjore për arsimin e lartë, në kuadër të vlerësimit të një programi studimi.

Për një përgjigje shteruese, dhe që qartëson dyshimet e GVJ, lutem, shikoni përgjigjen e dhen për **Standardin I.4, Kriteri 1** më sipër.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

• Standardi IV.4, Kriteri 5:

GVJ citon: *"Jo gjithmonë është e përditësuar me edicionet e fundit, dhe jo gjithmonë këto janë pasqyruar në syllabuset e lëndëve"*

Duke qenë një program me vetëm 3 vite ekzistence në U_POLIS, pasurimi i literaturës për programin e SHK është në fokusin kryesor të departamentit dhe bibliotekës dhe vazhdimisht tentohet të sillen literaturat e fundit. Sigurisht, kjo është një punë e vazhduar dhe ndryshimet/përditësimet e Syllabuseve. U_POLIS po punon vazhdimisht për përgatitjen e dispencave/manualeve dhe ka në dispozicion dy platforma e-library online JSTOR dhe EBSCO të shoqëruara me manualat përkatëse të përdorimit për të cilat, aksesimi është i lirë për të gjithë studentet dhe i disponueshëm në çdo kohë, nuk mund të pretendohet që universiteti nuk ofron literaturë të përditësuar. Lidhur me faktin që, në disa lëndë mund të mos jetë literatura e viteve të fundit, kjo lidhet me lirinë akademike të pedagogut, i cili mendon se libri baze mund të mos jetë më i mire se ai i botuar së fundmi, por sigurisht që literatura shtesë është gjithmonë e azhurnuar. Ndërkohë, pedagogu në leksionet e tij e kapërcen këtë, duke i përditësuar çdo vit ato.

Përgjigje e GVJ:

Një program studimi, i hapur prej 3 vitesh, nuk duhej të kishte në përdorim një literaturë jo të azhurnuar. Kjo tregon edhe një herë që, që në hapje të këtij programi, organizimi i tij, ka qenë me literaturë të vjetruar. Nëse në vitin 2018, kur është aplikuar në ministrinë përgjegjëse për arsimin për hapjen e këtij programi, do të ishin hartuar syllabuset me literaturë të azhurnuar, ajo do të ishte koherente edhe sot.

Mjafton të përmendim disa lëndë karakterizuese të këtij programi si:

- “Web Programming” me literaturë të detyrueshme të vitit 2002 dhe atë të rekomanduar të vitit 2011 (shih syllabusin e lëndës).
- Kujtojmë U_POLIS, se në fushën e Shkencave Kompjuterike, Web-i, dhe të gjitha fushat e lidhura me të, kanë bërë ndryshime rrënjësore, në filozofi, qasje, teknika dhe mënyra të paraqitjes së informacionit.

Pra kjo literaturë (viti 2002), për këtë lëndë, jo vetëm që nuk është më e mirë se ato të viteve të fundit, por është jashtë çdo argumenti që mund të trajtohet në një lëndë të tillë në vitin 2022. Situata është e ngjashme në disa lëndë të tjera karakterizuese.

GVJ, duke qenë edhe njohës të kësaj fushe akademik dhe profesionale, dakordësojnë se për lëndë formuese bazë si Matematikë apo Fizikë, literatura më e mirë, mund të mos jetë e viteve të fundit, por kjo nuk është e pranueshme për lëndë profilizuese apo karakterizuese si ajo e përmendur më sipër. Në shumë syllabuse, literatura nuk citohet e plotë si referencë bibliografike që duhet të përmbajë

- Autorin/Autorët
- Titullin e librit
- Edicioni (nëse ka)
- Vitin e botimit
- Shtëpinë botuese
- ISBN

Por citohet vetëm me emër libri, apo vetëm si link në web. Informacion jo i plotë për të referuar një literaturë.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS dhe me komentin e tij më sipër.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, është tashmë pjesë e draft-RVJ, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

Standardi 5

STUDENTET DHE MBESHTETJA E TYRE

- **Standardi V.5, Kriteri 2:**

GVJ citon: *"Megjithatë, studentët, edhe pse janë të përfshirë në dhënien e mendimeve për përmirësimin e vazhdueshëm, institucioni nuk i informon ata në lidhje me raportet e përmbledhura apo mbi vendimet dhe masat e mara për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë që janë prodhim i drejtë për drejtë i anketimeve të studentëve"*

Në lidhje me këtë standard sqarojmë se, studentet përfaqësohen në NJSBC me një anëtar, si dhe me 3 anëtare në Senatit Akademik nga 19 anëtare që ka në total. Kjo mënyre përfaqësimi i jep mundësi studenteve, të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre si dhe njëkohësisht të informohen në lidhje me raportet dhe vendimmarrjet e institucionit. Megjithatë e gjejnë këtë konstatim në përputhje me objektivat e POLIS për transparence dhe gjithë përfshirje dhe do garantohemi që në website zyrtar të institucionit (që është aktualisht në rinovim) Raportet e NJSBC të jenë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë.

Përgjigje e GVJ:

Komenti i sjellë më sipër nga U_POLIS, është në përputhje të plotë me atë të shkruajtur në RVJ nga ne si GVJ.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Faqe 34 nga 129

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Citimi i sjell vjen nga takimi me studentët, ku ata edhe pse plotësojnë pyetësorët, nuk informohen rreth tërësisë së plotësimit të pyetësorit nga kolegët e tyre.

Ky citim, vjen si rekomandim për U_POLIS që të informojë studentët rreth gjetjeve, kjo me qëllimin e qartësimit të tyre rreth programit, lëndëve dhe institucionit. Si në shembullin në vijim.

Pra, nëse një student, në plotësimin e pyetësorit vlerëson lëndën apo literaturën si të vështirë, dhe në opinionin e atij studenti, ajo lëndë nuk është zhvilluar si duhet. Nëse në komentet në tërësi, të të gjithë studentëve, vlerësohet se lënda nuk është e vështirë, atëherë edhe studenti qartësohet se problemi i lëndës nuk qëndron tek lënda apo institucioni, por mund të jetë në përgatitjen e tij. Por këtë qartësim, studenti mund ta kuptojë vetëm nëse sheh edhe opinionin e studentëve të tjerë, e cila vjen në formën e raportit.

Komenti i më sipërm, është në përputhje me atë të kërkuar në “Kriterin 2” ku citojmë (në bold):

[...]

*Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, **këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme***

...]

Pra, kjo është në formën e sugjerimit për të patur një përfshirje dhe informim real të studentëve, në kuadër të transparencës dhe sigurimit të cilësisë. Por ky standard, është vlerësuar maksimalisht nga GVJ, pasi strukturat për përfshirjen e studentëve janë të ngritura. Sugjerimi është që të jenë më frytdhënëse.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Ky kriter ka qenë i vlerësuar maksimalisht nga GVJ që në fillim. RVJ nuk ndryshon.

Koment i Universitetit POLIS:

Standardi 6

SIGURIMI ICILESISE SE PROGRAMEVE TE STUDIMIT BACHELOR

• **Standardi VI.1, Kriteri 2**

GVJ citon: " *Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, u gjeten dokumentacion jo-konform akteve dhe rregulloreve institucionale*"

Sikurse kemi shpjeguar dhe më lartë Standardi IV.2, Kriteri 4, dosjet e punësimit të stafit akademik janë në përputhje të plotë me Rregulloren e Përgjithshme të U_POLIS, por dhe kërkesave ligjore në fuqi. Nuk mund të pretendohet se gjatë vizite në zyrën e burimeve njerëzore, u gjeten dokumentacion jo-konform akteve dhe rregulloreve institucionale, për sa kohë që nuk citohet një shembull konkret. Për sa kohë në përfundim të vizitës nuk është kërkuar asnjë evidencë shtesë nuk mund nuk vihet në pikëpyetje në këtë mënyrë serioziteti i punës jo

vetëm të institucionit tonë por dhe të atyre monitoruese. Dokumentacioni për stafin është subjekt kontrolli të vazhdueshëm nga MAS, organet tatimore dhe gjithashtu i përditësuar çdo vit në sistemin elektronik të ASCAL.

Gjithashtu vëmë në dukje se gjatë vizitës së GVJ-së në institucion i është shpjeguar në formë të detajuar përmbajtja e dosjeve të stafit akademik, procesi i punësimit, dokumentet e arkivuara për staf me kontrate punësimi me kohë të plote dhe me kohë të pjesshme. E në lidhje me këtë vlen të theksohet se, dokumentacioni për stafin akademik me kohë të plote dhe atë me kohë të pjesshme nuk i arkivohen të njëjtat dokumente. (Aneksi 44 i RVB-se)

Përgjigje e GVJ:

Sugjerojmë U_POLIS të shohë përgjigjen e dhënë nga GVJ për **Standardin I.4, Kriteri 1** më sipër.

Aty janë dhënë tre shembuj konkret të mospërputhjeve të gjetura.

Pra dy dosje nuk përmbanin “*Dokumentacionin rreth angazhimit akademik*”, dokument që plotësohet në fillim të vitit akademik ose në fillim të angazhimit të stafit.

Ne si GVJ, realizuam vizitën në këtë zyrë në datat 21 dhe 22 Shkurt 2022, ku ishte mbyllur semestri i parë akademik dhe ishte në zhvillim semestri i dytë.

Një dosje e përmbante dokumentacionin rreth angazhimit akademik, por aktivitetet e përshkruara në të, nuk janë pjesë e planit mësimor.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

• Standardi VI.4, Kriteri 4:

GVJ citon: "*Kjo u vu re edhe gjatë vizitës, ku një pjesë e gjetjeve jo konforme me standardet e cilësisë, mund të zvogëlohen me anë të përcaktimit të detyrave konkrete apo proceseve konkrete për të rritur ndërgjegjësimin e brendshëm institucional për plotësimin e standardeve dhe kritereve të cilësisë*"

Gjatë vizitës së GVJ-së ka patur takim të posaçëm me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, anëtarët e të cilës kanë shpjeguar në mënyrë të detajuar se cili është roli dhe përgjegjësia e gjithsecilit në këtë njësi dhe është shpjeguar mënyra e funksionimit të NJBSC-së. Theksojmë se kjo Njësi është operative në POLIS që prej themelimit të tij (pra ka një përvojë 16 vjeçare) dhe stafi drejtues ka një përvojë të gjatë dhe një serë trajnimesh kombëtare e ndërkombëtare për aspekte të ndryshme të cilësisë (standardet ISO, kërkimi shkencor, çështje etike dhe gjinore) dhe stafi i kësaj njësie është angazhuar në akreditime kombëtare e ndërkombëtare si dhe ka qenë pjesë e projektit QainAL me fokus të posaçëm në garantimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Por kjo është një njësi e pavarur, e cila ka për qëllim evidentimin dhe gjetjet mbi mënyrën e ofrimit të cilësisë në institucion. NJBSC-ja si një njësi e pavarur është një organ këshillues e

cila raporton në formë periodike, gjetje të ndryshme ti cilat ia ve në dispozicion Rektoratit dhe Njësive Kryesore.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara, janë këto njësi të cilat mbështetur dhe në legjislacionin e brendshëm propozojnë përmirësime me qëllim rritjen e cilësisë.

Përgjigje e GVJ:

Citimi i sjell më sipër, nuk i përket **Kriterit 4**, por **Kriterit 2**.

Citimi i paraqitur nga U_POLIS, e ka nxjerr atë nga konteksti, pasi një paragraf më sipër është përmendur NJSBC dhe roli i saj i hershëm në institucion. Komenti i paraqitur nga U_POLIS si përgjigje e citimi, përkon plotësisht me atë që GVJ ka hartuar në RVJ, dhe më konkretisht ne si GVJ e kemi cituar në raport. Për korrektesë të përgjigjes, po e risjellim si vijon:

[...]

Megjithatë, edhe pse NJBSC është një strukturë e hershme e këtij institucioni, gjatë vizitës në institucion, u evidentua mbledhja e informacionit nga kjo njësi në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të cilësisë. Por nuk u vu re një përcaktim i detyrave apo objektivave konkrete për adresimin e gjetjeve apo nevojave për përmirësimin e vazhduar të shërbimeve të ofruara në kuadër të rritjes së cilësisë.

Kjo u vu re edhe gjatë vizitës, ku një pjesë e gjetjeve jo konforme me standardet e cilësisë, mund të zvogëlohen me anë të përcaktimit të detyrave konkrete apo procesve konkrete për të rritur ndërgjegjësimin e brendshëm institucional për plotësimin e standardeve dhe kritereve të cilësisë

Ne si GVJ i sugjerojmë institucionit që të rrisë peshën e NJBSC-së në sigurimin e brendshëm të cilësisë sidomos në adresimin e gjetjeve që kanë nevojë për përmirësim.

...]

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

- **Standardi VI.5, Kriteri 3:**

GVJ citon: "Nuk ka një evidence për planin e masave të hartuar dhe të ndjekur për adresimin e gjetjeve të evidentuara nga NJBSC në kuadër të rritjes së cilësisë"

Sikurse e bëmë të ditur edhe me lartë, NJSBC raporton direkt në organet më të larta të Universitetit, në lidhje me rezultatet e vlerësimit të cilësisë, duke bërë sipas rastit edhe rekomandime në lidhje me aspekte të ndryshme, në funksion të rritjes së cilësisë. Në përfundim të procesit të vlerësimit, Dekanët e fakulteteve duhet të informojnë pedagogët në lidhje me

rezultatet e vlerësimit (Aneksi 37 i RVB-se) dhe sipas rastit marrin dhe masat specifike, sipas procedurës së përcaktuar në udhëzuesin e Burimeve Njerëzore.

Përgjigje e GVJ:

- Citimi i shkruajtur nga GVJ ka në thelb “Plan Masash për adresimin e gjetjeve”
- Komenti i sjell nga U_POLIS ka në thelb “Hartim raportesh”

Pra U_POLIS sjell për rivlerësim pjesë të raportit të hartuar nga GVJ, por në komentin për rivlerësim, sjell rolin si mbledhës informacioni dhe raportues të NJSBC. Informacion që edhe ne si GVJ e kemi përmendur korrektësisht në raport (*shih edhe përgjigjen e dhënë për Standardi VI.4, Kriteri 4 më sipër*).

GVJ, në këtë kriter, sugjeron institucioni që në gjetjet që mund të përmirësohen në kuadër të cilësisë, të hartojë një plan konkret masash, të caktojë personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e tyre, dhe njëkohësisht të vendos afate në realizimin e tyre.

Edhe një herë, ky kriter, i analizuar dhe i hartuar nga GVJ, është korrekt dhe në përputhje me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës.

Komenti i paraqitur më sipër nga institucioni, nuk qëndron, dhe nuk merret parasysh. RVJ nuk ndryshon

Koment i Universitetit POLIS:

Përmbledhëse e hartuar nga U_POLIS

Duke theksuar dhe njëherë vëmendjen maksimale që POLIS i kushton procesit të vlerësimit të jashtëm si një instrument tejet i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe vetëdijes që konkretisht për këtë program të hapur rishtaz puna për garantimin e një standardi sa më të lartë duhet të jetë shumë intensive, kërkojmë që dhe ekspertet të tregohen po kaq mendje hapur dhe konstruktive në leximin e komenteve të përcjella në këtë shkresë dhe të sigurojnë reflektimin e tyre në versionin përfundimtar të raportit.

Përgjigje e GVJ:

Grupi i vlerësimit të jashtëm, e vlerëson pozitivisht bashkëpunimin me U_POLIS si gjatë vizitës, ashtu edhe në dokumentacionin shtesë të kërkuar. Kujtojmë se procesi i vlerësimit të jashtëm, të hartuar nga dy ekspertët e pavarur, dhe nën mbikëqyrjen e ekspertëve të ASCAL, ka qenë një punë voluminoze, korrekte dhe në përputhje të plotë me dokumentacioni e paraqitur nga U_POLIS sikurse edhe me operimin e GVJ gjatë vizitës në institucion. Për të gjitha komentet e parashtruara nga U_POLIS, janë paraqitur të gjithë argumentet mbështetës me dokumentacione, çka edhe një herë tregon asnjësinë e GVJ dhe korrektësinë e operimit të tij.

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin POLIS, GVJ konstaton se ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Misioni dhe vizioni i Universitetit POLIS përcaktohet <i>ne nenin 2 dhe 3</i> të statutit institucional. Universiteti POLIS ka si mision të tij ofrimin dhe përcjelljen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe të aplikuar si dhe inovacionit. Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtar të rinj në fushën e dizajnit, arkitekturës dhe inxhinierisë, shkencave të territorit, menaxhimit dhe politikave të zhvillimit. Të kontribuojë nëpërmjet edukimit, kërkimit shkencor dhe të aplikuar dhe inovacionit, në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit. <i>[Aneks 2 Statuti i Universitetit POLIS]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin POLIS, GVJ konstaton nga shqyrtimi i statutit të Universitetit POLIS dhe strategjinë e zhvillimit institucional, që programet e studimit, përfshirë programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, kanë synim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><i>[Aneks 2 Statuti i Universitetit POLIS]</i></p> <p><i>[Aneks 3 Strategjia e Zhvillimit të institucionit POLIS 2021-2026]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, ofruar nga Universiteti POLIS, është në përputhje me misionin institucional të sanksionuar në statutin e tij në <i>nenin 3</i>. Gjithashtu, edhe rregullorja specifike e programit të studimit, është e hartuar në përputhje me misionin institucional si njësi akademike, kërkimore shkencore dhe kërkim të aplikuar.</p> <p><i>[Aneks 2 Statuti i Universitetit POLIS]</i></p> <p><i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike]</i></p>

<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” i përgjigjet kërkesave të kohës për rritjen e rolit të teknologjisë së informacionit në gjithë aspektet e jetës së përditshme dhe është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Ky program është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKSTI 2020), me Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë së Biznesit (BITS), me Strategjinë për Teknologjinë e Informacionit dhe Telekomunikacionit (e miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 10.04.2003) dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm GVJ konstatoi përmes konsultimeve me të gjithë dokumentacionin e venë në dispozicion (rregulloret bazë, dokumentet e strategjisë së zhvillimit të institucionit) si dhe nga takimet me drejtuesit e Universitetit POLIS, se programi i studimit është ngritur mbi misionet dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë e diversifikimit të ofertës akademike, të sanksionuar në kreun II të strategjisë 2021-2026.</p> <p><i>[Aneks 3 Strategjia e Zhvillimit te institucionit POLIS 2021-2026]</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion, Statuti dhe Rregullorja e institucionit përcakton qartë përparësitë e tij akademike dhe demonstroi që programet e studimit hartohen dhe sigurohen në përputhje me këto të fundit. Referuar <i>Nenit 2 dhe 3</i> të Statutit të Universitetit POLIS, <i>Kreut II</i> të strategjisë institucionale si dhe <i>nenit 2, 3</i> dhe të rregullores së programit të studimit, ato janë në përputhje me strategjinë institucionale dhe ato të zhvillimit kombëtar.</p> <p><i>[Aneks 2 Statuti i Universitetit POLIS];</i></p> <p><i>[Aneks 3 Strategjia e Zhvillimit te institucionit POLIS 2021-2026];</i></p> <p><i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike]</i></p>

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Universiteti POLIS është i organizuar në tre njësi kryesore (Fakultete) ku secili është i përbërë nga tre njësi bazë (departamente apo qendër). Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, ofrohet në njësinë bazë “Departamenti i Kërkimit Shkencor” si pjesë e njësisë kryesore “Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim”</p> <p>Njësia bazë, Departamenti i Kërkimit shkencor, është përgjegjës për organizimin e vetëm dy programe studimi, përkatësisht: Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, dhe Dr në “Arkitekturë dhe Planifikim Urban”</p> <p><i>[Aneks 53 Organigrama _POLIS 2021-2022]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3</p> <p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar RVB-së, Dosjes së Vetëvlerësimit si dhe protokollit të takimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra gjatë zhvillimit të programit të studimit dhe duke mundësuar njohuritë e nevojshme për thellimin e studimeve në ciklin e dytë. Nga të dhënat në dosjen e vetëvlerësimit, konstatohet se nëpërmjet këtij programi studimi synohet që studentëve tu jepen njohuri, dije, aftësi dhe kompetenca në zhvillimin e softuerëve, databazave, menaxhimit të të dhënave dhe rrjetave kompjuterike etj. Në përputhje me nivelin 6 të KSHK. Referuar dhe RVB, synohet që programi i studimit të pajisë studentët me aftësitë e nevojshme për të vepruar dhe hulumtuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë sajë, në sajë të njohurive sistematike dhe të integruara në lidhje me zhvillimin e aplikacione softuare të përdorur në këtë fushë.</p> <p><i>[Aneks 3 Strategjia e Zhvillimit te institucionit _POLIS 2021-2026];</i></p> <p><i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike]</i></p>

Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Bazuar në RVB, Universiteti POLIS, ka kryer një studim të tregut të punës për fushat ku mund të kenë mundësi të punësohen studentët e këtij programi studimi. Megjithatë, në dosjen e vetë vlerësimit, dokumenti me emërtimin “*Aneks 16 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit*”, që duhet të përmbante këtë informacion, në të vërtetë paraqet objektivat formuese të programit të studimit, si dhe strukturat akademike përgjegjëse. Në të nuk është paraqitur asnjë studim tregu apo të dhëna statistikore në lidhje me kërkesën e punëdhënësve të ndryshëm për specialist të formuar në këtë program studimi.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me përfaqësues të Zyrë së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, u vu re, se nga ana e institucionit realizohen takime me punëdhënës potencial. Kryesisht, takimet janë të fokusuar në kompani apo punëdhënës të lidhur ngushtësisht me fushën e arkitekturës, inxhinierisë së mjedisit apo ndërtimit dhe planifikimit urban. Dhe nga këto të dhëna, janë përpunuar edhe ato në lidhje me nevojat e tregut të punës për specialist në fushën e Shkencave Kompjuterike. Gjatë takimit me organet drejtuese të njësisë kryesore dhe asaj bazë, përgjegjëse për programin e studimit, si dhe me koordinatorin e programit të studimit, u vu re, se kishin një njohje të ulët, dhe jo të plotë të programit të studimit, kërkesave dhe nevojave të tregut në lidhje me këtë fushë. Gjithashtu, kjo njohje jo e plotë e fushës së programit të studimit, vërehej edhe në interpretimin e nevojave të tregut të punës bazuar vetëm në sugjerime apo nevoja të disa prej punëdhënësve, të cilat pasqyrohen si nevoja globale për të diktuar ndryshimet e planeve mësimore. Nga këto sugjerime, paraqitej nevoja për shtimin e lëndëve të reja në këtë program studimi për të plotësuar kërkesa që vijnë nga tregu i punës.

Ne si GVJ, mendojmë se kërkesat e një punëdhënësi specifik, për formime të caktuara në fushën e shkencave kompjuterike, bazuar në nevojat specifike të atij punëdhënësi, nuk duhet të konsiderohen si nevoja globale për të diktuar ndryshime kurrikulare, përveç rasteve kur ato nevoja përkojnë me studime më të thelluara të tregut të punës dhe me objektivat formuese të vet programit.

GVJ, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet e realizuara në institucion, gjykojmë se institucioni duhet të realizojë një studim më të mirëfilltë të tregut të punës, jo vetëm për të kuptuar nevojat për specialist në këtë

	<p><i>fushë, por ajo që është më e rëndësishme, është vlerësimi i nevojës së pasqyrimin apo jo në planin mësimor. Vlerësimi i ndryshimeve dhe përshtatja e kurrikulës në mënyrë didaktike për të përçuar me efektivitet njohuritë tek studentët duke parashikuar njohuritë paraprake të nevojshme për përçimin e njohurive të reja që mendohen të shtohen.</i></p> <p>Kjo kërkon që institucioni të përfshijë në organizimin e këtij programi studimi, profesionistë dhe akademik me eksperiencë në hartimin e programeve të studimit, por edhe që te kenë njohje në tërësi jo vetëm të rezultateve dhe njohurive që studentët duhet të përftojnë në përfundim të këtij cikli studimi, por edhe se si ato të arrihen me shpërndarje e tyre në aktivitete didaktike (leksione, seminare, laboratorë, etj.) si dhe në vite akademike. Ky sugjerim vlen për të evituar riskun, që kërkesa specifike nga tregu i punës, të mos devijojnë thelbin e programit të studimit drejt një formimi specifik profesional. Kujtojmë se është një program studimi i nivelit 6 të kualifikimit kombëtar, dhe jo një diplomë profesionale e nivelit 5 të kualifikimit sipas KSHK.</p> <p><i>[Aneks 16 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit]</i></p>						
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve në DVV për këtë program studimi, konstatohet që në tërësinë e vet ky program bazohet në objektiva formuese të qarta dhe strukturë të përshtatshme që janë në funksion të dijeve dhe aftësive të studentëve në tregun e punës. <i>[Syllabuset e lëndëve të kërkuar gjatë vizitës]</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1467 785 1568">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="785 1467 973 1568">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="973 1467 1161 1568">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1568 785 1628"></td> <td data-bbox="785 1568 973 1628" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="973 1568 1161 1628"></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X	
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
	X						

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën,</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit, GVJ konstaton se Universiteti POLIS, garanton burimet financiare dhe</p>

kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.

logjistike për mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike".

Struktura përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim, i cili ka tre njësi bazë:

1. Departamenti i Kërkimit Shkencor;
2. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar;
3. Qendra e Burimeve dhe Informacionit.

Dhe në veçanti në njësinë bazë "Departamenti i Kërkimit Shkencor". Kjo njësi bazë ofron dy programe studimi, përkatësisht një program studimi të nivelit 6 të KSHK (Bachelor) dhe një të nivelit 8 (Doktoratë) si vijon:

1. Bachelor në Shkenca Kompjuterike
2. Doktoratë në Arkitekturë dhe Planifikim Urban

Burimet njerëzore: Personeli Akademik në vitin akademik 2021 – 2022, në nivel fakulteti është **43 pedagogë** gjithsej nga ku 26 janë personel Akademik Efektiv (PAE), dhe 17 janë personel akademik me kontratë (PAK). (Aneks. 23 Te dhenat per njesite kryesore, pergjegjese Bsc SHK)

Grada / titulli	PAE	PAK
Prof. Dr	1	1
Prof. Asoc.	1	-
Dr/PhD	9	5
Dr proces	7	1
Msc	8	10
Totali	26	17

Në Departamentin e Kërkimit Shkencor, i cili është përgjegjës për programin e studimit, në tre vitet e fundit akademike, përbërja e stafit akademik PAE dhe PAK është si në tabelën në vijim. (Aneks. 23 Te dhenat per njesite kryesore, pergjegjese Bsc SHK), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Grada/ Kualifikimi	Nr. për vite akademike					
	2019-2020		2020-2021		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	4	1	3	1	1	1
Prof. Asoc.	1	-	-	-	1	-

Dr/PhD	3	-	3	2	3	3
Docent	-	-	-	-	-	-
Master i Shkencave	1	1	1	4	4	5
Master Profesional	-	-	-	-	-	-
Total	9	2	7	7	9	9

Megjithatë, edhe pse njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, ka numrin minimal të nevojshëm për tu formuar, konform ligjit 80/2015, vihet re se formimi akademik, kërkimor shkencor i tyre nuk është plotësisht në përputhje me fushën e këtij programi studimi.

Në veçanti, stafi akademik PAE, i njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, për vitin akademik 2020-2021, të verifikuar nga ASCAL, dhe vitin 2021-2022 të nxjerrë nga dokumentacioni i paraqitur, ka formimin si më poshtë:

Profili	PAE	
	2020 - 2021	2021 - 2022 ^(#)
Inxh. Ndërtimi	2	0
Arkitekturë	2	3
Telekomunikacion/ Elektronikë	1	4 / 3 / 2 ^(#)
Informatikë	1	1
Matematikë	0	2
Shkenca sociale	1	0
Total	7	10 / 8

(#) Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me zyrën e burimeve njerëzore, nuk ishte e qartë nëse dy prej stafit akademik të angazhuar pranë njësisë bazë "Departamenti i Kërkimit Shkencor" për vitin akademik 2021-2022, të paraqitur si PAE, efektivisht ishin staf PAE apo PAK. Kjo pasi edhe dosja e tyre pranë zyrës së burimeve njerëzore, nuk përmbante të gjithë të dhënat si për staf PAE të parashikuar nga institucioni. Gjithashtu, gjatë përpunimit të dokumentacionit të paraqitur në DVV, vërehet se në [Aneks 19 Organigrama e stafuar] dhe [Tabela 2.3 në RVB] ka

mospërputhje të numrit dhe emrave të stafit të angazhuar për vitin akademik 2021-2022. Megjithatë, formimi i tyre ishte në përputhje me fushën specifike të programit të studimit.

Bazuar në përmbledhjen më sipër, vetëm 2 nga 7 staf PAE për vitin akademik 2020-2021 në njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, kanë formimin në fushën specifike, nga të cilët, një me kualifikimin Prof. Dr, dhe një me Msc.

Ne si GVJ, vlerësojmë pozitivisht përpjekjen e institucionit në rritjen e numrit të stafit akademik PAE me formimin në fushën specifike të programit të studimit. Në veçanti, për vitin aktual akademik (2021-2022), stafi akademik PAE si anëtar i njësisë bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, është rritur dhe me formim më specifik në fushën e programit të studimit. (Tabela 2 në RVB).


Në zhvillimin e aktiviteteve didaktike në këtë program studimi, angazhohet edhe staf PAK me përvojë në kompani të lidhura ngushtësisht me profilin e këtij programi studimi.

Mungesa e stafit akademik PAE me përvojë në fushën specifike të programit të studimit vërehej edhe gjatë vizitës, ku në tërësi mungonte nga autoritetet drejtuese, një njohje e plotë e programit të studimit, syllabuseve, aktiviteteve didaktike dhe formuese specifike. Edhe gjatë takimit me stafin akademik të përfshirë në këtë program studimi, vërehej njohja e tyre e lëndëve ku ishin të përfshirë, por nuk kishin një panoramë të plotë të programit të studimit, objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme për tërësinë e studimeve tre vjeçare të ofruara në këtë program studimi. Njohje më e plotë e programit të studimit zotërohej nga koordinatori i programit të studimit. Koordinatori, staf PAE, edhe pse me formim specifik në këtë fushë, ka një përvojë shumë të reduktuar, bazuar edhe në CV dhe në kualifikimin shkencor për mbarëvajtjen e plotë të një programi studimi.

Sugjerojmë që institucioni të zgjerojë stafin akademik të kësaj njësie bazë, me formim specifik në fusha të këtij programi studimi, mundësisht edhe me eksperience organizative.

Burimet Infrastrukturore: Institucioni garanton ambiente të bollshme dhe moderne si auditorë, klasa për leksione dhe seminare, laboratorë informatike, bibliotekë, mjedise për fotokopjim/librari, zyra për informimin e studentëve, zyra

	<p>për stafin, salla e mbledhje, mjedise për personelin e shërbimit, dhe për kërkim shkencor dhe inovacion, etj.</p> <p>Shërbimet IT: Institucioni ka në përdorim shërbime IT në funksion të mësimdhënies dhe anës administrative të sekretarisë, burimeve njerëzore dhe bibliotekës.</p> <p><i>[Tabela përmbledhëse BSC SHK]. [Aneks 19 Organigrama e stafuar]</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ofrohet në njësinë kryesore, “Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim”, i cili përbëhet nga tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Kërkimit Shkencor; 2. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar; 3. Qendra e Burimeve dhe Informacionit. <p>Kjo njësi kryesore është përgjegjëse për organizimin e katër (4) programe studimi, dy me karakter profesional (niveli 5 i KSHK), një në nivel Bachelor (niveli 6 i KSHK) dhe një në nivel doktorate (niveli 8 i KSHK) si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. PhD në Arkitekturë dhe Planifikim Urban; 2. Bachelor në Shkenca Kompjuterike, (180 ECTS); 3. Program Profesional në Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike (120 ECTS); 4. Program Profesional në Eficencë Energjetike, (120 ECTS); <p>Po në këtë njësi kryesore, është parashikuar aktivizimi i dy programeve të reja nga viti akademik 2022-2023 si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike, (120 ECTS); 2. Master Ekzekutiv në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore, (60 ECTS); <p>Institucioni ka një ekspertizë të konsoliduar në fushën e Arkitekturës, Inxhinierisë së Ndërtimit, mjedisit dhe menaxhimit urban. <i>Por mungon përvoja në fushën e shkencave kompjuterike.</i> Kjo vërehet edhe nga formimi i stafit akademik të kësaj njësie kryesore, e cila në masën më të madhe është e lidhur me profile të fushave të Arkitekturës, inxhinierish së Ndërtimit, mjedisit dhe menaxhimit urban.</p> <p>Megjithatë, është për tu vlerësuar përpjekja e institucionit në zhvillimin e këtij programi studimi dhe gërshetimin e tij me profilet e ofruara më herët nga ky institucion. Kjo sinergji lejon formimin ndërdisiplinor të studentëve, sidomos gjatë</p>




	<p>zhvillimit të praktikave profesionale apo pjesëmarrje në projekte ndërdisiplinore, ku njohuritë e shkencave kompjuterike luajnë një rol kyç në suksesin e tyre. Vërehet gjithashtu, një përpjekje pozitive e institucionit në rekrutimin e stafit akademik me fushë ekspertize në shkencë kompjuterike, edhe pse objektivisht, duke qenë një fushë shumë e kërkuar, ka vështirësi objektive në gjetjen e stafit me këtë formim.</p> <p><i>[Aneks 17 Raporti Vjetor POLIS 20-21];</i> <i>[Aneks 53 Organigrama POLIS 2021-2022];</i> <i>[Aneks 19 Organigrama e stafuar];</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkencë Kompjuterike ofrohet në njësinë bazë “Departamenti i Kërkimit Shkencor”. Kjo njësi bazë ofron dy programe studimi, përkatësisht një program studimi të nivelit 6 të KSHK (Bachelor) dhe një të nivelit 8 (Doktoratë) si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bachelor në Shkencë Kompjuterike 2. Doktoratë në Arkitekturë dhe Planifikim Urban <p>Këto programe studimi paraqesin dy fusha shumë të ndryshme mes tyre. Gjatë takimit në vizitë, vërehej edhe nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, një njohje shumë e mirë e fushës specifike për profilin e studimit doktoral, por një njohje minimale e fushës specifike të programit të studimit nën shqyrtim.</p> <p><i>[Aneks 17 Raporti Vjetor POLIS 20-21];</i> <i>[Tabela përmbledhëse BSC SHK];</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie	GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, statutin dhe rregulloren e Universitetit POLIS, si dhe aktet rregullatore specifike, po ashtu dhe përgjigjet e grupeve gjatë

<p>bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>takimeve të organizuara në institucion dhe konstaton se Universiteti POLIS siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të tij ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës. Njësitë bazë, në këtë njësi kryesore, por edhe në njësitë e tjera kryesore të Universitetit POLIS, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njëra tjetrën. Kjo duket edhe në mësimdhënie, ku disa prej lëndëve të këtij programi studimi mbulohen nga staf akademik i njësive të tjera bazë të këtij institucioni. Në mbarëvajtjen e këtij programi studimi, Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike dhe veprimtarinë shkencore. Vlerësimet e mësipërme u evidentuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se Universiteti POLIS ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private. Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet më jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja apo me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare qoftë për programe studimi të dyfishta ashtu edhe për projekte ndërkombëtare si në nivel partneri ashtu edhe në nivel organizatori.</p> <p><i>[Aneks 32 Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit];</i> <i>[Aneks 34 Marrëveshje bashkëpunimi];</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ gjatë takimit në institucion nuk vuri re një analizë të mirëfilltë periodike për programin e studimit apo hartimin e raporteve analitike për të analizuar marrëveshjet e bashkëpunimit në fuqi. Megjithatë, gjatë takimit me stafin akademik dhe autoritetet udhëheqëse, vihet re se institucioni vlerëson marrëveshjet aktuale në mënyrë subjektive dhe rezultateve të pritshme teorike, por jo nëse ato janë arritur apo vështirësitë që janë hasur. Nuk ka një procedurë të mirëfilltë për analizën e marrëveshjeve dhe efektivitetin e tyre. Në dosjen e vetë vlerësimit, është paraqitur një</p>




	<p>dokument për raportin periodik në lidhje me marrëveshjet, <i>[Aneks 35 Raporti i fundit periodik mbi marrëveshjet]</i>. Ky dokument përmban një procesverbal të mbajtur për një takim të koordinatorit të programit të studimit dhe studentëve në lidhje me vështirësitë e hasur nga studentët gjatë aktiviteteve didaktike të zhvilluara online në periudhën e diktuar nga pandemia Covid-19. Pra nuk paraqitet një dokument mbi analizën e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p><i>Gjatë shqyrtimit të DVV, nga GVJ janë gjetur disa pasaktësi në emërtim të dokumentacionit dhe përmbajtjes së tij por edhe në dokumentacion që nuk i përkisnin këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Sugjerojmë që institucioni, dhe në veçanti organet përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë të organizojnë seanca trajnimi për të rritur cilësinë institucionale në lidhje me dokumentacioni që prodhohet dhe vihet në dispozicion jashtë institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Referuar dosjes së vetë vlerësimit, institucioni ka në fuqi një sërë marrëveshjesh institucionale, pjesë e të cilave prekin edhe marrëdhënie bashkëpunimi specifike për këtë program studimi. Bazuar edhe në strategjinë e zhvillimit institucional, vërehet se numri i marrëveshjeve është në rritje në tërësi.</p> <p>Bashkëpunimi për praktikat profesionale, ndiqet nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga ai i njësisë kryesore me ndihmën e Zyrë së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. Megjithatë, gjatë takimit me përfaqësues të Zyrë së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, u vu re, se për këtë program studimi, duke patur parasysh se është një program i ri i ofruar nga institucioni, kjo zyrë nuk ka dhënë ndonjë kontribut të prekshëm. Në këtë kontekst, duhet patur në konsideratë që ky program studimi është i ri për institucionin dhe zhvillimi i tij ka prekur dy vite të diktuar nga kushtet e përhapjes së virusit Sars-Cov-2.</p> <p><i>[Aneks 3 Strategjia e Zhvillimit të institucionit _POLIS 2021-2026], [Shënime në vizitë]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Për këtë program studimi nuk ka akoma një brez të studentëve të diplomuar, megjithatë bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe historikun e institucionit në programet e tjera të ofruara, mendojmë se edhe për këtë program studimi do të ketë trajnime në vijim.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
<p>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite ECTS sipas legjislacionit kombëtar në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ofrohet në tre (3) vite akademike, 6 semestra, me kohë të plotë. Me një ngarkesë totale prej 180 kredite ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p><i>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</i> <i>[Tabela 10. Në RVB];</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, është niveli 6 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ai synon formimin e shprehive të veçanta në llojshmëri të gjerë në fushën e sistemeve kompjuterike, zhvillimit dhe testimit të aplikacioneve softuer, databaza, etj. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që pritet të këtë studenti në përfundim të këtij programi janë sipas nivelit 6 të KSHK (<i>Referuar RVB</i>)</p> <p>Bazuar në planin mësimor si edhe në programet e lëndëve (<i>syllabuse të paraqitura gjatë vizitës</i>), GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”</p>

	siguron formimin në fushën e sistemeve kompjuterike, sisteme të përpunimit të të dhënave, zhvillimit dhe testimit të aplikacioneve softuer. <i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike]</i>						
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë të nevojshëm për përgatitjen e specialistëve të kompletuar për tu aftësuar në vijim në drejtim të formimit më të specializuar. Për të mundësuar formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të Universitetit POLIS, Departamenti Kërkimit Shkencor, synon mbajtjen e kontakteve me tregun e punës dhe përshtatjen me kërkesat e tij. <i>[Syllabuset e lëndëve të paraqitura gjatë vizitës]</i></p>						
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të qarta të cilat pasqyrohen tek syllabuset e çdo lënde të cilat janë në përputhje me ato të programit. Përgatitja gjatë periudhës tre vjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet në nivelin e dytë të studimeve. Kërkesat e tregut të punës për specialistë që diplomohen në këtë profil janë në rritje, ndaj programi i studimit synon plotësimin e tyre me të diplomuar cilësorë. <i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike]</i></p>						
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 ku lëndët e parashikuara në planin mësimor janë të organizuara sipas kategorive (A-E) me ngarkesën në kredite përkatësisht A: 20%; B: 53%; C: 13%; D: 10% dhe E: 3%.</p> <p>Ajo që vihet re në planin mësimor, është se të gjitha lëndët/modulet parashikojnë shpërndarje të krediteve dhe ngarkesës respektive vetëm në dy tipologji të aktiviteteve formuese, përkatësisht leksione dhe seminare. Kjo shpërndarje ngarkese dhe kreditesh përkatëse nuk përputhet me format e vlerësimit referuar syllabuseve të lëndëve. Përkatësisht, referuar syllabuseve të lëndëve, vërehet se në format e vlerësimit përcaktohen një apo disa prej zërave të më poshtëm:</p> <table border="1" data-bbox="571 1809 1337 1986"> <tr> <td>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</td> <td>10% - 20%</td> </tr> <tr> <td>Ushtrimet laborator</td> <td>20% - 30%</td> </tr> <tr> <td>Detyra</td> <td>10% - 50%</td> </tr> </table>	Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10% - 20%	Ushtrimet laborator	20% - 30%	Detyra	10% - 50%
Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10% - 20%						
Ushtrimet laborator	20% - 30%						
Detyra	10% - 50%						

Testimi i ndërmjetëm	20% - 25%
Provimi final	35% - 70%

Në format e vlerësimit janë edhe detyra e kursit apo zhvillimet e laboratorëve, por as në syllabuset përkatëse dhe as në planin mësimor, nuk ka asnjë ndarje kreditesh dhe ngarkesë mësimore për këto zëra.

Pra, në planin mësimor, mungon përcaktimi i krediteve, për lëndët që e kanë të nevojshme, për aktivitetet didaktike "Laboratorë" dhe "Detyra / Projekte Kursi", pavarësisht se në vlerësimin e njohurive ato janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse.

Gjatë takimit në vizitë, u diskutua me drejtuesin e njësisë bazë, me drejtuesin e njësisë kryesore por edhe me stafin akademik për mungesën e aktiviteteve formuese si laboratorëve dhe detyrave/projekteve të kursit në këtë program studimi. Stafi akademik shpjegon se aktivitetet laboratorike realisht zhvillohen, por janë të integruara së bashku me seminarët. Pra stafi akademik zhvillon seanca laboratorike gjatë orarit të zhvillimit të seminareve. Kjo pasi seminarët e lëndëve të kategorisë B dhe C zhvillohen në laboratorë informatike. Pra studentët, orët dhe aktivitetet e parashikuara në zërin e seminareve, zhvillohen në ambiente të pajisur me kompjuter, ku zbatojnë menjëherë në Simulator apo programe kompjuterike, njohuritë e përçuara gjatë seancës së seminareve. Gjithashtu, studentët ngarkohen me projekte dhe detyra kursi, të cilat janë pjesë e vlerësimit total të lëndëve përkatëse, por një zë i tillë nuk është i pasqyruar as në syllabus dhe as në planin mësimor.

GVJ mendon se një ndarje si zë i veçantë i krediteve në formën e laboratorit dhe të projektit/detyrës së kursit do të ishte në interesin e studentëve dhe të mbarëvajtjes së procesit dhe objektivave të planit mësimor. Një ndarje e paracaktuar e krediteve të lëndës në aktivitetet e saj formuese si Leksione, Seminare, Laboratorë, projekte/detyra kursi, tregon peshën që secili zë ka në formimin e studentit. Peshë që secili prej këtyre aktiviteteve duhet të ketë në përpjesëtim të drejtë me vlerësimin e njohurive në përmbyllje të lëndës. Kjo e gjykuar edhe në lirinë akademike të pedagogut të lëndës.

Pra, nëse si shembull, një lëndë me 5 kredite ECTS, ka 1 kredit detyrë kursi, pesha e vlerësimit të detyrës duhet të jetë rreth 1/5 e vlerësimit total, pra rreth 20% duke ponderuar

	<p>kështu impenjimin e studentit për atë aktivitet në vlerësimin total të lëndës. Ndarja në kredite të mirë përcaktuara të aktiviteteve formuese të lëndëve, shërben edhe për vlerësimin e ngarkesës totale që një student duhet të mbajë për përfundimin e dijeve të lëndës përkatëse. Kujtojmë se sipas standardit të krediteve ECTS por edhe sipas VKM 41/2018, 1 kredit ECTS përkon me 25 orë studimi mesatare për studentin.</p> <p>Përcaktimi i krediteve për çdo aktivitet didaktik ndihmon jo vetëm studentin për të baraspeshuar shpërndarjen e orëve të studimit për lëndë dhe aktivitete të saj, por shërben edhe për stafin akademik mësimdhënës për të vlerësuar edhe peshën që laboratorit apo detyra/projekti duhet të kenë në vlerësimin përfundimtar. Gjithashtu, një ndarje e aktiviteteve formuese, gjithmonë, brenda lirisë akademike të stafit mësimdhënës, i lejon edhe institucionit të monitorojë dhe të ketë instrumente sasiore vlerësues të stafit në impenjimin e tij me studentët, por edhe të vlerësojë nevojën për infrastrukturë në mbështetje të programit të studimit. Pra përcaktimi i krediteve për aktivitetet laboratorike, dhe orëve përkatëse, i mundësojnë institucionit të vlerësojë në mënyrë sasiore oraret dhe mjaftueshmërinë e ambienteve laboratorike dhe kapacitetet maksimale që ato kanë për tu shfrytëzuar.</p> <p><i>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</i> <i>[Tabela 10. Në RVB];</i> <i>[Syllabuset e lëndëve të paraqitura gjatë vizitës];</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E), që kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Kategoria A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 36 ECTS (20%); – Kategoria Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: 96 ECTS (53.4%); – Kategoria C Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: 24 ECTS (13.3%); – Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 18 ECTS (10%); – Kategoria E (detyrimet përmbyllëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3.3%); <p>Për secilën lëndë, në planin mësimor dhe në syllabuset përkatëse janë të përcaktuara aktivitete formuese vetëm si</p>

	<p>Leksione dhe Seminare. Aktivitetet të tjera formuese që zhvillohen brenda lëndëve si laboratorë dhe detyra/projekte kursi, nuk janë të përcaktuara në syllabuse dhe në planin mësimor, pavarësisht se ato realisht zhvillohen.</p> <p>Kjo mungesë e përcaktimit të këtyre aktiviteteve, nuk lejon monitorimin e tyre sasiore nga ana e GVJ në lidhje me mjaftueshmërinë e tyre për përçimin e dijeve.</p> <p>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</p> <p>[Syllabuset e lëndëve të paraqitura gjatë vizitës];</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Institucioni “Universiteti POLIS” është akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.113, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 (gjashtë) vite akademike e vlefshme deri më 14.12.2023.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është hapur bazuar në Urdhër Nr. 815, datë 21.12.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe ka filluar aktivitetin akademik për vitin e parë në vitin 2019-2020.</p> <p>Ky program studimi ofrohet në njësinë bazë, “Departamenti i Kërkimit Shkencor”, pjesë e njësisë kryesore “Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim”. Bazuar në verifikimet e ASCAL të azhornuara më datë 25.06.2021 dhe në dokumentacionin e paraqitur në DVV, vërehet se numri i stafit akademik dhe formimi i tyre është në përputhje me legjislacionin në fuqi për hapjen e njësisive bazë.</p> <p>Megjithatë, gjatë shqyrtimit të kualifikimeve, gradave dhe titujve akademik për organet drejtuese, vërehet se Dekani i njësisë kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, ka vetëm gradën shkencore “Doktor”, pra i përket kategorisë “Lektor” (shih nenin 59 të ligjit 80/2015 për Kategoritë e Personelit Akademik).</p>

	<p>Zgjedhja e Dekanit nga kategoria “Lektor”, është në përputhje me <i>nenin 19</i> të Statutit të Universitetit POLIS ku sanksionohet:</p> <p>[... <i>Drejtuesi i njësisë kryesore duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë i Universitetit POLIS dhe të ketë të paktën gradën shkencore Doktor...</i>].</p> <p>Statuti i Universitetit është miratuar me Urdhër Nr, 281, datë 19.05.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Bazuar në <i>nenin 42</i> të Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, drejtuesi i njësisë kryesore (Dekani) është <i>personel akademik i kategorisë “Profesor”</i>.</p> <p>Për sa më sipër, ka një mospërputhje midis kualifikimit të drejtuesit të njësisë kryesore dhe ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, por është në përputhje me Statutin e Institucionit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>Ne si GVJ nuk jemi në gjendje të vlerësojmë përputhshmërinë ligjore të këtij kriteri. Për sa më sipër, sugjerojmë Bordin e Akreditimit të vlerësojë këtë kriter bazuar edhe në akreditimin institucional të vitit 2017 i cili është në datë më të vonshme sesa miratimi i Statutit nga ministria përgjegjëse për arsimin.</i></p> <p>[Verifikimet ASCAL më 25.06.2021 për vitin akademik 2020-2021];</p> <p>[Aneks 53. Struktura organizative e U_POLIS];</p> <p>[Aneks 19 Organigrama e stafuar];</p> <p>[Aneks 2 Statuti i Universitetit POLIS];</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, Koordinator i programit, propozohet nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohet nga dekani, është personel akademik me kohë të plotë pranë departamentit. Koordinator përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor, në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj. Institucioni, ka miratuar koordinatorët jo vetëm për këtë program studimi, por për të gjithë programet e studimit që ofron konform akteve rregullatore të brendshme institucionale.</p> <p>[Aneks 36 Vendim emërimi i koordinatorëve];</p> <p>[Aneks 54 Procesverbale të takimeve];</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e</p>	

studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ofrohet në njësinë bazë “Departamenti i Kërkimit Shkencor”. Ky departament, së bashku me njësinë bazë “Departamentin e Kërkimit të Aplikuar” dhe njësinë bazë “Qendra e Burimeve dhe Informacionit” formojnë njësinë kryesore “Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim.

Si njësia bazë, ashtu edhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, përmbushin detyrimet minimale për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik sipas dokumentacionin në DVV.

Në total, për vitin akademik 2021-2022, njësia kryesore ka në përbërjen e saj 26 anëtar efektiv, personel akademik, nga të cilët 1 me titull “Profesor”, 1 me titull “Profesor i Asociuar”, 9 me gradën shkencore “Doktor”, 15 me kualifikimin “Master i Shkencave” ku 7 prej tyre janë student të shkollave të doktoratës.

Bazuar në tabelën 7.1 (*Tabela përmbledhese BSC SHK.*), njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka angazhuar për këtë program staf akademik PAE dhe PAK në tre vitet e fundit si më poshtë:

Viti akademik	PAE	PAK	Total
2019-2020	8	2	10
2020-2021	10	7	18
2021-2022	13	8	21

Megjithatë, institucioni në plotësimin e tabelave sasiore të paraqitura në dosjen e vetë vlerësimit, kanë mos përputhje mes tyre. Në veçanti për numrin, kualifikimin dhe llojin e punësimit të stafit të angazhuar në këtë program studimi. Të dhëna që do të jepen më të detajuara në standardin IV në vijim.

Të dhënat e përmbledhura më sipër, nuk mund të përdoren në formë krahasuese mes tyre pasi ky program studimi është në ciklin e tij të parë.

Në vitin akademik 2019-2020 ka qenë aktiv vetëm viti i parë, dhe logjikisht stafi i angazhuar ka qenë në një numër më të ulët.

Në vitin akademik 2020-2021 ka qenë aktiv viti i parë dhe viti i dytë.

Për vitin aktual akademik 2021-2022 janë aktive të tre vitet akademike duke përkuar kështu edhe me stafin minimal të

	<p>kërkuar për zhvillimin e të gjithë aktiviteteve didaktike në të tre vitet për këtë program studimi.</p> <p><i>[Tabela përmbledhëse BSC SHK]</i></p> <p><i>[Aneks 19 Organigrama e stafuar]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Në përbërjen e njësisë bazë, Departamenti kërkimit shkencor, është i përfshirë edhe një personel ndihmës akademik, i cili angazhohet në mbështetjen e aktiviteteve laboratorike në funksion të këtij programi studimi. Edhe pse në planet mësimore nuk janë detajuar orët e ngarkesës laboratorike apo të projekteve, sikurse u konfirmua gjatë vizitës në institucion, ato zhvillohen së bashku me aktivitetet e seminareve dhe kur është e nevojshme, asistohen edhe nga personeli ndihmës akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3</p> <p>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor është njësi bazë përbërëse e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim. Ky departament është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Departamenti i Kërkimit Shkencor ka informacionet për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike si më poshtë:</p> <p>Të dhëna të përgjithshme programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> – rregullorja e programit, – plani mësimor; – syllabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese shqip dhe anglisht, – CV e personelit akademik. <p>Dokumentacioni i sipërcituar ruhet, arkivohet dhe menaxhohet sipas rregullave të brendshme institucionale.</p>

<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet në tre (3) vite akademike, 6 semestra, me kohë të plotë. Me një ngarkesë totale prej 180 kredite ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Programi i studimit është i organizuar në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 ku lëndët e parashikuara në planin mësimor janë të organizuara sipas kategorive (A-E) me ngarkesën në kredite përkatësisht A: 20%; B: 53%; C: 13%; D: 10% dhe E: 3%.</p> <p>Ajo që vihet re në planin mësimor, është se të gjitha lëndët/modulet parashikojnë shpërndarje të krediteve dhe ngarkesës respektive vetëm në dy tipologji të aktiviteteve formuese, përkatësisht leksione dhe seminare.</p> <p><i>Bazuar në planin mësimor, nuk ka një organizim të aktiviteteve formuese si laboratorë apo projekte/detyra kursi në këtë program studimi. Për më shumë, referohuni vlerësimit të Standardit II.1, kriteri 5, më sipër.</i></p> <p><i>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</i> <i>[Tabela 10. Në RVB];</i> <i>[Syllabuset e lëndëve të paraqitura gjatë vizitës];</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është i strukturuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 30 lëndë të ndara sipas 3 viteve :</p> <ul style="list-style-type: none"> - 11 lëndë në vitin e parë; - 10 lëndë në vitin e dytë; - 9 lëndë në vitin e tretë; <p>Në vitin e tretë është parashikuar edhe praktika profesionale me 6 kredite ECTS si dhe punimi i diplomës ose provimi i diplomës me 6 kredite ECTS. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike përmban informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Institucioni ka zbatuar një ndarje prej 12 orë/ECTS në auditor për leksionet dhe 8 orë/ECTS për seminarat. Mënyra e vlerësimit të dijeve është</p>

e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

e përcaktuar në syllabuset e secilës lëndë dhe përfshinë në përqindje të ndryshme kriteret si më poshtë:

- Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitetet didaktike;
- Pjesëmarrja dhe zhvillimi i laboratorëve;
- Projekte dhe detyra kursi;
- Testimet të ndërmjetme gjatë zhvillimit të lëndës;
- Provimi përfundimtar;

Plani mësimor buron nga kurrikula e programit të studimit dhe pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik.

Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, praktikat profesionale dhe aktivitetet përmblyëse, etj. Plani mësimor përmban të ndarë ngarkesën në orë në auditor/jashtë auditorit: Ndarja e tyre në program është si më poshtë:

Aktivitet formues	Orë në auditor	Orë jashtë auditorit
Leksione	1056	1094
Seminare	672	1378
Praktikë Profesionale	0	150
Laboratorë	0	0
Projekte kursi/detyra	0	0
Provimi formimi / punim diplome	62	88
Total	1790	2710

Ndarje e ngarkesës totale prej 4500 orësh, respektivisht në auditor 40% dhe jashtë auditorit 60% është në përputhje me VKM 41, përkatësisht neni 1, pika ç).

[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];

[Tabelat në RVB];

Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të

Studentët, në fillim të secilit semestër, informohen gjerësisht dhe pajisen me programin e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar, etj. Pedagogët e lëndëve, në orën e parë që zhvillojnë me studentët, u paraqesin atyre


<p>pranimi, transferimi dhe ekuivalentimi të studimeve.</p>	<p>syllabusin e lëndës. Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përshkruhen edhe kriteret dhe procedura e ndjekur në rast të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>[Aneks 47 Kriteret e pranimit];</i> <i>[Aneks 51.1 Kriteret e Pranimit];</i> <i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike];</i> <i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme Uni POLIS];</i> <i>[Aneks 6 Rregullore FKZH];</i> <i>[Aneks 9 Rregullore Didaktike];</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës konform VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra; - Numri i krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve (leksione dhe seminare); - Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë); - Mënyra e kontrollit të dijeve të çdo moduli; <p>Nga verifikimi i dokumentacionit, vërehet se institucioni nuk ka parashikuar shpërndarje të ngarkesës akademike në aktivitete didaktike si “laboratorë” dhe në “detyra/projekte kursi”. Megjithatë, ato janë pjesë e vlerësimit të studentit sipas syllabuseve të lëndëve. Formalisht, kjo bie në kundërshtim brenda syllabusit, i cili nuk parashikon laborator apo detyrë kursi, por studenti vlerësohet në këto aktivitete. Gjatë takimit në vizitë, u shpjegua se aktiviteti laboratorik dhe detyrat/projektet e kursit, janë pjesë e formimit të studentit dhe zhvillohen nga institucioni, por nuk janë të detajuara veçmas në planin mësimor dhe as në kredite. Format e vlerësimit të mësimnxënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatesisht, studenti vlerësohet, pjesëmarrja në frekuentim, nga detyra e kursit; nga provimi i ndërmjetëm; provimin përfundimtar, në raporte të ndryshme sipas lëndëve. Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me elementët që parashikohen në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar.</p>

	[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK]; [Tabela 10. Në RVB];			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Institucioni parashikon përmirësimin e vazhdueshëm të planeve mësimore si dhe syllabuseve të lëndëve me diskutime brenda njësisë bazë, dhe më pas ato miratohen në njësinë kryesore. Për këtë program studimi, nuk ka ndryshime në planin mësimor. Në njësinë bazë përgjegjëse, ka propozime për shtimin e lëndëve të reja në fushën e sigurisë kibernetike. Kërkesë që bazohet nga takimet e institucionit me tregun e punës. <i>Këtu sugjerojmë, që vlerësimi i kërkesave të punëdhënës specifik, të konsultohen më gjerë brenda institucionit dhe me ekspert akademik nëse është e këshillueshme zbatimi i ndryshimeve të propozuara, në çfarë niveli, viti akademik apo semestri, dhe cilat janë njohuritë paraprake që studenti duhet të ketë për të ndjekur dhe përvetësuar njohuritë e reja që propozohen. Kjo për të evituar që profili i programit të studimit të bëhet i personalizuar sipas nevojave specifike të një grupi të vogël punëdhënësish. Shih Standardin 1.3, kriteri 2, më sipër.</i> <i>[Shtojcë e kërkuar gjatë vizitës: Procedura e ndryshimit të kurrikulës];</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit paraqitet në programet e lëndëve ai realizohet me një ngarkesë mësimore, shkencore dhe praktike me 180 ECTS dhe me afat kohor tre vite akademike me kohë të plotë. Shpërndarja e ngarkesës respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me VKM nr.41, Dt. 24.01.2018, i ndryshuar duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare.

	<p>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</p> <p>[Tabela 10. Në RVB];</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, janë në fushën informatike/kompjuterike, sistemeve të përpunimit të informacionit, sigurisë së informacionit duke ju mundësuar studentëve përçimin e njohurive në përputhje me objektivat e programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademik ndjek një rrjedhë logjike të trajtimit të argumenteve dhe përçimit të njohurive tek studentët. Njohuri që aftësojnë studentin për punësimin e tij të ardhshëm por edhe për ndjekjen e një programi studimi të ciklit të dytë në këtë fushë.</p> <p>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</p> <p>[Tabela 10. Në RVB];</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë. Lëndë të caktuara, në varësi të specifikave, aplikojnë veprimtari të ndryshme në funksion të mësimdhënies duke respektuar lirinë akademike dhe njëkohësisht për të nxitur studentët të praktikohen më shumë në detyrat e kursit/projekte që zhvillojnë. Pavarësisht se këto të fundit nuk janë përcaktuar në syllabuset e lëndëve as si laboratorë dhe as si projekte/detyra kursi. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, si program i ciklit të parë, është organizuar sipas ligjit 80/2015, VKM nr. 41. dt. 24.01.2018, i ndryshuar. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në orë/kredite) është përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore. Programi i studimit përfundon me realizimin e praktikës profesionale dhe punimit të diplomës. Nga sa më sipër rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional.</p> <p>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</p> <p>[Tabela 10. Në RVB]</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Evropiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialist në fushat informatike, zhvillimin softuer, sisteme përpunimi informacioni etj. Formalisht, lëndët janë të organizuara vetëm në aktivitete formuese teorike si Leksione dhe Seminare. Nuk ka të parashikuar aktivitete praktike si Laboratorë dhe</p>

<p>përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Detyra/projekte kursi. I vetmi aktivitet praktik i parashikuar, është “Praktika Profesionale” me 6 kredite ECTS. Duke dhënë kështu një disbalancën të raportit teori/praktikë. Megjithatë, sikurse u konfirmua gjatë vizitës në institucion, gjatë zhvillimit të seminareve, studentët praktikojnë, për lëndë specifike, zhvillimin laboratorik të argumenteve të trajtuara në seminare. Nëse do të konsiderojmë si orë të zhvillimit teorik, vetëm pjesën e leksioneve, dhe të gjitha seminarët do të analizohen si zhvillime praktike, raporti është 1056 orë leksione, 672 orë seminare dhe 150 orë praktikë profesionale.</p> <p>Çka rezulton në një raport 1056/(672+150), ose afërsisht 1.3:1</p> <p><i>Megjithatë, bazuar edhe në natyrën specifike të lëndëve, kryesisht të fushës së programimit, sugjerohet të përmirësohet raporti në favor të zhvillimeve praktike.</i></p> <p>Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me profilin e zgjedhur që është Shkenca Kompjuterike. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p><i>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</i> <i>[Tabela 10. Në RVB]</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike parashikon lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike profesionale. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuritë praktike në fushën e shkencave kompjuterike gjatë periudhës së praktikës në një kompani të fushës. Pjesëmarrja e studentëve në praktikë në bashkëpunim me ndërmarrje, kompani dhe institucione që operojnë në këtë fushë, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.</p> <p><i>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</i> <i>[Aneks 32 Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit];</i> <i>[Syllabuset e lëndëve të paraqitura gjatë vizitës]</i></p>




<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të VKM nr. 41, Dt. 24.01.2018, i ndryshuar. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literatura bazë (e detyrueshme) dhe literature e rekomanduar ndihmëse, në ndonjë rast mungon viti i botimit të literaturës. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet nga drejtuesit e departamenteve të cilët monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Literatura synohet të jetë e viteve të fundit.</p> <p><i>Megjithatë, vihet re se literatura e përdorur, nuk është çdo herë e viteve të fundit, në veçanti në syllabuse paraqiten literatura të detyrueshme dhe/ose e rekomanduar jo e 5 viteve të fundit disa janë të viteve 2002, 2008, 2009 etj.</i></p> <p><i>[Syllabuset e lëndëve të paraqitura gjatë vizitës]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve.</p> <p><i>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK];</i></p> <p><i>[Tabela 10. Në RVB];</i></p> <p><i>[Syllabuset e lëndëve të paraqitura gjatë vizitës]</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike i ofron studentëve njohuri dhe dije specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë të studimeve. Njohuri që aftësojnë studentin për punësimin e tij të ardhshëm por edhe për ndjekjen e një programi studimi të ciklit të dytë në këtë fushë.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucionin afirmohet fakti që institucioni realizon anketime periodike me studentët për aktivitetet didaktike, por nuk realizon një korrelim të pyetjeve mes tyre për të identifikuar, nëse ka, problematika dhe origjinën e tyre.</p> <p>Opinionet dhe mendimet/propozimet e bashkëpunëtorëve apo partnerëve në projekte merren dhe analizohen kryesisht me takime. Nuk vihet re përdorimi i ndonjë procedure të mirë organizuar për të marrë dhe përpunuar të dhëna nga partnerë/bashkëpunëtor jashtë institucionit. Gjithashtu nuk ka një mekanizëm vlerësimi të efektivitetit të bashkëpunimeve të institucionit me palë të treta në kuadër të këtij programi studimi.</p>

	<p>Propozimet/sugjerimet e palëve të treta merren kryesisht nga takime individuale dhe subjektive. Në DVV, është paraqitur një dokument për raportin periodik në lidhje me marrëveshjet, [Aneks 35 Raporti i fundit periodik mbi marrëveshjet]. Ky dokument përmban një procesverbal të mbajtur për një takim të koordinatorit të programit të studimit dhe studentëve në lidhje me vështirësitë e hasur nga studentët gjatë aktiviteteve didaktike të zhvilluara online në periudhën e diktuar nga pandemia Covid-19. Pra nuk paraqitet një dokument mbi analizën e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>[Aneks 35 Raporti i fundit periodik mbi marrëveshjet], [shënime gjatë vizitës]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi ka eksperiencë akademike apo profesionale në fusha të lidhura ngushtësisht me objektivat e këtij programi studimi. Referuar tabelës 4 në RVB, e cila përkon me stafin akademik (PAE+PAK) të angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2021-2022, vit ku janë aktive të gjitha lëndët e këtij programi, vërehet se disa prej stafit të angazhuar në aktivitete didaktike si “Leksione”, janë me formimin Master i Shkencave.</p> <p>Bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, personeli akademik me kualifikimin “Master i Shkencave” është i kategorisë “Asistent Lektor”, dhe nuk mund të angazhohet në zhvillimin e leksioneve. Edhe pse personeli me kualifikimin “Master i Shkencave” ka eksperiencë profesionale dhe ka një qasje më të orientuar drejt tregut të punës dhe kërkesave të tij, bazuar në legjislacionin në fuqi, nuk mund të angazhohet në zhvillimin e leksioneve, por vetëm për seminare dhe laboratorë. Si GVJ, e vlerësojmë pozitive angazhimin e stafit PAK me eksperiencë në industri, dhe për këtë motiv, sugjerojmë që të formalizohen orët dhe kreditet përkatëse për</p>

aktivitete laboratorike. Aktivitete didaktike ku ky staf mund të jetë vlerë e shtuar e programit.

Konstatohet gjithashtu, se departamenti ka angazhuar edhe staf të huaj për përmbushjen e nevojave të programit, si dhe për shkëmbim eksperiencash.

Duke qenë se ky program studimi është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2019-2020, dhe në atë vit ka qenë aktiv vetëm viti i parë, për referencë përputhshmërie me kërkesat ligjore të zhvillimit të aktiviteteve didaktike së paku në 70% nga personel PAE për të gjithë ciklin e studimeve, po i referohemi vetëm vitit akademik 2021-2022 ku jepet ngarkesa për një cikël të plotë.

Referuar tabelave në RVB, në auditor zhvillohen në total 1692 orë mësimore për të tre vitet akademike. Nga këto, 456 orë janë realizuar nga staf PAK, pra 27% dhe pjesa tjetër prej 73% është realizuar nga staf PAE. Megjithatë, referuar dokumentacionit të paraqitur në DVJ, rezulton një mospërputhje e të dhënave në tabelën 2 në RVB që përmbledh stafin akademik të departamentit përgjegjës për programin e studimit, dhe referuar Aneks 19 Organigrama e stafuar, shpërndarja e stafit në njësi bazë nuk përputhet mes tyre.

Të dhëna që nuk përputhen as me gjetjet në zyrën e burimeve njerëzore ku për dy anëtar, staf akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2021-2022, të deklaruar si PAE, në dosjen përkatëse, dokumentacioni nuk ishte në përputhje me atë të stafit PAE të deklaruar nga institucioni. Në dosjen përkatëse kishte mangësi dokumentacioni dhe GVJ nuk ishte në gjendje të vlerësonte nëse ky personel akademik është PAE apo PAK. Nëse roli i tyre do të ishte PAK, atëherë ngarkesa akademike e tyre do të konsiderohej si e zhvilluar nga pedagog të jashtëm dhe raporti i mësipërm do të ndryshonte si $(456 + 120) = 576/1692$, pra 34% i realizuar nga PAK dhe 66 nga PAE. (Shih standardin I.4, kriteri 1 më sipër).

Për më shumë, nëse i referohemi ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, në Nenin 57, pika 2 citojmë:

[...Personeli i institucioneve të arsimit të lartë mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme...]

Dhe neni 41, pika 1 përshkruan:

[...Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore...]

Pra, për sa më sipër, Personel Akademik Efektiv PAE, është personeli akademik i **punësuar me kohë të plotë** (me afat të caktuar apo të pacaktuar) pranë një institucioni të arsimit të lartë.

Megjithatë, institucioni ka paraqitur të dhëna sasiore kontradiktore. Nëse i referohemi tabelës 10 në RVB që paraqet planin mësimor, dhe marrim dy lëndë të vitit të parë, përkatësisht lënda me indeks 1 dhe me index 6. Janë të dy lëndë me të njëjtën ngarkesë në auditor dhe zhvillohen me të njëjtit student. Nëse i referohemi tabelës 12.1 që paraqet planin mësimor të lidhur me personelin akademik, për vitin akademik 2019-2020, që është dhe viti i parë i hapjes së këtij programi studimi, shohim se për njëjërën lëndë, ngarkesa vetëm në këtë program studimi është 216 orë, dhe për lëndën tjetër është vetëm 60 orë, kur duhej të ishin të njëjta nëse i referohemi planit mësimor.

Kjo lloj mos përputhje, mendojmë se është një ngatërresë e institucionit në plotësimin e tabelave sasiore, duke paraqitur ngarkesën totale për pedagogun edhe në programe të tjera studimi dhe jo vetëm në këtë program.

Kjo ngatërresë vihet re edhe në tabelat vijuese për vitet pasardhëse akademike.

Ne si GVJ, me këto të dhëna sasiore, nuk jemi në gjendje të vlerësojmë raportin e ngarkesës mësimore PAE/PAK për vitet akademik 2019-2020 dhe 2020-2021, pasi tabelat 12.1 dhe 12.2 përkatëse kanë pasaktësi në paraqitje.

Tabela 12.3 e cila paraqet planin mësimor të lidhur me stafin akademik, gjithashtu ka paqartësinë e ngarkesës, por që për këtë vit akademik është saktësuar edhe në tabelën 4 në RVB, të dhëna që kanë shërbyer për hartimin e shpërndarjes statistikore të paraqitur në fillim të këtij kriteri.

Megjithatë, edhe nëse krahasojmë tabelën 12.3 që paraqet planin mësimor të lidhur me stafin akademik për vitin akademik 2021-2022, dhe tabelën 4 që paraqet ngarkesën e stafit akademik, të paraqitur në Aneks 25 për të njëjtin vit akademik, ka mospërputhje me emërtimet e stafit që është angazhuar në mësimdhënie të lëndëve specifike.

Në tabelën 12.3 paraqitet në një lëndë "X" që zhvillohet nga pedagogu "A" dhe pedagogu "B", ndërsa në tabelën 4 pedagogu "A" ka ngerkesë orë mësimore në lëndën "X" ndërsa pedagog "B" nuk ka ngarkesë mësimore në atë lëndë, edhe pse ishte paraqitur në tabelën 12.3.

[Aneks 19 Organigrama e stafuar];

	<p>[Tabelat në RVB];</p> <p>[Aneks 24 Te dhënat për personel akademik Bsc. Shk];</p> <p>[Aneks 25 Tabela me ngarkesën e stafit Bsc. Shk];</p> <p>[CV e stafit akademik];</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar në përputhje me objektin apo fokusin e modulit/lëndës që zhvillon në program. Kualifikimet e stafit dhe eksperiencia e tyre përputhen me profilin e programit.</p> <p>Kualifikimi i stafit, jo gjithmonë është i duhuri për zhvillimin e leksioneve. Nga ana e institucioni angazhohen edhe Asistent Lektor të cilët mbulojnë 100% të aktiviteteve didaktike të lëndëve (Leksione + Seminare).</p> <p>[Tabelat në RVB];</p> <p>[Aneks 24 Te dhënat për personel akademik Bsc. Shk];</p> <p>[Aneks 25 Tabela me ngarkesën e stafit Bsc. Shk];</p> <p>[CV e stafit akademik];</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>[Tabelat në RVB];</p> <p>[Aneks 24 Te dhënat për personel akademik Bsc. Shk];</p> <p>[Aneks 25 Tabela me ngarkesën e stafit Bsc. Shk];</p> <p>[CV e stafit akademik];</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktikat profesionale zhvillohen në institucionet më të cilat Universiteti POLIS ka marrëveshje të formalizuara ndërinstytucionale dhe drejtohen/mbikëqyren nga pedagogu përgjegjës i caktuar nga njësia bazë. Ndërkohë në bashkëpunim me institucionet ku do kryhet praktika, caktohet dhe personeli i duhur e i kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale në institucionin e tyre. Roli i personelit akademik është i rëndësishëm në bashkëpunimin me këto institucione. Kjo realizohet në përputhje me parashikimet në rregulloren e Universitetit POLIS, Fakultetit dhe të praktikave si dhe në procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.</p> <p>[Aneks 34 Marrëveshje bashkëpunimi]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për</p>	<p>Në planin mësimor, nuk ka të parashikuar aktivitete laboratorik, megjithatë, gjatë vizitës në institucion, na u konfirmua se aktivitetet laboratorike zhvillohen bazuar në specifikat e lëndëve. Ato ndiqen nga pedagogu i angazhuar në aktivitetin e seminareve, pasi edhe laboratorët zhvillohen gjatë seancave të seminareve. Në raste të nevojës, asistohen edhe</p>

mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

nga personel ndihmës akademik. Referuar edhe tabelave në RVB, njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 nuk ka angazhuar personel ndihmës akademik. Vetëm në vitin akademik 2021-2022, në njësinë bazë, është punësuar një personel ndihmës akademik në ndihmë të zhvillimit të aktiviteteve të këtij programi studimi.

Për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 nuk ka patur të angazhuar personel ndihmës akademik, pasi dhe numri i studenteve ka qenë më i ulët, si dhe mos të harrojmë se mësimi në këto vite është zhvilluar kryesisht online si pasojë e pandemisë

[Tabelat në RVB];

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk është	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit në dosjen e vetëvlerësimit, nuk rezultojnë që të këtë udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënëse.</p> <p>Vlen të theksohet se si rrjedhojë e kushteve të krijuara nga pandemia Sars-Cov-19, Universiteti POLIS ka reaguar duke realizuar zhvillimin e procesit mësimor në platforma interaktive online. Gjithashtu, bazuar edhe në kërkesat dhe nevojat e studentëve, kanë gërrshetur edhe zhvillimin e kombinuar të aktiviteteve didaktike, online/në auditor.</p> <p>Institucioni ka hartuar edhe një publikim me titull “<i>A critical reflection on the distant and close teaching, and learning practices in the context COVID-19 pandemic, the case of R&D institute of POLIS University</i>”</p> <p>Institucioni gjithashtu, bazuar edhe në projektet kërkimore shkencore që ka aktive, i vendos ato në funksion të aktiviteteve didaktike. Për këtë vlen të përmendet edhe “<i>IF – Innovation Factory</i>” si burim informacioni dhe zbatim praktik për studentët e këtij programi studimi. Institucioni, në funksion të rritjes së gjithëpërfshirës në përcimin e dijeve, përdor edhe orët e hapura dhe <i>workshop</i>-e si brenda institucionit ashtu edhe me partnerë nga industria.</p> <p><i>[Aneks 9 Rregullore Didaktike]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti POLIS, përfshin periodikisht studentët në vlerësime periodike e kryesisht të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pyetësorët e studentëve për lëndën dhe pedagogun që kryhen periodikisht me frekuencë semestrale, para zhvillimit të provimit përfundimtar të lëndës.</p> <p>Kontrolli periodik realizuar nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me NJBSC-n për mënyrën e zhvillimit të leksioneve duke asistuar një herë ose dy herë për çdo pedagog dhe duke diskutuar konkluzionet me pedagogët dhe studentët e grupit. Procedura përkatëse mbi ankimin e vlerësimit përcaktohet në Rregulloren e provimeve. Verifikimi i vlerësimit bëhet me komision dhe miratohet nga dekani.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të</p>	

<p>vlerësimet të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Ndryshimet në rezultatin e vlerësimit të studentit bëhet brenda afatit të miratuar të lejueshëm dhe reflektohet në notën përfundimtare si në sistem ashtu edhe në regjistër. Nga sa më sipër rezultojn që institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> <p><i>[Aneks 40 Vlerësim nga studenti për pedagogun];</i> <i>[Aneks 40.1 Formular për vlerësimin];</i> <i>[Aneks 41.1 Vlerësimi i kolegut për kolegun];</i> <i>[Aneks 41.2 Vetëvlerësim i performancës së lektorit]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se organi përgjegjës për politikat e cilësisë, është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJBSC).</p> <p>Në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit POLIS janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e NJBSC. Konkretisht hartimi i formularit të anketimit të studentëve bëhet nga NJBSC, e cila pas procesit të përpunimit statistikor nga zyra e IT –së, bën analizën e rezultateve duke evidentuar problematikat dhe rekomandimet përkatëse. Këto raporte analitike ju bëhen të njohura Dekanateve dhe Rektoratit për të marrë masa konkrete. Në përfundim të këtij procesi, masat e planifikuara për përmirësim të mëtejshme ju komunikohen personelit akademik dhe studentëve në takime me to.</p> <p><i>[Aneks 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përdorin rezultatet e vlerësimeve periodike për të njohur situatën cilësore të programit të studimit dhe për përmirësimin e mëtejshëm të tij. Institucioni është i përfshirë në projekte ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit si Erasmus+, KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse dhe shkëmbime eksperiencash.</p> <p><i>[Aneks 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2




Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni në nivel institucional ka miratuar rregullore dhe udhëzues dhe organizon trajnime të vazhdueshme për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve të parashikuara për çdo lëndë të programeve mësimore, në syllabuset, ku janë të përcaktuara të gjithë elementët. Format e mësimdhënies janë të ndara sipas aktiviteteve specifike si leksione dhe seminare. Bazuar edhe në informacionet e marra gjatë vizitës, u konfirmua se në zërin e seminareve zhvillohen edhe aktivitetet laboratorike. Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren didaktike, frekuentimi është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75% të numrit të seancave të zhvilluara, për programet e studimit Bachelor, Master Shkencor dhe programet e integruara të ciklit të dytë, si dhe jomë pak se 80% për programet e studimit Master Profesional. <i>[Aneks 9 Rregullore Didaktike]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i Universitetit POLIS përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, Gjatë situatës të krijuar prej pandemisë Sars-Cov-19, UMT-ja ofroi alternativën online të procesit mësimdhënies dhe mësimnxënies, sipas specifikave të programeve të studimit apo të lëndëve/disiplinave të planit mësimor. NJBSC-ja në bashkëpunim edhe me Koordinatorin e Programit të Studimit kanë hartuar pyetësin për matjen e kënaqësisë së studentit lidhur me alternativën online të zhvillimit të procesit mësimor rezultatet e të cilit janë objekt diskutimi dhe përmirësimi në format e mësimdhënies. Personeli akademik, sidomos ai i lëndëve bazë si Fizikë dhe Matematikë, kanë përvojë të gjatë në fushën akademike dhe aftësinë për të rritur përfshirjen e studentëve në tërësi.</p> <p><i>[Shënime në vizitë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e</p>	<p>Institucioni mbështet stafin akademik në përmirësimin e kompetencave personale duke ofruar edhe mbështetje për zhvillimin e ciklit të tretë të studimeve në bashkëpunim me universitete partnere. Departamenti i Kërkimit Shkencor mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete</p>




<p>në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe <i>workshop</i>-e me profesorë të ftuar nga universitete partnere. Angazhimi i personelit akademik me eksperiencë në industrinë e lidhur ngushtësisht me objektivat formuese të këtij programi studimi mundëson qasje në nevojat e tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në njohuritë dhe konceptet e shpjegimit duke përdorur metoda të ndryshme sipas temave specifike të parashikuara në lëndëte përkatëse. Metodatat e mësimdhënies në programin “Shkenca Kompjuterike” përfshijnë leksionet dhe seminarët. Ndërsa projektet e kursit dhe laboratorët zhvillohen në mënyrë të pavarur nga secili pedagog, pa patur një ndarje formale në orë dhe kredite. Mungesa e një ndarje specifike për këto aktivitete didaktike, e bën të vështirë monitorimin e zhvillimit të tyre cilësor dhe sasior në vite nga ana e institucionit.</p> <p>[CV e stafit të angazhuar në këtë program studimi]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe përditëson periodikisht mënyrat dhe metodat e mësimdhënies me anë të implementimit të pyetësorëve mbi Vlerësimin e Lektorit të Lëndës i cili është një nga mjetet kryesore të përdorura për kontrollin e cilësisë të mësimdhënies. Ky pyetësor mbahet në bazë semestrale. Raporti i vihet në dispozicion çdo pedagogu dhe strukturave drejtuese. Nga takimi me studentët u konstatua se ky mekanizëm kishte funksionuar në disa raste në përmirësimin e mësimdhënies në disa lëndë formuese bazë.</p> <p>[Aneks 40 Vlerësim nga studenti për pedagogun]; [Aneks 40.1 Formular për vlerësimin]; [Aneks 41.1 Vlerësimi i kolegut për kolegun]; [Aneks 41.2 Vetëvlerësim i performancës së lektorit];</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Në përgjithësi, personeli akademik në punën e përditshme gjatë procesit mësimor, synon të kalojë nga metoda tradicionale e të mësuarit në metodën e interaktivitetit në procesin mësimor duke synuar rritjen e rolit të punëve praktike, projekteve, integritit në punën shkencore të pedagogëve, punës në grup etj. Përmes këtyre transformimeve synon të nxiten dhe zhvillohen cilësi si: a) kreativiteti; b) puna në grup dhe komunikimi i ndërsjellë; c) ndërgjegjësimi dhe marrja e përgjegjësisë; ç) individualiteti; d) zhvillimin i imagjinatës krijuese dh) zhvillimi i iniciativës për të vepruar; e) Të shprehurit korrekt me shkrim dhe me gojë.</p>




	Kjo vihet re edhe në zhvillimin e aktiviteteve laboratorike brenda orëve të dedikuara për zhvillimin e seminareve të lëndëve.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në diskutim edhe me pedagogët por edhe me studentët, GVJ konstaton se mësimdhënia në Universitetin POLIS orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit dhe zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenarë të jetës reale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>GVJ konstaton se Universiteti POLIS zhvillon aktivitetin e tij në Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar.</p> <p>Godina qëndrore ka një hapësirë totale prej 5756 m². Në funksion të aktiviteteve të institucionit janë edhe 3864m² oborr dhe 1400 m² parkim nëntokësor. Nga të dhënat në RVB si dhe vizita në institucion, vihet re se aktiviteti didaktik i këtij programi studimi zhvillohet në ambiente të bollshme si për aktivitetet teorike ashtu edhe për ato praktike/laboratorike. Ambientet e brendshme janë të pastra dhe të bollshme. Gjithashtu edhe ambientet përreth godinës ku zhvillohet aktiviteti didaktik ndihmojnë në përmirësimin në tërësi të ambientit dhe frymës ku këto aktivitete zhvillohen.</p> <p>[Aneks 42. Sipërfaqet POLIS]; [Aneks 42.1 Planimetri kati 0]; [Aneks 42.2 Planimetri kati 1]; [Aneks 42.3 Planimetri kati 2]; [Aneks 42.4 Planimetri kati 3]; [Aneks 42.5 Mexamine];</p>

<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>[Aneks 42. 6 Planimetria FAB-Lab kati 00]</p> <p>GVJ nga vizita në vend në ambientet e Universitetit POLIS, konstaton se ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC, video projektor dhe me internet (<i>wireless</i>). Institucioni ka në dispozicion edhe një ambient me funksionin e bibliotekës e cila është e pajisur me literaturë fizike dhe disa poste pune (kompjuter) për të konsultuar literaturën elektronike.</p> <p><i>Megjithatë, biblioteka kishte një numër të vogël të literaturës në dispozicioni në funksion të këtij programi studimi apo në fusha të ndërlidhura me të.</i></p> <p>Në funksion të këtij programi studimi janë edhe dy laboratorë informatike të pajisur me nga 32 kompjuter desktop secili. Në këto ambiente zhvillohen seminarët e lëndëve që njëkohësisht zhvillojnë edhe praktikën laboratorike. Këto laboratorë përdoren edhe për programet e studimit me karakter profesional të cilat janë nën departamentin e Kërkimit të Aplikuar.</p> <p>[Aneks 42. Sipërfaqet POLIS]; [Aneks 42.1 Planimetri kati 0]; [Aneks 42.2 Planimetri kati 1]; [Aneks 42.3 Planimetri kati 2]; [Aneks 42.4 Planimetri kati 3]; [Aneks 42.5 Mexanine]; [Aneks 42. 6 Planimetria FAB-Lab kati 00]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Stafi akademik, edhe si rrjedhojë e situatës së krijuar nga përhapja e virusit Sars-Cov-2, kanë përdorur platformën online si Microsoft Teams, Skype, Google Clasroom, Google Meet, Etj. për të ndihmuar zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu, në funksion të procesit mësimor, aktivitetet e seminarëve për disa prej lëndëve të këtij programi studimi, zhvillohen në ambientet laboratorike ku studentët njëkohësisht praktikojnë njohuritë e përçura nga stafi akademik. <i>[Shënime në vizitë]</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe</p>	<p>Bazuar në plan programet e lëndëve të këtij programi studimi, literatura e parashikuar si e detyrueshme, pjesërisht gjendet në bibliotekën e institucionit. Literatura e përgatitur nga pedagogët e lëndëve në formë konspektesh u jepej studentëve nga vet pedagogët dhe një kopje ruhet në njësinë bazë.</p>






<p>njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Edhe pse literatura e përdorur për këtë program studimi në gjuhën shqipe, gjendet në institucion, ajo nuk është e azhurnuar me botime të pesë viteve të fundit.</p> <p>Për lëndët e formimit bazë në kategorinë e lëndëve si matematika, fizika apo kimi, që përbëjnë thellimin e njohurive bazë për studentët e këtij programi studimi, argumentet e trajtuar janë në përputhje me ato që gjenden në literaturën e rekomanduar, edhe pse nuk është e pesë viteve të fundit. Për lëndët karakterizuese të këtij programi studimi, literatura e përdorur kryesisht është në gjuhë të huaj (angleze). Përdorimi i literaturës në gjuhën angleze, sikurse u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, nuk përbën pengesë në përçimin e njohurive. Kjo edhe për faktin, se studentët e pranuar në këtë program studimi, por edhe brezat në vijim, kanë një njohje të mjaftueshme të gjuhës angleze për të kuptuar përçimin e njohurive në këtë gjuhë. Stafi akademik, gjithashtu, ndihmon edhe me shënime dhe dispensa në gjuhën shqipe për të lehtësuar kuptimin e argumenteve nga studentët.</p> <p>Angazhimi i stafit akademik të huaj në këtë program studimi, nuk ka hasur vështirësi gjuhësore në përçimin e njohurive. Megjithatë, për të lehtësuar vështirësitë e mundshme që mund të kishin studentët, institucioni ka angazhuar edhe staf akademik shqiptar që paralelisht asistojnë pedagogët e huaj.</p> <p><i>Megjithatë, për lëndë karakterizuese, sugjerojmë institucionin të përditësojë literaturën e përdorur me edicionet e reja që trajtojnë edhe ndryshimet teknologjike më të fundit në këtë sektor.</i></p> <p><i>[Lista e teksteve SHKENCA KOMPJUTERIKE_IT]</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Literatura e nevojshme për zhvillimin normal të aktivitetit mësimor gjendet në formën libri në bibliotekën e institucionit, edhe pse në edicionet jo të viteve të fundit.</p> <p>Në fillim të çdo semestri të gjithë lektorëve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme, ju kërkohet të përcaktojnë literaturën që planifikojnë të përdorin në aktivitetin didaktik. Kërkesat e tyre paraqiten në Departament dhe shërbejnë si kërkesa për pasurimin e fondit të bibliotekës. Studentët gjithashtu kanë qasje edhe në formën elektronike të materialeve të siguruara nga personeli akademik në platformën online të institucionit dhe ato të ofruara nga vet pedagogët në formë dispense apo shënime të lëndës.</p>

	<p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron pasurimin e mëtejshëm të fondit të librave në dispozicion, jo vetëm për literaturën e detyruar, por edhe për ato të avancuara në këtë fushë.</i></p> <p><i>[Lista e teksteve SHKENCA KOMPJUTERIKE_IT];</i></p> <p><i>[Shënime gjatë vizitës]</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje qasjeje në bibliotekën digjitale “U-library” të ofruar në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin. Biblioteka U-Library garanton qasje në bazën e të dhënave EBSCO. Institucioni garanton qasje edhe në librarinë digjitale JSTOR (www.jstor.org) e cila përfshin literaturë në funksion të njohurive të përçuara në këtë program studimi. Studentët mund të përdorin libraritë digjitale edhe nga ambientet e bibliotekës e cila është e pajisur me kompjuter të lidhur në internet.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti POLIS disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Sallat e leksioneve/seminareve janë të pajisura me PC, projektorë. Biblioteka dhe laboratorët e informatikës janë të pajisura PC me programet e nevojshme. Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. Studentët kanë qasje në ambientet e institucionit edhe jashtë orarit të aktiviteteve didaktike dhe mund ti shfrytëzojnë ato në funksion të projekteve apo punimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik, edhe si rrjedhojë e situatës së krijuar nga përhapja e virusit Sars-Cov-2, kanë përdorur platformën online si Microsoft Teams, Skype, Google Clasroom, Google Meet, Etj. për të ndihmuar zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka patur në përdorim platformën elektronike “ESSE3” të menaxhuar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar), dhe aktualisht ka kaluar në përdorimin e platformës “Pitagora”. Sistem që mundëson menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe në funksion të studentëve si orari mësimor, notat dhe vlerësimet e studentëve etj.</p> <p>Bazuar edhe nga opinionet e studentëve, përdorimi i platformave online të mësimdhënies janë mirëpritur nga studentët dhe gjykohej që të mund të përdoren me efikasitet përtej kushteve të diktuar nga situata e pandemisë globale.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë</p>	<p>Institucioni ka patur në përdorim sistemin “ESSE3” të ofruar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar). Aktualisht sistemi</p>





<p>sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>“ESSE3” është zëvendësuar me sistemin “Pitagora” me të njëjta funksionalitete. Në këtë sistem, studentët, pedagogët, sekretaria mësimore kanë qasje të kushtëzuar në vartësi të rolit që kanë në institucion (student, pedagog, personel administrativ etj.). Studenti ka qasje vetëm në të dhënat personale apo ato që lidhen me të (nota, të dhëna financiare etj.). Pedagogu ka qasje vetëm në listën e studentëve dhe notat e vendosura në lëndën për të cilën është angazhuar në mësimdhënie, sekretaria mësimore ka qasje në të dhënat e studentit në funksion të aktivitetit normal të saj. Të gjitha këto të dhëna përpunohen nga institucioni në përputhje me rregulloren për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.</p> <p>Megjithatë, në Dosjen e Vetvlerësimit, nuk është paraqitur një dokumentacion i mirëfilltë apo një shembull konkret të platformave elektronike të përdorura nga institucioni apo organizimin e tyre të unifikuar.</p> <p>[Aneks 46.1 Manual Perdorimi per plotesimin e pyetesorit] [Aneks 46.2 Manual pedagogu]</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Përmbyllja e studimeve realizohet me mbrojtje të punimit të diplomës. Në fillim të vitit të tretë akademik, studentet që kanë të drejtë të mbrojnë diplomë me punim diplome përzgjedhin nga temat e ofruara nga pedagogët e institucionit. Temat e propozuara nga pedagogët e institucionit janë të miratuara paraprakisht në njësinë bazë. Pas caktimit të udhëheqësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik (udhëheqësi i punimit të diplomës) janë në kontakte periodike (të paktën tre kontrole të ndërmjetme) gjatë gjithë semestrit, deri në përfundimin e punimit të diplomës.</p> <p>[Aneks 9 Rregullore Didaktike]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Struktura organizative e Universitetit POLIS është në formë hierarkike sikurse paraqitet edhe në organigramën përkatëse.</p> <p>Bazuar në organigramën e institucionit, vërejmë disa struktura që në fokus kanë promovimin dhe sigurimin e cilësisë. Ndër të cilat përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Koordinatori për Burimet Njerëzore, Kualifikim Stafit & Sigurimi i Cilësisë; – Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë; – Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë; <p>Struktura/zyra në varësi hierarkike të Rektoratit. Megjithatë Institucioni ka në organikë tre struktura që në fokus kanë promovimin e cilësisë, vërejmë se funksionimi i tyre nuk është i mjaftueshëm apo i koordinuar brenda institucionit.</p> <p>Dokumentacioni i paraqitur në dosjen e vlerësimit nuk është i plotë sipas kërkesave të ASCAL. Në DVV janë paraqitur dokumentacion që nuk shërben për vlerësimin e këtij programi studimi. Edhe në dokumentacionet e paraqitura për këtë program studimi vërehen mangësi. Për vlerësimin e disa prej kritereve dhe standardeve të cilësisë nuk janë paraqitur dokumentacione mbështetëse, apo përmbajtja e tyre nuk përkonte me emërtimin e dokumentit.</p> <p>Edhe në tabelat përmbledhëse sasiore, të cilat paraqesin angazhimin e stafit akademik në këtë program studimi, përfshirë kualifikimin e tyre, llojin e punësimit etj, ka mos rakordime të informacioneve. Edhe gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, dokumentacioni i mbajtur nuk ishte i plotë konform akteve rregullatore të brendshme të institucionit. Dosje të stafit të kontrolluar në mënyrë rastësore, paraqisnin mangësi në dokumentacion kundrejt atyre të parashikuara në rregulloren institucionale. Edhe në dokumentacionin e ruajtur në dosje, në lidhje me angazhimin akademik, u vërejt dokumentacion jo i plotë dhe i saktë. Dokumentacion në dosje që paraqet angazhimin akademik të stafit, e sigluar nga stafit akademik përkatës dhe i kontrolluar nga drejtuesi i njësisë bazë, nuk përputhje me angazhimin e lëndës sipas planit mësimor. Pasaktësi që u vërejtën dhe u vunë në dukje gjatë takimit në institucioni, ku GVJ dakordëson se këto pasaktësi janë gabime njerëzore.</p> <p><i>GVJ vlerëson se gabimet njerëzore në plotësimin e dokumentacionit sipas kritereve dhe rregulloreve institucionale mund të jenë të pranishme se është në natyrën njerëzore të jetë e gabueshme. Por është detyrë e institucionit</i></p>
---	--

	<p><i>që të garantojë instrumentet dhe zbatimin e tyre për të promovuar një frymë të vazhdueshme të bashkëpunimit të zyrave brenda institucionit në funksion të rritjes së cilësisë.</i></p> <p><i>[Aneks 38_Rap Kërkimi shkencor 2018-2019];</i></p> <p><i>[Aneks 53 Organigrama_POLIS 2021-2022]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ofrohet në Fakultetin për Kërkim dhe Zhvillim, në Departamentin e Kërkimit Shkencor. Të dy këto njësi, bazë dhe kryesore, kanë si drejtues, personel akademik me formim në fushën e Arkitekturës. Megjithëse formimi i autoriteteve drejtuese nuk është në fushën e këtij programi studimi, institucioni mbështetet në ekspert të jashtëm në hartimin e planeve mësimore apo strukturës në përgjithësi të këtij programi studimi. Vërehet një përpjekje pozitive institucionale për rritjen e stafit akademik të brendshëm me formim specifik në fusha të Shkencave Kompjuterike në funksion të rritjes së cilësisë. Pavarësisht vështirësive objektive në rekrutimin e stafit akademik të kualifikuar në këtë fushë. Gjithashtu, institucioni mundëson lëvizshmërinë e studentëve në universitetet partnere falë marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p><i>[Mobilitet e studentëve:</i> <i>http://www.universitetiPOLIS.edu.al/?q=sq/node/1974]</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në DVV nuk ka një dokumentacion për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri. Megjithatë, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me Koordinatorin për Marrëdhëniet & Projektet Ndërkombëtare, vërehet një angazhim institucional për eksperimentimin e metodave të reja apo shkëmbimit të eksperiencave me institucione të tjera arsimore dhe kërkimore/shkencore. Në veçanti, institucioni mbështet me anë të pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, rritjen e kapaciteteve mësimdhënëse dhe kërkimore institucionale. Bashkëpunimi në projekte dhe gërshetimi i njohurive nga njësi të ndryshme kryesore dhe bazë brenda institucionit, vlerësohet si pozitive nga GVJ për rritjen e cilësisë dhe metodikave në mësimdhënie dhe mësimnxënies.</p> <p><i>[Shënime gjatë vizitës]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i ri në tërësi në këtë institucion. Vërehet se ka patur një lëvizshmëri jo të vogël që nga aplikimi për çeljen e tij në ministrinë përgjegjëse për arsimin, e deri në vitin akademik</p>

ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	2021-2022, vit i cili përkon me aktivitet të plotë didaktik në të tre vitet e programit.			
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në DVV, informacioni i vënë në dispozicion është shumë i pakët për të vlerësuar në tërësi shkallën e përbushjes së kritereve cilësore për stafin e angazhuar në këtë program studimi. Megjithatë, vërehet se institucioni mbështet kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik me mbështetjen e zhvillimit të punimeve doktorale në institucione partnere. Falë edhe projekteve institucionale si koordinator apo edhe si anëtar, Universiteti Polis trajnon stafin e tij. Në veçanti, falë pjesëmarrjes në projektin DRIVE (Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo), pjesë e platformës Erasmus+ CBHE, Universiteti POLIS ka realizuar një sërë trajnimesh në institucionet partnere.</p> <p><i>[Shënime gjatë vizitës];</i> <i>[Plani mësimor në kuadër të licensimit];</i> <i>[https://driveproject-eu.com/]</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik i institucionit dhe personeli ndihmës akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin caktimin e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje për kurrikulat e plota. <i>[CV e stafit të angazhuar në këtë program studimi]</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Kryesisht metodat e përdorura nga ana institucionit ishin tradicionale, por po bëheshin përpjeke që krahas tyre të futeshin edhe metodat bashkëkohore duke vendosur studentin në qendër të mësimdhënies. Synohet që mësimdhënia të orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit e zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenarë reale të jetës.</p> <p><i>[CV e stafit të angazhuar në këtë program studimi];</i> <i>[Aneks 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>




Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërës të kontratës së shkollës dhe studentit. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton të jetë:</p> <table border="1" data-bbox="571 902 1343 1205"> <tbody> <tr> <td>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</td> <td>10% - 20%</td> </tr> <tr> <td>Ushtrimet laborator</td> <td>20% - 30%</td> </tr> <tr> <td>Detyra/Projekte</td> <td>10% - 50%</td> </tr> <tr> <td>Testimi i ndërmjetëm</td> <td>20% - 25%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final</td> <td>35% - 70%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>[Syllabuset e lëndëve të kërkuara gjatë vizitës];</i> <i>[Aneks 9 Rregullore Didaktike]</i></p>	Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10% - 20%	Ushtrimet laborator	20% - 30%	Detyra/Projekte	10% - 50%	Testimi i ndërmjetëm	20% - 25%	Provimi final	35% - 70%
Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10% - 20%										
Ushtrimet laborator	20% - 30%										
Detyra/Projekte	10% - 50%										
Testimi i ndërmjetëm	20% - 25%										
Provimi final	35% - 70%										
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret institucionale, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/lëndë me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezulton të jetë realizuar një proces i tillë. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës.</p> <p><i>[Syllabuset e lëndëve të kërkuara gjatë vizitës];</i> <i>[Shënime gjatë vizitës]</i></p>										
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore</p>	<p>Referuar Rregullores së provimeve, GVJ konstaton se testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), laboratorët,</p>										

realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse për mbrojtjen e diplomës. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zberthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve për komponentët e ndryshëm të vlerësimit është kompetencë e pedagogut përgjegjës të lëndës. <i>[Syllabuset e lëndëve të kërkuara gjatë vizitës]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. Testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Studentët testohen me teste, projekte, detyra, etj. sipas syllabusit përkatës. <i>[Syllabuset e lëndëve të kërkuara gjatë vizitës];</i> <i>[Shënime gjatë vizitës]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, nuk ka të dhëna rreth përdorimit të sistemeve elektronike për testimin apo vlerësimin e studentëve. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, dhe takimit me studentë të këtij programi studimi, vlerësohej korrektësia e stafit akademik si në mësimdhënie ashtu edhe në vlerësimin e dijeve të studentëve. <i>[Shënime gjatë vizitës]</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre	Vlerësimi përfundimtar i studentit realizohet nga komisionet e provimeve të përbëra me jo më pak se 2 pedagogë, ku njëri është titullar i lëndës. Komisionet e provimeve propozohen nga njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore (Dekani) siç

është titullari i lëndës/modulit.	parashikohet nga Rregullorja e përgjithshme e Universitetit POLIS.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Institucioni përdor disa forma të vlerësimit të njohurive sipas lirisë akademike por edhe specifike të lëndëve duke përfshirë vlerësime gjatë lëndës dhe në përfundimin e saj. Testimi i njohurive realizohet bazuar në autoritetin, kompetencën dhe mirëbesimin e stafit akademik. Megjithatë, në nivel njësie bazë, sikurse u konfirmua gjatë takimit me stafin e NJBSC, kontrolli realizohet nga koordinatori i programit të studimit. <i>[Shënime gjatë vizitës]</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregulloreve në fuqi të institucionit. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen njohuritë dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Edhe në korrigjimin e provimeve, ato shoqërohen me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe motivin e vlerësimit. <i>[Shënime gjatë vizitës]</i>
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar dhe Kodit të Etikës. <i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme]</i>
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulet kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëheshin të njohura studentëve nga sistemi ESSE3, dhe aktualisht nga sistemi "Pitagora", ose/dhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda tre


	<p>ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit ESSE3/Pitagora. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament. Gjatë vitit/semestrit, pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quiz-e, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p><i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme]</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Mbas kësaj faze, nëse studenti ka akoma pretendime rreth vlerësimit, ai ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi, u vu re se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo qartësoheshin rreth çdo paqartësie të mundshme direkt me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Studentët vunë në duke disponibilitetin e pedagogëve për sqarime dhe këshillime të studentëve. <i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme]</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Të drejtat e studentit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale të cilat kanë të përcaktuara të gjitha hallkat dhe mënyrat se si dhe kur studenti të kryej një ankesë, si shqyrtohet ajo dhe mënyra e informimit. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion nuk u vu re një praktikë konkrete pasi studentët nuk kishin patur ankesa/kërkesa që të kërkonin përshkallëzime përtej njësisë bazë. <i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Kuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë teorike në fushën Shkencave Kompjuterike si dhe përmbillet me punimin e diplomës. Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura me profesionist të fushës. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare dhe projekte. Njohuritë e përftuara në këtë program studimi i lejojnë studentit ti thellojë ato në ciklin master.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i plan-programeve të lëndëve vërehet se nuk janë parashikuar qartë orët laboratorike, të cilat sipas institucionit janë të përfshira në ngarkesën e seminareve që zhvillohen në laboratorë kompjuterik.</i></p> <p><i>[Syllabuset e lëndëve të kërkuara gjatë vizitës]</i></p> <p><i>[Shënime gjatë vizitës]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e Shkencave Kompjuterike si dhe e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, janë të parashikuara zhvillimi i lëndëve karakterizuese në shkencë Kompjuterike (kategoria B) dhe janë parashikuar gjithashtu edhe lëndë me karakter të përgjithshëm si lëndë për aftësimin në gjuhë të huaj (Anglisht), lëndë për aftësimin logjik (Metoda të Kërkimit Shkencor), aftësi menaxhuese (Sipërmarrja dhe Biznesi) etj.</p> <p><i>[Syllabuset e lëndëve të kërkuara gjatë vizitës]</i></p> <p><i>[Shënime gjatë vizitës]</i></p> <p><i>[Aneks 14 Dosja programit Bsc ShK]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit të studimit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). Përveç komunikimit të drejtpërdrejtë student-staf akademik, studentët, në përfundim të lëndës, plotësojnë edhe pyetëtorin përkatës ku vlerësojnë pedagogun e lëndës.</p> <p><i>[Shënime gjatë vizitës];</i></p> <p><i>[Aneks 40 Vlerësim nga studenti për pedagogun]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe</p>	<p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javet e fundit, pedagogët e lëndës informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e</p>

orienton studentët për implementimin e tyre.	pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe <i>workshop</i>-e, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të projekteve Erasmus+. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me IAL partnere dhe kompani që operojnë në fushën e shkencave kompjuterike, në Universitetin POLIS organizohen herë pas here orë të hapura. Gjithashtu, stafi akademik por edhe studentët e këtij programi studimi motivohen të marrin pjesë në konkurse të organizuara në nivel kombëtar në fushën e teknologjisë së informacionit. Megjithatë, në DVV, nuk janë paraqitur evidenca të orëve të hapura. Evidenca që GVJ gjeti pjesërisht në rrjetet sociale si më poshtë:</p> <p>[https://www.linkedin.com/posts/polis-university_fablab-ictawards10-albanianictawards-activity-6919544910698192896-sV1G?utm_source=linkedin_share&utm_medium=member_desktop_web]</p> <p>[https://www.linkedin.com/posts/polis-university_artificialintelligence-machinelearning-highereducation-activity-6807930722595151872-GJd3?utm_source=linkedin_share&utm_medium=member_desktop_web]</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia kryhet mbi bazën e kompetencave në mënyrë që t'u ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar kompetencat e tyre në laboratorë dhe praktikë. Orët e seminareve, për lëndët karakterizuese të këtij programi studimi realizohen në laborator të informatikës të pajisur me kompjuter desktop me parametra teknik të mjaftueshëm për zhvillimin simulimeve apo programimeve të parashikuara në lëndët e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave apo projekteve të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës. Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme përbën një ndër kompetencat e programit.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e</p>	<p>GVJ konstaton se në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, dhe në tërësi në Universitetin Polis, ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor në Universitetin POLIS aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë</p>

shkencore dhe mbështetje të studentëve.	civile. Puna me projektet kërkimore në Universitetin POLIS, ka si fokus bashkëpunimet në fushën akademike, kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit, si dhe marrjen e përvojave të reja nga institucionet partnere. Kështu studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga takimi me studentët e programit, GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat/projektet e kursit. Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka në dispozicion edhe qendrën IF – <i>Innovation Factory</i> e cila gërsheton njohuritë e fushave akademike të ndryshme të ofruara nga Universiteti Polis. Zbatimi i njohurive në fushën e Shkencave Kompjuterike në fushat e tjera ku institucioni ka një kompetencë të konsoliduar, mundëson zhvillimin e ideve inovative të zbatimit të shkencave kompjuterike. GVJ nuk evidentoi që studentë të këtij programi të kishin marrë mbështetje financiare në këtë drejtim.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në rang institucioni GVJ evidenton forma bashkëpunimi mësimdhënieje me institucione homologe vendase por edhe ndërkombëtare. Universiteti POLIS realizon mobilitete shkëmbimi me universitete të huaja. Mobilitetet e realizuara përfshijnë kryesisht shkëmbimet mes stafeve si dhe mobilitete studentësh që kanë studiuar për një periudhë afatshkurtër në universitetet e huaja partnere.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të	Bazuar në dosjen e vetë vlerësimit DVV, institucioni harton një procedurë të veçantë për diplomimin e studentëve në tërësi. Procedura është në përputhje të normave ligjore dhe të cilësisë, ajo bëhet publike dhe studentët informohen përgjatë

<p>studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>vitit të 3-të nga ana e kordinatorit të programit të studimit dhe drejtuesi i njësisë bazë.</p> <p><i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme];</i></p> <p><i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike] [Aneks 9 Rregullore Didaktike]</i></p> <p><i>[Aneks 10 Rregullore e diplomimit Bsc SHK]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti apo të një studimi me karakter përgjithësues në fushat përkatëse sipas programeve të studimit të ofruara nga Universiteti POLIS. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore e projektuese, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer studime e projektme në fushat përkatëse. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përiferata të përfundimit të çdo pike të programit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës dhe ka kryer të gjitha kontrollet në departament. Për këtë Udhëheqësi jep mendimin e tij me shkrim dhe notë, i cili përbën 20% të vlerësimit përfundimtar dhe deklaron se volumi i planifikuar i punës është kryer dhe studentit është gati për mbrojtjen e temës. Pas kësaj, Oponenti jep vlerësim me shkrim dhe notë i cili përbën 20% të vlerësimit përfundimtar. <i>[Aneks 10 Rregullore e diplomimit Bsc SHK]</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar punimi i tij. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit si dhe i vlerësimit të Udhëheqësit (20%) dhe Oponentit (20%). Vlerësimi i komisionit përbën 60% të vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi i komisionit të diplomimit, Udhëheqësit dhe Oponentit dokumentohen dhe i bashkëngjiten proces-verbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilën regjistrohet nota përfundimtare.</p> <p><i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme]</i></p>

	<i>[Aneks 10 Rregullore e diplomimit Bsc SHK]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe në udhëzuesin e punimit të diplomës, për këtë program studimi, punimi i diplomës jo domosdoshmërisht duhet të ketë punim praktik. Në rastet kur tema përfshin një fushë të tillë, departamenti mbështet realizimin e punimit praktik të temës së diplomës. Mbështetja përfshin edhe vënien në dispozicion të studentit ambientet laboratorike nëse është e nevojshme.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, origjinalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. <i>[Aneks 9 Rregullore Didaktike]</i> <i>[Aneks 10 Rregullore e diplomimit Bsc SHK]</i>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Procedura e diplomimit për studentët e këtij institucioni është e hartuar qartë në rregulloret e ndryshme që janë hartuar në nivel institucioni, njësie kryesore dhe asaj bazë. Provimi përfundimtar ose projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës. Vlerësimi bëhet në bazë të vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidatit dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të bëra nga komisioni. Nota komunikohet në prani të komisionit nga kryetari i komisionit. Në rastin e provimit përfundimtar nota del pas vlerësimit të çdo tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për fushën përkatëse. <i>[Aneks 5 Rregullore e Përgjithshme]</i> <i>[Aneks 7 Rregullore programi Bsc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Aneks 9 Rregullore Didaktike]</i> <i>[Aneks 10 Rregullore e diplomimit Bsc SHK]</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga	Në përfundim të studimeve, pasi studentin plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS zyrtar përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të

<p>ministra përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Diploma mbart elementët e përcaktuar dhe miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe lëshohet vetëm njëherë nga institucioni. Institucioni mban kopje të saj dhe studenti mund të pajisjet vetëm me vërtetime në rast humbjeje të saj. Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar kur ai e kërkon këtë gjë.</p> <p><i>[Model Diplome Shkenca Kompjuterike];</i> <i>[Suplementi i Diplomës Shkenca Kompjuterike]</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Ky material mund të jepet edhe në gjuhën angleze, fakt që ndihmon studentin kur aplikimet e tij të mëvonshme janë në institucione që zhvillojnë aktivitetin e tyre në gjuhë të ndryshme nga ajo shqipe, apo edhe kur studentit aplikon për punësim në kompani ndërkombëtare.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë. <i>[Shënime gjatë vizitës]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni mbledh dhe ruan të dhëna në mënyrë periodike për personelin akademik dhe ndihmës akademik duke përfshirë ngarkesën mësimore dhe detyrat e stafit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Po ashtu në fund të çdo viti akademik, behët planifikimi i ngarkesës mësimore dhe personelit PAE+PAK për vitin akademik pasardhës, si edhe caktohen procedurat e rekrutimit duke filluar nga shpallja e vakancave dhe kriterëve. Të dhënat për PAE dhe PAK, ngarkesa totale në semestra si edhe informacioni mbi personelin e IT si staf administrativ, ruhen në forme fizike dhe elektronike dhe depozitohen pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, u vu re se procedurat e parashikuara në aktet rregullatore të brendshme, jo gjithmonë kanë rezultuar në mbajtje të saktë të dokumentacionit. Në veçanti në zyrën e burimeve njerëzore, nga shqyrtimi rastësor i disa dosjeve të stafit akademik u vu re mangësi në dokumentacion kundrejt atyre të parashikuara në aktet rregullatore, apo dokumentacion për angazhimin akademik jo në përputhje me lëndët.</p> <p><i>[Aneks 23 Te dhënat për personel akademik njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse]</i></p> <p><i>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i></p> <p><i>[Aneks. 5 Rregullore e Përgjithshme]</i></p> <p><i>[Aneks. 43 Te dhënat mbi kualifikimin shkencor Bsc SHK]</i></p> <p><i>[Tabela përmbledhëse BSC SHK]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Universiteti POLIS, në përputhje me nevojat për staf akademik shpall vakancat dhe bën përzgjedhjen e stafit në bazë të kriterëve ligjore, ato të kualifikimit si edhe të kriterëve të cilësisë duke i dhënë një rëndësi të veçantë aspektit aplikativ. Stafit akademik i rekrutuar duhet të respektojë me rigorozitet vlerat dhe misionin e U_POLIS, rregulloret e brendshme si edhe të tregojë përgjegjshmëri dhe aftësi komunikuese.</p> <p><i>[Aneksi 44. Format i dosjes personale te stafit]</i></p> <p><i>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i></p>

	<i>[Aneks. 5 Rregullore e Përgjithshme]</i>			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Universiteti POLIS ka përpiluar një dokument për rekrutimin e stafit akademik duke cilësuar kriteret e përgjithshme dhe ato specifike duke ja vene në dispozicion edhe kandidatëve. Dokumenti është gjithëpërfshirës dhe në të përcaktohen hapat që ndiqen për rekrutim si edhe anekset përkatëse në funksion të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm. U_POLIS cilëson edhe dokumentacionin për stafin e huaj dhe kushtet përkatëse që nga periudha e provës deri tek kontrata apo largimi nga puna. <i>[Aneksi 44. Format i dosjes personale te stafit]</i> <i>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore]</i>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedurat e rekrutimit janë të detajuara duke përfshirë jo vetëm kriteret profesionale por edhe elemente të tjerë që garantojnë përzgjedhjen e personelit të përshtatshëm me ambientin akademik të institucionit. Nder kriteret e specifike janë fusha e studimit, profili si edhe eksperiencia profesionale e cila synon gërshetimin e njohurive teorike me punët praktike. Dokumentacioni ofron edhe procedurën e prezantimit të stafit te ri për ta integruar atë sa me shpejt me stafin akademik, infrastrukturën dhe me procedurat e punës. <i>[Aneksi 44. Format i dosjes personale te stafit]</i> <i>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Universiteti POLIS ofron një infrastrukturë te përshtatshme dhe mjedis komod për stafin akademik duke vene në dispozicion ambientet e punës dhe mjetet teknologjike të nevojshme për kryerjen e detyrave të personelit. Personeli midis të tjerash ka në dispozicion laboratorët dhe bibliotekën për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe asaj shkencore. Institucioni ofron programe mbështetëse për stafin për stimulimin e kualifikimit të vazhdueshëm te tij. <i>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore]</i>

	<i>[Aneks. 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Duke pasur parasysh vështirësinë e rekrutimit të stafit akademik PAE, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë investimit në personel me ane të trajnimeve apo kualifikimeve në kuadër edhe të bashkëpunimit në projektet ndërkombëtare. Universiteti synon të ofrojë edhe mundësi për regjistrimin në ciklet e mëtejshme siç janë programet e doktoratës ku një pedagoge nga stafi i programit të SHK vazhdon aktualisht studimet pranë një universiteti partner.</p> <p><i>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i></p> <p><i>[Aneks. 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</i></p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Përveç programeve të kualifikimeve lokale, universiteti shfrytëzon edhe projektet ndërkombëtare specifike për trajnime në lidhje me metodologjitë e mësimdhënies dhe përfshirjen e teknikave bashkëkohore në proceset mësimore dhe kërkimore. Trajnimet ndahen në faza për tju përshtatur me mire aspektit të kualifikimit që mund të jetë i lidhur me metodologjinë, kërkimin shkencor apo hartimin e syllabuseve.</p> <p><i>[https://driveproject-eu.com/2020/03/31/wp-2/]</i></p> <p><i>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i></p>
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Megjithë vështirësitë e njohura për angazhimin e stafit akademik në fushën e shkencave kompjuterike, universiteti ndjek strategji që synojnë rekrutimin e stafit profesionist me eksperience jo vetëm në fushën akademike teorike por edhe atë aplikative. Bashkëpunimet me kompanitë e ndryshme që operojnë në fushën e SHK, po ashtu kanë si qëllim nxitjen e aspektit praktik dhe gërshetimin me aspektin teorik. Përfshirja e koordinatorëve lehtëson koordinimin e aktiviteteve të stafit me njësitë e tjera bashkëpunuese të universitetit në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit. Gjatë vizitës, u re një përpjekje e institucionit për të rritur stafin akademik të përfshirë në këtë program studimi, rekrutimi i stafit të kualifikuar është një vështirësi reale jo vetëm e Universitetit Polis, por në përgjithësi e të gjithë institucioneve të arsimit të lartë me profile studimi të përafërta me këtë në vlerësim.</p> <p>Megjithatë, në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni për vlerësimin e kritereve sasiore dhe cilësore të angazhimit të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, vërehen pasaktësi dhe mos përputhje të të dhënave të deklaruara. Në veçanti, nëse i referohemi përkatësisht tabelave 4, 6.1, 6.2, 6.3,</p>




7.1, 12.1, 12.2, dhe 12.3 për tre vitet akademike, vërejmë të dhënat si vijon:

V. A.	Tab. 6.1		Tab. 7.1		Tab. 12.1	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
19-20						
Prof. Dr.	1	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	1	-	1	-	1	-
Dr./PhD	2	-	2	-	2	-
Msc.	4	1	4	1	4	1
Total	8	2	8	2	8	2

V. A.	Tab. 6.2		Tab. 7.1		Tab. 12.2	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
20-21						
Prof. Dr.	1	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	1	-	1	-	1	-
Dr./PhD	1	3	1	3	4	3
Msc.	7	3	7	3	7	2
Total	10	7	10	7	13	6

V. A.	Tab. 6.3		Tab. 7.1		Tab. 12.3		Tab. 4 ^(#)	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
21-22								
Prof. Dr.	1	1	1	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	1	-	1	-	1	-	1	-
Dr./PhD	3	3	3	3	6	3	4	2
Msc.	8	4	8	4	8	4	8	4
Total	13	8	13	8	16	8	14	7

(#) të dhënat e tabelës 4 në RVB janë vetëm për vitin akademik 2021-2022

Nga sa më sipër, vërejmë se këto të dhëna nuk përputhen mes tyre duke pasqyruar kështu edhe raporte të ndryshme midis stafit PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program studimi. Të dhënët e përmbledhura në tabelën 7.1 dhe të sipër përmendura, janë përdorur si referencë për hartimin e vlerësimit në standardin II.2.4 më sipër konform procedurave të miratuara nga ASCAL për hartimin e raporteve. Megjithatë, të dhënat e kësaj table, nuk përputhen me ato të analizuara për të njëjtin vit akademik në të dhënat e tjera sasiore të hartuara nga

	<p>institucioni. Gjithashtu, edhe në vlerësimin e llojit të punësimit të stafit akademik, nuk ishte e qartë nëse dy prej stafit akademik të angazhuar pranë njësisë bazë “Departamenti i Kërkimit Shkencor” për vitin akademik 2021-2022, dhe të angazhuar si staf akademik në këtë program studimi, të paraqitur si PAE, efektivisht ishin staf PAE apo PAK. Kjo pasi edhe dosja e tyre pranë zyrës së burimeve njerëzore, nuk përmbante të gjithë të dhënat si për staf PAE të parashikuar nga institucioni. Gjithashtu, kjo paqartësi vërehet edhe në dokumentacionin e paraqitur në DVV, ku stafi i paraqitur në [Aneks 19 Organigrama e stafuar] me atë të paraqitur në [Tabela 2.3 në RVB] ka mospërputhje të numrit dhe emrave të stafit të angazhuar për vitin akademik 2021-2022. Megjithatë, formimi i tyre ishte në përputhje me fushën specifike të programit të studimit.</p> <p>[Aneks. 11 Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore] [Aneks. 34 Marrëveshje bashkëpunimi]; [Tabela përmbledhëse BSC SHK]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Universiteti POLIS ka formuluar një strategji zhvillimi ku midis të tjerash i ka kushtuar një vëmendje të veçantë krijimit të ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Universiteti ofron ambiente të bollshme si klasa për zhvillimin e mësimit apo laboratorë mësimorë në përputhje edhe me natyrën praktike të programit të studimit të Shkencave Kompjuterike. Si një program i ri, grupet e studenteve janë të vogla duke u përshtatur më së mire në ambientet dhe infrastrukturën aktuale.</p> <p>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit të institucionit _POLIS 2021-2026] [Aneks 42. Sipërfaqet POLIS] [Vizita e GVJ në institucion]</p>

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni në strategjinë e zhvillimit thekson rëndësinë e digjitalizimit të ambienteve mësimore në funksion të një procesi mësimor sa më cilësor. Nga vizita e GVJ në institucion u konstatua se ambientet mësimore ishin të pajisura me projektorë, kompjutera dhe printera të cilët mundësonin zhvillimin e mësimin duke përdorur metoda bashkëkohore ndërveprimi me studentet.</p> <p><i>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit të institucionit _POLIS 2021-2026]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Duke pasur parasysh natyrën aplikative të programit të studimit të Shkencave Kompjuterike, institucioni ka pajisur ambientet me mjetet e nevojshme elektronike për tju mundësuar studenteve gërshetimin e njohurive teorike me ato praktike si edhe duke ju dhënë mundësinë të aplikojnë këto njohuri në zgjidhjen e detyrave dhe problemeve reale. Për module të veçanta janë vënë në dispozicion pajisje që i përshtaten qëllimit të modulit siç ishte rasti i lëndës së Rrjetave Kompjuterike ku studentet mund të ushtroheshin me pajisje që shërbejnë për ndërtimin dhe menaxhimin e rrjeteve.</p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion];</i></p> <p><i>[Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Universiteti POLIS ka në dispozicion të procesit mësimor dy laboratorë të Teknologjisë së Informacionit të pajisur me 60 kompjutera bashkëkohore (hardware), si edhe me programet përkatëse që i nevojiten programit të Shkencave Kompjuterike. Këta laboratorë vihen në dispozicion të studenteve edhe gjatë kohës së lire duke plotësuar nevojat e tyre. Institucioni synon rritjen e numrit të laboratorëve sipas një plani për përshtatjen me teknologjitë e reja në zhvillim.</p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Institucioni përveç kapaciteteve aktuale, ka lidhur një sere marrëveshesh me kompani që operojnë në fushën e IT me qëllim të zhvillimit të praktikave profesionale, si një ndër komponentët më të rëndësishëm në formimin praktik të studenteve. Shfrytëzimi i infrastrukturës së tyre ju jep mundësinë studenteve që të familjarizohen edhe me një ambient real të punës. Bashkëpunimi me kompanitë partnere lidhet po ashtu me mundësitë për punësim të të diplomuarve të ardhshëm.</p> <p><i>[Aneks. 34 Marrëveshje bashkëpunimi]</i></p>






	[Vizita e GVJ në institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti POLIS ofron ndaj studenteve një bibliotekë me hapësira të mjaftueshme dhe komode, me literature në formë fizike dhe elektronike. Për këtë të fundit janë vendosur në dispozicion kompjutera që lejojnë akses në librarinë elektronike dhe në Internet. Biblioteka mund të shfrytëzohet lirshëm nga studentet në baze të një rregulloreje të miratuar për menaxhimin e saj. Për një orientim sa më të mirë të studenteve, informacion mbi bibliotekën jepet edhe në websit-in e universitetin.</p> <p>[Aneks. 45 Broshura e bibliotekës] [Vizita e GVJ në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një seksion të veçantë për literaturën fizike në dispozicion të programit të Shkencave Kompjuterike. Literatura përbëhet nga libra, dispensa dhe materiale ndihmëse të shtypura sipas rekomandimeve nëpër syllabuset e lendeve. Universiteti ofron mundësi financiare për të ripërtërirë literaturën në bazë të kërkesave dhe zhvillimit të programit. Duke pasur parasysh edhe natyrën specifike të fushës, biblioteka ofron po ashtu edhe literaturë në gjuhën angleze e cila synon të plotësojë mangësitë e ripërtëritjes në kohë të literaturës përkatëse në gjuhën shqipe. Megjithatë, edhe literatura fizike në bibliotekë, pavarësisht gjuhës së botimit, jo gjithmonë është e përditësuar me edicionet e fundit, dhe jo gjithmonë këto janë pasqyruar në syllabuset e lëndëve. Institucioni duhet të garantojë përdorimin e literaturës së azhurnuar, pavarësisht nëse janë botime në gjuhën shqipe apo atë angleze, kjo duke patur parasysh edhe dinamikën dhe zhvillimet e vrullshme teknologjike në fushën e këtij programi studimi.</p> <p>[Aneks. 45 Broshura e bibliotekës]</p>

	<i>[Vizita e GVJ ne institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<p>Përveç literaturës fizike, universiteti ofron edhe libraritë elektronike online siç janë JSTOR dhe EBSCO të shoqëruara me manualet përkatëse të përdorimit. Aksesit është i lirë për të gjithë studentet dhe i disponueshëm në çdo kohë. Përdoruesit inkurajohen në përdorimin e tyre duke shfrytëzuar si avantazh ripërtëritjen e shpeshtë në përputhje me dinamikën e fushës së IT.</p> <p><i>[Aneks. 45 Broshura e bibliotekës]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion]</i></p>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	<p>Kompjuterat e vendosur në sallën e bibliotekës, lejojnë studentët të kenë qasje në libraritë online dhe të gjitha materialet në formë elektronike të vendosura në dispozicion të studenteve. Çdo kompjuter është i pajisur me software-t përkatës që mundësojnë ndërveprimin me dokumentacionin dhe shfrytëzimin e efikas të tij. Për shkakë komoditeti, studentet preferojnë të shfrytëzojnë edhe laboratorët nga ku mund të aksesohen materialet elektronike online.</p> <p><i>[Aneks. 45 Broshura e bibliotekës]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Gjatë vizitës në institucion nga takimet vërehej një tendencë për të përdorur literaturë të përditësuar për zhvillimin e aktiviteteve didaktike të parashikuara në këtë program studimi. Stafit akademik përdor materiale kryesisht në gjuhën angleze, çka edhe pse ky program është i nivelit të parë, nuk përbën vështirësi për studentët në përvetësimin e dijeve. Kjo pasi edhe natyra specifike e këtij programi studimi ka një terminologji shumë të gjerë në gjuhën angleze, sidomos në lëndë të fushës së informatikës. Megjithatë, nga analiza e plan-programeve të lëndëve, vërehej se literatura e detyruar apo ajo e rekomanduar, janë në botime dhe edicione të vjetra, jo të azhuruara në pesë vitet e fundit, dhe në tërësi, për lëndët karakterizuese, nuk ishte ajo që përdorej realisht për zhvillimin e aktiviteteve didaktike. Kjo mos përputhje e dokumentacionit bazë të çdo lënde, me atë që realisht përdoret për përçimin e dijeve, vështirëson mundësinë e një vlerësimi objektiv dhe cilësor të këtij programi studimi nga ana e GVJ.</p> <p><i>Aneks. 45 Broshura e bibliotekës]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është vendosur në shërbim të studenteve sipas orareve të përshtatshme për ta nga ora 08:00 deri në 16:30 gjate ditëve të javës, dhe nga ora 09:00 deri në 17:00 në fundjave. Hapësira dhe komoditeti i saj i përshtaten kërkesave dhe nevojave të studenteve të cilët mund të përdorin edhe pajisjet e tyre kompjuterike për qasje online në materialet e saj.</p> <p>[Aneks. 45 Broshura e bibliotekës] [Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti POLIS, ne baze edhe te strategjisë se digjitalizimit, shfrytëzon një sistem informacioni të brendshëm PITAGORA për të menaxhuar dhe administruar në mënyrë të shpejtë informacionet që lidhet me studentet e programit të Shkencave Kompjuterike. Pas regjistrimit në POLIS, çdo student pajiset me kredencialet përkatëse për të aksesuar këtë sistem përgjatë një periudhe se studimeve deri në diplomim. Sistemi shërben edhe si një ambient komunikimi me stafin akademik i cili ju vë në dispozicion studenteve materialet dhe informacionet gjate studimeve.</p> <p>[Aneks 46.2 MANUAL_PEDAGOGU] [Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi PITAGORA është një sistem që gërsheton komunikimin e centralizuar midis stafit akademik dhe ndihmës akademik, studenteve dhe personelit administrativ. Të gjitha palët e përfshira në këtë sistem kane akses në informacionin e ruajtur në të sipas roleve që ata kane. Për tu familjarizuar me sistemin, është vene në dispozicion edhe një manual përdorimi.</p> <p>[Aneks 46.2 MANUAL_PEDAGOGU]</p>

	<i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Sistemi PITAGORA është një element shumë i rëndësishëm komunikimi dhe informimi për stafin akademik dhe studentet. Këta të fundit mund të marrin informacion në kohe reale mbi stafin, vlerësimet e vazhdueshme dhe ato përfundimtare, si edhe të aksesojne materiale si syllabuset, njoftime, oraret e provimeve etj. Nëpërmjet këtij sistemi ju mundësohet aksesit edhe instancave të tjera duke përfshirë zv. dekanët, sekretarisë mësimore, zyrës së burimeve njerëzore.</p> <p><i>[Aneks 46.2 MANUAL_PEDAGOGU]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>Sistemi i menaxhimit PITAGORA pasqyron informacion që lidhet me programin Shkenca Kompjuterike. Ky sistem është i aksesueshëm edhe nga studentët, të cilët përveç të dhënave personale dhe avancimin e tyre akademik, kanë qasje edhe në të dhëna të përgjithshme të programit të studimit, si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, aktivitetet e parashikuara për secilën lëndë, orarin mësimor, etj. Staf akademik, bazuar në privilegjet e caktuara në sistemin Pitagora, ka mundësinë e nxjerrjes në kohë reale të të dhënave statistikore për mbarëvajtjen e procesit mësimor, avancimin akademik të studentëve etj. Si një sistem i integruar mundëson një sërë funksionesh që shfrytëzohen nga të gjithë përdoruesit e regjistruar në të.</p> <p><i>[Aneks 46.2 MANUAL_PEDAGOGU]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Ky sistem ndihmon në gjenerimin e raporteve të ndryshme për të monitoruar dhe analizuar aktivitete akademike si edhe për të përgatitur të dhëna të cilat ju përcillen organeve drejtuese. Këto raporte shërbejnë me pas për të vlerësuar cilësinë e proceseve mësimore si edhe për të gjeneruar të dhëna statistikore. Raportet përfshihen edhe në raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit.</p> <p><i>[Aneks 46.2 MANUAL_PEDAGOGU]</i></p> <p><i>[Aneks. 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</i></p>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e	<p>Universiteti POLIS përdor një faqe zyrtare në Internet www.universitetipolis.edu.al në të cilën publikohen informacione të ndryshme mbi programet e studimit, kampusin, inovacionin, aktivitetet akademik, kërkimin</p>


internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	shkencor etj. Informacioni jepet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe përditësohet periodikisht sipas veprimtarive. <i>[Vizita e GVJ ne institucion]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Universiteti harton një buxhet vjetor që është në përputhje me objektivat e programit të studimit, duke marrë në konsideratë kostot dhe nevojat për burimet njerëzore akademike dhe jo-akademike, infrastrukturën përfshirë atë të IT. Për të gjitha kostot e lartpërmendura parashikohen edhe burimet e financimit përveç tarifave studentore për të përmblytur me sukses ciklin e plotë të studimit. <i>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit të institucionit _POLIS 2021-2026]</i> <i>[Aneks. 4 Politika e financimit]</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Institucioni ka hartuar një plan financimi të programit të studimit për të mbuluar shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i programit. Në këtë plan financimi, midis të tjerash përfshihen pagat për stafin akademik të përfshirë në SHK, shpenzimet administrative, shpenzimet për bibliotekën fizike dhe atë dixhitale si edhe shpenzimet për infrastrukturën e laboratorëve dhe orendive të klasave. Te gjitha zërat e mësipërme janë të domosdoshëm në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit dhe plotësimit të detyrimeve të ndryshme ndaj palëve të treta. Plani financiar synon edhe përmirësimin e infrastrukturës në të ardhmen për tju përgjigjur kërkesave në rritje të cilësisë. Shpenzimet aktuale për një laborator përlllogariten deri në shumën 60 mijë Euro. <i>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit të institucionit _POLIS 2021-2026]</i> <i>[Aneks. 4 Politika e financimit] [Standardi IV.6 i RVB]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson	Universiteti POLIS, si një shoqëri që operon bazuar në legjislacionin shqiptar, përgatit pasqyra dhe auditor të dhënat

<p>dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>financiare. Mbarëvajtja e programit të studimit SHK, bëhet e mundur duke përdorur fonde shtese nga programet e tjera duke qenë se behet fjalë për një program të ri. Nisur nga trendi i regjistrimeve të reja, synohet që në një periudhë të afërt kohor të ardhurat e programit ta financojnë atë plotësisht. Për të garantuar zhvillimin normal të procesit mësimor, shfrytëzohen burime të ndryshme financimi, ku përveç tarifave të studenteve përfshihen edhe të ardhurat nga projektet dhe grantet, kurset e trajnimit dhe konferencat si edhe suficiti i programeve të tjera ekzistuese.</p> <p><i>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit te institucionit _POLIS 2021-2026]</i></p> <p><i>[Aneks. 4 Politika e financimit]</i></p> <p><i>[Standardi IV.6 i RVB]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Për programin e studimit, nuk është mbyllur ende një cikël i plotë studimi, megjithatë institucioni zbaton strategjinë e diversifikimit të burimeve të të ardhurave me qëllim të shmangies së rrezikut që vjen nga ulja e numrit të regjistrimeve. Burimet e të ardhurave koordinohen në disa drejtime kryesisht në projekte ndërkombëtare, shërbime, kualifikime, trajnime etj.</p> <p><i>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit te institucionit _POLIS 2021-2026]</i></p> <p><i>[Aneks. 4 Politika e financimit] [Standardi IV.6 i RVB]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Trendi i regjistrimeve të studenteve ka pësuar një dyfishim për çdo vit akademik duke ndikuar në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të programit të studimit. Parashikimet financiare bëhen për periudha 3 dhe 5 vjeçare duke marrë në konsiderate nevojat dhe burimet e duhura për të garantuar mbarëvajtjen e programit në të gjitha aspektet. Diversifikimi i vazhdueshëm i aktiviteteve të universitetit është një garanci më shume për qëndrueshmërinë financiare të programit.</p> <p><i>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit te institucionit _POLIS 2021-2026]</i></p> <p><i>[Aneks. 4 Politika e financimit]</i></p> <p><i>[Standardi IV.6 i RVB]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti POLIS ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen që nga kandidimi i maturanteve, në regjistrimin e studentit dhe deri në diplomim sipas legjislacionit në fuqi. Rregulloret përkatëse të institucionit përfshijnë të gjitha aspektet e detajuara të proceseve që ndiqen përgjatë gjithë ciklit të studimeve. [Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregulloret e institucionet, që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, përcaktojnë procedurat si edhe të drejtat dhe detyrimet e studenteve që nga momenti që regjistrohen në universitetin POLIS. Kandidatet dhe studentet gëzojnë të drejta dhe trajtim të barabartë në çdo aspekt, përgjatë periudhës së studimeve deri në diplomimin e tyre. [Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rregullorja e programit të studimit SHK, përcakton kriteret dhe procedurat e pranimit të studenteve si edhe përgjatë periudhës së studimit në institucion. Universiteti POLIS pranon transferime studentesh nga universitet e tjera shtetërore apo private dhe në çdo rast ndiqen në mënyrë rigorozë hapat e transferimit. Kriteret bëhen publike për të interesuarit në faqen zyrtare të institucionit. [Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike] [Aneks. 5 Rregullore e përgjithshme]
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Në përfundim të çdo viti akademik, hartohen kriteret akademike të veçanta për përzgjedhjen e studenteve që do të pranohen në vitin akademik pasardhës. Këto kriteret janë në përputhje edhe me udhëzimet që dalin për çdo vit nga ministria përgjegjëse për arsimin. [Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]

	<i>[Aneks. 47 Kriteret e pranimit]</i>			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret specifike dhe ato të përgjithshme, përshtaten sipas akteve nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në përputhje edhe me kriteret e maturës shtetërore. Midis të tjerash përcaktohen edhe procedurat dhe kuotat për regjistrimin e studenteve të huaj. <i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Aneks. 47 Kriteret e pranimit]</i>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti POLIS, përpara fillimit të vitit akademik publikon në faqen zyrtare kriteret për të gjithë të interesuarit duke i udhëzuar ata edhe për filtrat që mund të vendosen në rast të tejkalimit të kuotave. Kriteri kryesor i përzgjedhjes në raste të tilla mbetet cilësia e kandidatëve. Po ashtu edhe zyra e informimit të studenteve luan një rol të rëndësishëm në informimin e studenteve. <i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Aneks. 47 Kriteret e pranimit]</i> <i>[www.universitetipolis.edu.al]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Universiteti POLIS vë në dispozicion informacionin përkatës për procedurat që ndiqen gjatë studimeve dhe që lidhen me kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Informacioni është pasqyruar në rregulloret përkatëse por është i aksesueshem edhe nëpërmjet sistemit online PITAGORA. Edhe sekretaria mësimore dhe koordinatori i programit SHK janë po ashtu të angazhuar për informimin e studenteve mbi progresin e tyre. <i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Aneks. 9 Rregullore Didaktike]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	Për të gjithë studentet që dëshirojnë të transferohen, jepet informacion paraprak mbi njohjen e krediteve apo kualifikimeve të mëparshme të fituara si rezultat i studimeve




<p>mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>me kohe te plote apo te pjesshme në institucione arsimore të tjera. Për çdo rast zbatohet rregullorja përkatëse.</p> <p>Duke ju referuar tabelës se aneksit 27 rezultojnë regjistrimet dhe transferimet si me poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="571 275 1339 600"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar</th> <th>Mesatarja në hyrje</th> <th>Transferimet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>16</td> <td>8.49</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>34</td> <td>8.7</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>59</td> <td>8.74</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Aneks. 9 Rregullore Didaktike]</i> <i>[Aneks. 27 Te dhëna te plota për regjistrimin, diplomimin e studenteve Bsc.SHK]</i></p>	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar	Mesatarja në hyrje	Transferimet	2019-2020	16	8.49	2	2020-2021	34	8.7	-	2021-2022	59	8.74	1
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar	Mesatarja në hyrje	Transferimet														
2019-2020	16	8.49	2														
2020-2021	34	8.7	-														
2021-2022	59	8.74	1														
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, studentet informohen mbi syllabuset e lëndëve ku midis të tjerash pasqyrohen edhe mënyrat e vlerësimit të dijeve. Pedagogu i lëndës shpjegon me hollësi elementet e syllabusit dhe modulet e vlerësimit qoftë të ndërmjetëm apo përfundimtare. Për çdo modul vlerësimi përcaktohet pesha përkatëse dhe mënyra e llogaritjes së vlerësimit përfundimtar. <i>[Aneks. 9 Rregullore Didaktike]</i></p>																
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentet e vitit të tretë njihen me procedurat e diplomimit si edhe kriteret e punimit të diplomës. Në mbështetje të diplomës zhvillohet një lëndë e quajtur “Metodat e kërkimit shkencor” ku studiohen elementet me kryesore për përgatitjen e punimit të diplomës. Po ashtu është krijuar një aneks i posaçëm në rregullore i cili pasqyron modalitetet e diplomimit.</p> <p><i>[Aneks. 9 Rregullore Didaktike]</i> <i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>																
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i te interesuarve për te vazhduar studimet pranë universitetit POLIS përfshihet në strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe për këtë qëllim përdoren mjete të ndryshme informimi. Ndër to përfshihen rjetet sociale, website zyrtare, materialet informuese etj. Po ashtu institucioni ka ngritur edhe zyrën e marketimit e cila në bashkëpunim me njësitë e tjera, organizon takime të hapura me maturanet e shkollave të mesme duke i ftuar ata të njihen me programet dhe infrastrukturën e universitetit. Një mënyrë tjetër informimi</p>																

	<p>është edhe pjesëmarrja në panairët që organizohen nga drejtoritë arsimore ku një përfaqësues i programit SHK jep informacion të hollësishëm mbi elementet e programit.</p> <p><i>[Aneks 51.2 Open day]</i></p> <p><i>[Aneks 51.3 Polis@Glance]</i></p> <p><i>[Aneks 51.4 Takim Informues]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Shkëlqim	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Institucioni informon studentet ditën e parë të shkollës dhe i njeh ata me strukturën e programit dhe të universitetit. Dekani, koordinatori i programit dhe instancat e tjera bëjnë një prezantim të njësisë kryesore, kurrikules së programit dhe zyrave përkatëse që ofrojnë shërbime të ndryshme të lidhura me programin e studimit SHK. Po ashtu studentet informohen se ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problematikave që ata mund të kenë gjatë periudhës së studimeve.</p> <p><i>[Aneks. 36 Vendim emërimi i koordinatorëve]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p> <p><i>[Aneks. 31 Kodifikim programi -Guida e Studentit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Koordinatori i programit i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit, në bashkëpunim me pedagogët e lendeve ju vë në dispozicion studenteve planin mësimor me të gjitha lëndet dhe modulet duke i udhëzuar ata mbi përmbajtjen atyre lëndëve, ngarkesën mësimore si edhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Informacione jepen edhe në sistemin online ku studentet mund të shohin orarin mësimor dhe prezencat si edhe ndarjen e leksioneve, seminareve dhe praktikave.</p> <p><i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p> <p><i>[Aneks. 31 Kodifikim programi -Guida e Studentit]</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Mbas regjistrimit si studente të universitetit POLIS, ata informohen edhe mbi mundësitë që kanë për tu punësuar mbas përfundimit të studimeve. Institucioni angazhon zyrat përkatëse për orientimin e vazhdueshëm të studenteve mbi hapësirat në tregun e punës duke ofruar edhe mbështetje në formën e këshillimit të karrierës. Koordinatori i programit mban lidhje të vazhdueshme me studentet për ti sinjalizuar për çdo mundësi në tregun e punës.</p> <p><i>[Aneks. 36 Vendim emërimi i koordinatorëve]</i> <i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Me fillimin e procesit mësimor, studentet njihen me mënyrën e organizimit të tij në baze edhe të orarit mësimor. Ata po ashtu njihen me ambientet ku do të zhvillohet mësimi duke përfshirë klasat, laboratorët, sekretarinë mësimore dhe zyrat e shërbimeve. Koordinatori merr përsipër orientimin dhe informimin e hollësishëm mbi aspektet e lidhura me zbatimin e planit mësimor.</p> <p><i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Mënyra më e shpejtë për të marre informacione mbi programin e studimit dhe procesin mësimor, konsiderohet sistemi online PITAGORA i cili ofron akses në çdo kohë dhe po ashtu në distancë. Studentet mund të gjejnë aty orarin, syllabuset e lendeve, informacion mbi stafin akademik si edhe vlerësimin mbi performancën akademike.</p> <p><i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk është përmbushur</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për</p>	<p>Universiteti POLIS ruan të dhëna mbi regjistrimet e studenteve për çdo vit akademik. Po ashtu ruhen edhe të</p>




<p>numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>dhëna mbi kalueshmërinë nga njeri vit akademik në tjetrin si edhe mbi transferimet nga universitetet e tjera. Për arsye se programi SHK është aktiv prej gati tre vjetësh, nuk ka ende të diplomuar. <i>[Aneks. 27 Te dhëna te plota për regjistrimin, diplomimin e studenteve Bsc.SHK]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Mbarëvajtja e programit të studimit monitorohet vazhdimisht nga koordinatori dhe sekretaria mësimore. Kjo e fundit ruan dhe përditëson statistikat mbi numrin e studenteve që regjistrohen, ndërpresin studimet apo transferohen brenda vitit akademik.</p> <p><i>[Aneks. 27 Te dhëna te plota për regjistrimin, diplomimin e studenteve Bsc.SHK]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Universiteti ruan dhe përpunon të dhënat mbi ecurinë studenteve përgjatë zbatimit të programit mësimor në SHK. Vlerësimet nga ana e pedagoqeve shërbejnë si burime parësore për të ndjekur ecurinë deri në diplomim. Studentet po ashtu inkurajohen për të luajtur një rol aktiv gjatë periudhës së studimeve duke u bërë pjese e takimeve për zgjidhjen e problematikave që mund të kenë. <i>[Aneks. 54 Procesverbale të takimeve]</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi online mundëson një përpunim të shpejtë të rezultateve nga ku mund të nxirren përfundime mbi ecurinë e aktiviteteve të ndryshme akademike. Sistemi po ashtu mundëson gjenerimin e të dhënave statistikore në mënyrë automatike, të cilat më pas dërgohen tek personat e autorizuar që mund ti shfrytëzojnë këto të dhëna.</p> <p><i>[Aneks. 27 Te dhëna te plota për regjistrimin, diplomimin e studenteve Bsc.SHK]</i></p> <p><i>[Aneks 46.2 MANUAL_PEDAGOGU]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Universiteti POLIS ruan dhe përpunon vazhdimisht statistika që lidhen me të dhënat e përgjithshme dhe cilësinë e studenteve të regjistruar si edhe do të vazhdojë me përpilimin e statistikave të studenteve që do të diplomohen për të analizuar në këtë mënyrë ecurinë e procesit mësimor. Përsa i përket statistikave të punësimit synohet të krijohet një raport për të vlerësuar përputhshmërinë e të punësuarve me profilin e IT.</p> <p><i>[Aneks. 29 Te dhëna mbi punësimin e studenteve Bsc. ShK]</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Universiteti POLIS garanton përfshirjen e studenteve në organe vendimmarrëse në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Studentet kanë përfaqësues në senatin akademik, në NJBSC si edhe kur nevojitet, mund të jenë pjesëmarrës në komisione të përhershme.</p> <p><i>[Aneks. 2 Statuti i Universitetit POLIS]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfaqësimi i studenteve është në disa nivele ku përveç senatit akademik dhe NJBSC, institucioni ka krijuar senatin studentor si pjese e strukturës së universitetit. Ai koordinon veprimtarinë e tij me organet e tjera drejtuese dhe ka si qëllim aktivizimin e studenteve në veprimtaritë akademike dhe sociale. Programi SHK përfaqësohet nga përfaqësuesi i Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim. Opinioni i studenteve merret parasysh në raportet që përpilohen mbi ecurinë e programit duke evidentuar edhe problematikat e mundshme të shprehura nga ana e studenteve. Megjithatë, studentët, edhe pse janë të përfshirë në dhënien e mendimeve për përmirësimin e vazhdueshëm, institucioni nuk i informon ata në lidhje me raportet e përmbledhura apo mbi vendimet dhe masat e mara për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë që janë prodhim i drejtë për drejtë i anketimeve të studentëve.</p> <p><i>[Aneks. 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave</p>	<p>Institucioni aplikon një komunikim të vazhdueshëm me studentet për të marre prej tyre mendime mbi programin e studimit dhe kurrikulave të lëndeve. Për një vlerësim me të mire synohet të zhvillohet një procedure për marrjen e mendimeve nga studentet e diplomuar. Për shkak se akoma nuk ka një brez studentesh të diplomuar në programin SHK,</p>

<p>joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>procedura është lënë të zhvillohet në një periudhe të mëvonshme.</p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Ecuria e semestrit behet objekt takimi midis studenteve, koordinatorës së programit dhe përfaqësuesve nga dekanati të cilët diskutojnë nevojat që ata mund të kenë. Po ashtu në lidhje me kurrikulat, në fillim të çdo viti akademik merren në shqyrtim propozimet nga ana e studenteve të cilët harmonizojnë në kurrikula kërkesat që vijnë edhe nga tregu i punës. Me konkretisht, në kurrikulat për vitin akademik 2021-2022 janë bërë ndryshime në bazë të propozimeve të studentëve.</p> <p><i>[Aneks. 54 Procesverbale të takimeve]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Universiteti POLIS ju jep mundësinë studenteve që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me procesin e vlerësimit nga ana e stafit akademik. Bazuar ne rregulloret përkatëse, studentet kane të drejtë që të kërkojnë informacion mbi mënyrën e vlerësimit dhe ta kontestojnë ata nëse nuk janë dakord me vlerësimin. Rregullorja përcakton një procedure sipas të cilës lihet një afat për nxjerrjen e rezultateve dhe për ankimimin e tyre. Në rast të moszgjidhjes së situatës nga komisioni i vlerësimit, atëherë përfshihen edhe dekani si autoritet drejtues me të drejte ngritjen e një komisioni tjetër të ndryshëm nga i pari, i cili jep në mënyrë te pavarur vlerësimin përfundimtar.</p> <p><i>[Aneks. 7 Rregullore programi BSc. Shkenca Kompjuterike]</i> <i>[Aneks. 9 Rregullore Didaktike]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------




<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Universiteti POLIS ka ngritur një zyrë të posaçme të quajtur Zyra e Mbështetjes së Studenteve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) e cila ka si qëllim informimin dhe mbështetjen e studenteve përgjatë periudhës së studimeve. Po ashtu, ndër funksionet e kësaj zyre janë këshillimi mbi praktikat profesionale dhe ndërmjetësim për punësim pas përfundimit të ciklit tre vjeçar të studimeve.</p> <p>Institucioni, edhe pse e ka të ngritur këtë strukturë, ajo përbëhet nga staf akademik i institucionit kryesisht në fusha jo specifike të këtij programi studimi. Staf që ndër angazhimet e tjera brenda institucionit, ka edhe përgjegjësinë e kësaj strukture. Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti me përfaqësues të kësaj strukture, vihej re një njohje e ulët e specifikave të këtij programi studimi dhe zhvillimit të karrierës në këtë fushë. Megjithatë, institucioni, duke patur në konsideratë edhe faktin se ky program studimi është i ri, ka përdorur si mundësi këshillimi karriere marrëdhëniet që ka me kompani që kanë veprimtari në fusha specifike të këtij programi studimi.</p> <p><i>Gjithsesi, GVJ sugjeron që institucioni të risë numrin e bashkëpunimeve në kompani që të mundësojnë edhe rritjen e këshillimit të karrierës përtej specifikave të kompanive aktualisht të përfshira. Fusha e karrierës e specialistëve të diplomuar në këtë program studimi është shumë më e gjerë se ajo e mbuluar nga disa kompani specifike.</i></p> <p><i>[www.universitetipolis.edu.al/zmskk/]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Universiteti ka disa mekanizma për të informuar dhe ndjekur ecurinë e procesit akademik të programit të studimit SHK. Koordinator i programit ka kontakt të drejtpërdrejtë me studentet duke ndjekur ecurinë e tyre dhe duke marrë opinione të vazhdueshme përgjatë studimeve. Zyrat ndihmese po ashtu kontribuojnë me mbështetje sipas interesimit të studenteve në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studenteve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) është njësia përkatëse që mbështet dhe informon studentet përgjatë periudhës së studimeve deri në daljen e tyre në tregun e punës. Kjo njësi luan rolin e ndërmjetësit duke i këshilluar dhe orientuar studentet që të</p>

mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	shfrytëzojnë mundësitë në tregun në përputhje me profilin e tyre. Për të gjitha çështjet e mësipërme, ZMSKK vepron duke u bazuar mbi parimet e transparencës. [www.universitetipolis.edu.al/zmskk/] [Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Mbështetjes së Studenteve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) do të kujdeset po ashtu edhe për të mbajtur kontakte të vazhdueshme pas diplomimit, duke krijuar një strukturë informacioni mbi punësimin e studenteve dhe karrierën në vazhdim. Ky funksion do të aplikohet mbas diplomimit të brezit të parë në vitin akademik 2021-2022. Zyra do kujdeset po ashtu edhe për bashkëpunimin me shoqatën ALUMNI të programit SHK. [www.universitetipolis.edu.al/zmskk/] [Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe	Në baze të RVB dhe dokumentacionit shoqërues, Universiteti POLIS ka ngritur Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) e cila funksionon me qëllimin e monitorimit dhe koordinimit të aktiviteteve të cilat lidhen me procesin mësimor dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në programin SHK. Njësia e sigurimit të

<p>me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>cilësisë është zhvilluar ndër vite deri në vitin akademik 2012-2013 kur ajo është emërtuar NJBSC. Kjo njësi bashkërendon punën me njësitë e tjera kryesore për të përpiluar raporte vlerësimi për stafin akademik dhe pyetësorë për studentet si burime informacioni. Këto raporte ndërmjetëse shërbejnë për të hartuar një raport përfundimtar i cili i dorëzohet rektoratit duke garantuar po ashtu edhe elemente të konfidencialitetit. Në baze të raportit përfundimtar, merren edhe vendimet përkatëse të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbushjen e standardeve.</p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NJBSC funksionon si njësi e pavarur ku anëtarët e saj kanë eksperiencë të mëparshme në pozita të ndryshme. NJBSC përbëhet nga 9 anëtarë ku secili prej tyre ka detyra dhe përgjegjësi të caktuara. Po ashtu ata janë trajnuar në projekte të cilët kanë pasur si qëllim mbështetjen e proceseve të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies. Puna e saj orientohet nga strategjia e institucionit në drejtim të zbatimit të politikave dhe procedurave bashkëkohore bazuar në Standardet Kombëtare dhe Evropiane të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Megjithëse institucioni ka në funksion strukturën përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur dhe gjatë vizitës në institucion, jo gjithmonë procedurat e ndjekura kanë qenë efektive. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, u gjetën dokumentacion jo-konform akteve dhe rregulloreve institucionale. Në veçanti, në plotësimin e angazhimit akademik të stafit për këtë program studimi u evidentua plotësimi i ngarkesës me aktivitete të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në planet mësimore për atë lëndë. Në rastin konkret, në dosjen e stafit akademik paraqitej një ngarkesë në orë laboratoritk, kur lënda përkatëse nuk ka një ngarkesë të tillë. Dokumenti i kontrolluar nga drejtuesi i njësisë bazë dhe ai i njësisë kryesore.</p> <p>Në dosjet e stafit, të vlerësuara në mënyrë rastësore, kishte mangësi në plotësimin e tyre kundrejt parashikimeve të rregulloreve të brendshme institucionale. Në veçanti, mungonte marrëveshja e angazhimit akademik për stafin. Në këto dosje, nuk ishte e mundur, me përmbajtjen e tyre, të vlerësohej nëse stafi akademik ishte me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme pranë institucionit. Mungesë</p>

	<p>informacioni që nuk qartësonte llojin e angazhimit të stafit dhe sikurse është paraqitur në Standardin 1 më sipër, nuk lejon vlerësimin e saktë të raportit të ngarkesës mësimore PAE/PAK.</p> <p>Gjithashtu, edhe dokumentacioni i paraqitur në dosjen e vlerësimit të jashtëm, të dhënat sasiore nuk rakordojnë mes tyre, dhe në veçanti numri i stafit i angazhuar në këtë program studimi apo edhe përkatësia e tyre në njësi bazë.</p> <p>Tabelat sasiore, nuk rakordojnë as për stafin akademik të angazhuar në një lëndë të caktuar në një vit akademik, pasi tabelat paraqesin të dhëna kontradiktore.</p> <p>Pra, institucioni edhe pse ka të ngritur njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, mekanizmat e përdorur nuk kanë rezultuar efektive në sigurimin e një procesi të mbajtjes, administrimit dhe përpunimit të të dhënave.</p> <p><i>Si GVJ, edhe pse vlerësojmë se institucioni ka të ngritur strukturën e NJBSC, funksionimi i saj nuk është efektiv.</i></p> <p>NJBSC duhet të trajtojë stafin akademik dhe administrativ bazuar me standardet e cilësisë, mënyrën e plotësimit dhe mbajtës së dokumentacionit.</p> <p>Gjithashtu, edhe grupet e vlerësimit të brendshëm duhet të trajtohen më shumë për të patur një njohje më të mirë të standardeve të cilësisë por edhe të dokumentacionit të kërkuar nga organet ligjore të ngarkuara për vlerësimin e cilësisë jashtë institucionit si ASCAL apo ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>[Aneks. 3 Strategjia e Zhvillimit të institucionit _POLIS 2021-2026]</i></p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor _2020 2021]</i></p> <p><i>[Aneks. 8 Rregullore NJBSC]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NJBSC përdor disa praktika për mbledhje të të dhënave në kuadër të vlerësimit të brendshëm të cilësisë duke e shtrirë vlerësimin në disa drejtime si atë të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, literaturës së përdorur, teknikave të mësimdhënies dhe përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi. Po ashtu sigurimi i jashtëm i cilësisë garantohet nëpërmjet procesit të akreditimit qoftë institucional ose të programeve që universiteti POLIS ofron. Universiteti ka një bashkëpunim të suksesshëm edhe në kuadër të projekteve të cilët lidhen drejtpërdrejtë me fitimin</p>




	<p>e ekspertizave në drejtim të sigurimit të cilësisë në IAL-te në Shqipëri.</p> <p>Megjithatë, edhe pse institucioni paraqet një angazhim në rritjen në tërësi të shërbimeve të ofruara, si për studentët, stafin por edhe komunitetin, mekanizmat e përdorur për vlerësimin, monitorimin apo rritjen e cilësisë nuk kanë qenë të mjaftueshme.</p> <p>Mbledhja e të dhënave nga anketimet studentore, dhe hartimi i raporteve përkatëse, nuk është e mjaftueshme për të sigurur rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.</p> <p>Duke parë edhe përvojën e gjatë të institucionit në fushën e arsimit të lartë në drejtime të tjera akademike, dhe së fundmi edhe në atë të shkencave kompjuterike, grupi i vlerësimit të jashtëm, nuk priste të gjente mangësitë e vëna në dukje në standardet e më sipërme, dhe në veçanti në standardin 1. Mangësi që një pjesë e tyre mund të zvogëlohen duke përdorur mekanizma apo procese informuese që rrisin ndërgjegjësimin institucional dhe të stafit për standardet e cilësisë, si objekt i drejtë për drejtë të NJBSC.</p> <p><i>Ne si <u>GVJ sugjerojmë</u> institucionin që duhet të rrisë ndërgjegjësimin e brendshëm dhe mekanizmat për të garantuar një rritje të cilësisë jo vetëm akademike por edhe administrative në funksion të programit të studimit, por edhe në funksion të administrimit institucional.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>NJBSC vepron në nivel institucioni dhe veprimtaria e saj mbështetet në një rregullore të qartë. Duke e konsideruar çështjen e cilësisë si mjaft të rëndësishme, universiteti POLIS ndjek në mënyrë periodike procedura që synojnë të mbledhin të dhëna që mund të përdoren për përmirësimin e cilësisë. Procedurat e vlerësimit përfshijnë vlerësimin e stafit, proceset administrative dhe punën kërkimore duke përdorur formularë dhe raporte të ndërmjetme të reflektuara më pas edhe në ato vjetore në nivel të NJBSC dhe institucional.</p> <p>Megjithatë, fokusi i NJBSC nuk duhet të jetë vetëm mbledhja e informacionit dhe hartimi i raporteve përkatëse, por bazuar në gjetjet e tyre, duhet të jetë një aktor kryesor në rritjen e ndërgjegjësimin, informimin e vazhduar të stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ etj., për përmirësimin e vazhduar të shërbimeve në tërësi të ofruara nga institucioni.</p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p>

	[Aneks. 40 Vlerësim nga studenti për pedagogun] [Aneks. 40.1 Formular për vlerësimin] [Aneks. 38_Rap Kërkimi shkencor]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngrre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Universiteti POLIS ka ngritur njësi të posaçme të cilat monitorojnë zbatimin e programeve të studimit dhe bëjnë rishikimin e tyre në bazë të vlerësimeve nga burime të ndryshme si studentet dhe stafi akademik. Institucioni merr masa konkrete për tju përgjigjur mangësive apo nevojave për përmirësimin jo vetëm të programit të studimit por edhe të procesit mësimor në tërësi.</p> <p>Megjithatë, duke parë edhe përvojën jo shumë të lartë të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, dhe në faktin se drejtuesi i njësive bazë përgjegjës për këtë program studimi dhe ai i njësive kryesore, nuk kanë formim specifik në fushën e këtij programi, rishikimi i programeve mësimore kërkon një vëmendje të shtuar, ndoshta me ekspert të jashtëm me përvojë në këtë drejtim.</p> <p>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020/2021] [Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni ka emëruar “Koordinator të programit të studimit” për të gjitha programet e studimit që ofron. Gjatë vizitës në institucion u vu re, se koordinatori i këtij programi studimi kishte një njohje të mirë të aktiviteteve didaktike, administrative të lidhura me këtë program studimi. Programet e studimit shqyrtohen për përshtatjen e tyre me lëndet e kërkuara në tregun e punës duke angazhuar organet kolegjiale si edhe duke marre në konsiderate mendimin e studenteve. Grupet e punës së bashku me specialistë të fushës brenda apo jashtë institucionit, bëjnë propozimet përkatëse të cilat më pas miratohen nga senati akademik.</p>

	<p>Megjithëse institucioni i ka të mirë përcaktuar mekanizmat për vlerësimin e programit të studimit, në rastin e këtij programi studimi, bazuar edhe në faktin se stafi akademik më me përvojë akademike dhe administrative të angazhuar në njësinë bazë apo atë kryesore, nuk kanë formim specifik të lidhur me fushën e këtij programi studimi. Dhe në këtë aspekt, pesha më e madhe e mbikëqyrjes së programit të studimit dhe parashtrimin e nevojave për ndryshime, janë pjesë e punës së koordinatorit, i cili edhe pse me formim specifik në fusha të këtij programi studimi, ka një eksperiencë të ulët akademik dhe administrative. Rekrutimi i një stafi cilësor dhe me përvojë e me formim specifik në fusha specifike të këtij programi studimi, do të garantonte një vlerësim dhe mbikëqyrje më të mirë të ecurisë së tij.</p> <p><i>[Aneks. 54 Procesverbale të takimeve]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti POLIS përdor metodologji të ndryshme për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit SHK. Procesi i implementimit të tyre organizohet nga NJBSC e cila përpilon edhe raportet përkatëse të cilat ju dërgohen organeve të tjera si dekanatit dhe rektoratit. Metodologjia baze është ajo nëpërmjet pyetësorëve qoftë për studentet apo edhe për stafin akademik. Rezultatet finale bëhen publike duke ruajtur edhe elementet e privatësisë atje ku shihet e nevojshme.</p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p> <p><i>[Aneks. 40 Vlerësim nga studenti për pedagogun]</i></p> <p><i>[Aneks. 40.1 Formular për vlerësimin]</i></p> <p><i>[Aneks. 38_Rap Kërkimi shkencor]</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve dokumentohen nga NJBSC dhe arkivohen për ti ardhur në ndihme procesit të rishikimit apo përmirësimit të programit në një kohë të mëvonshme. Përveç kësaj ato dërgohen në forme zyrtare tek autoritetet përgjegjëse të institucionit dhe mbas miratimit nga senatit akademik ato ju dërgohen ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit bëhen objekt diskutimi nga organet përkatëse dhe në baze të tyre bëhen edhe rekomandimet përkatëse. Analiza e rezultateve të pritshme dhe atyre reale i shërben identifikimit të problematikave të mundshme si edhe zgjidhjes së tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë</p>





<p>përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>së procesit të mësimdhënies. Megjithatë, edhe pse institucioni përdor si një nga mekanizmat për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, atë të anketimit të studentëve, raportet e hartuara në tërësi, si dhe rezultatet e pritshme për përmirësimin e gjetjeve, nuk ju bëhen të ditura studentëve.</p> <p><i>Gjithashtu, nuk ka një evidencë të përdorur për adresimin e mangësive apo nevojave të evidentuara për tu përmirësuar në funksion të rritjes së cilësisë. Kjo e vërejtur edhe me gjetjet e paraqitura në këtë raport, ku një pjesë e tyre janë gabime njerëzore, por që nuk janë adresuar për tu mos u përsëritur.</i></p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p> <p><i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Institucioni zbaton vlerësimin periodik të programit SHK në fund të çdo semestri dhe me pas bën një analize vjetore mbi ecurinë e tij. NJBSC monitoron mbarëvajtjen e programit në disa drejtime dhe harton një raport të posaçëm i cili përfshihet në proceset e vlerësimit institucional apo atij të brendshëm në kuadër të akreditimeve.</p> <p><i>[Aneks. 8 Rregullore NJBSC]</i></p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës</p>	<p>Universiteti POLIS përdor metoda të ndryshme të vlerësimit duke i harmonizuar ato për të nxjerrë përfundime sa më reale në përputhje me natyrën dinamike të programit të studimit SHK. Në vlerësim përfshihen të gjitha palët që kontribuojnë në këtë program duke dhënë në këtë mënyrë informacionin më të nevojshëm për një analize sa më saktë.</p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i></p>

<p>akademike të programit të studimit.</p>	<p>[Aneks. 40 Vlerësim nga studenti për pedagogun] [Aneks. 40.1 Formular për vlerësimin] [Aneks. 38_Rap Kërkimi shkencor]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Vlerësimet kryhen në mënyrë të drejtpërdrejtë tek palët që përfshihen në zbatimin e programit si edhe nga drejtuesit. Vlerësimi i kurrikules behet në mënyrë periodike duke zbatuar aktet ligjore në fuqi nëse është i nevojshëm ndryshimi. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies behet nëpërmjet 4 komponentëve komplementare ku përfshihen; vlerësimi nga studentet, vlerësimi nga koleget, vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga drejtuesit. Secili vlerësim ka një peshë të caktuar në përqindje dhe realizohet duke respektuar konfidencialitetin kur është e nevojshme. Sistemi PITAGORA vjen po ashtu në ndihmë të procesit të vlerësimit.</p> <p>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021] [Aneks. 40 Vlerësim nga studenti për pedagogun] [Aneks. 40.1 Formular për vlerësimin] [Aneks. 38_Rap Kërkimi shkencor]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Palët që përfshihen në programin e studimit SHK, janë objekt vlerësimi nëpërmjet metodave të përmendura në Kriterin 3. Sondazhet, intervistat apo edhe diskutimet ballë për ballë përfshihen tek elementet shtesë të vlerësimit duke inkurajuar vazhdimisht përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe zbatimit të programit në tërësi. Një element i rëndësishëm do të jetë edhe mendimi i të diplomuarve në fund të vitit akademik 2021-2022 duke plotësuar në këtë mënyrë të gjithë kuadrin e vlerësimit.</p> <p>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021] [Vizita e GVJ ne institucion - Takim dhe intervista me studentët e programit të studimit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.4




Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti POLIS ka synuar të organizojë një vlerësim gjithëpërfshirës të të gjithë aktoreve të interesuar për përmirësimin e cilësisë. NJBSC koordinon procesin dhe nëpërmjet marrëdhënieve me palët përkatëse për të garantuar transparencë.</p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i> <i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim me anëtarët e NJBSC]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Palët e përfshira në programin SHK si edhe organet përkatëse kanë detyra specifike në lidhje me sigurimin e cilësisë. NJBSC kujdeset që secila prej tyre të përmbushi me sukses këto detyra duke raportuar më pas tek organet drejtuese.</p> <p>Megjithatë, edhe pse NJBSC është një strukturë e hershme e këtij institucioni, gjatë vizitës në institucion, u evidentua mbledhja e informacionit nga kjo njësi në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të cilësisë. Por nuk u vu re një përcaktim i detyrave apo objektivave konkrete për adresimin e gjetjeve apo nevojave për përmirësimin e vazhduar të shërbimeve të ofruara në kuadër të rritjes së cilësisë.</p> <p>Kjo u vu re edhe gjatë vizitës, ku një pjesë e gjetjeve jo konforme me standardet e cilësisë, mund të zvogëlohen me anë të përcaktimit të detyrave konkrete apo procesve konkrete për të rritur ndërgjegjësimin e brendshëm institucional për plotësimin e standardeve dhe kriterëve të cilësisë</p> <p>Ne si GVJ i sugjerojmë institucionit që të rrisë peshën e NJBSC-së në sigurimin e brendshëm të cilësisë sidomos në adresimin e gjetjeve që kanë nevojë për përmirësim.</p> <p><i>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</i> <i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takim me anëtarët e NJBSC]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e</p>	<p>Vlerësimi dhe siguri i cilësisë bëhet duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë njësitë përgjegjëse për zbatimin e programit dhe stafin akademik dhe administrativ. Rezultatet e vlerësimit më pas shërbejnë për të analizuar ecurinë e programit dhe për të marrë masat përkatëse në funksion të</p>

<p>personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>përmirësimin të mëtejshëm të treguesve të cilësisë. Koordinatori i programit luan një rol të rëndësishëm në bashkëveprimin me NJBSC. Nga ana procedurale, njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ndjek mekanizma të dokumentuar për mbledhjen e informacionit me qëllim hartimin e raporteve të lidhur me gjetjet.</p> <p>Nga ana procedurale, edhe njësia bazë dhe ajo kryesore janë të përfshira në hartimin dhe shqyrtimin e raporteve. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, nuk vërehet një njohje e plotë e vështirësive, nevojave për përmirësim në kuadër të këtij programi studimi. Drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore kanë një njohje të ulët të vet programit të studimit, çka ka rezultuar edhe në dokumentacione me mangësi apo jo të plota.</p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion - Takim me anëtarët e NJBSC, dekanin, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe administrativ dhe studentet]</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studenteve. Po ashtu edhe stafi i ri që rekrutohet njihet me të drejtat dhe rolin e tij në proceset e ndryshme brenda institucionit duke u bere pjesë e misionit dhe vizionit të institucionit.</p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion - Takim me anëtarët e NJBSC, dekanin, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe administrativ dhe studentet]</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Natyra dinamike e programit të studimit SHK kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm me profesioniste dhe ekspertë të fushës akademike por jo vetëm. Futja e lendeve të reja dhe eksperiencia nga aktoret e industrisë garanton një përshtatje me të mire të programit me kërkesat e tregut të punës. Leksionet e hapura nga profesioniste të ftuar shërbejnë për shkëmbim mendimesh dhe përmirësimin në vazhdimësi të kurrikulës. Megjithatë, aktorët e jashtëm, të përfshirë në këtë proces, edhe pse me eksperiencë në fushën përkatëse, paraqesin një vizion subjektiv të nevojave të tregut për orientimin formues të programit të studimit. Kjo bazuar edhe në nevojat specifike të kompanive ku ata janë të angazhuar. Opinione e aktorëve dhe ekspertëve të jashtëm, nevojitet që të ponderohen nga njësia bazë dhe ajo kryesore, bazuar në objektivat formuese të parashikuara në këtë program studimi si dhe në objektivat institucionale për zhvillimin e më tejshëm të tij.</p>

	[Aneks. 32 Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit]			
	[Aneks. 34 Marrëveshje bashkëpunimi]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	NJBSC harton raportet përkatëse të cilat ju dorëzohen organeve drejtuese të rektoratit të cilët më pas organizojnë një mbledhje të hapur me stafin akademik dhe përfaqësuesit e studenteve dhe bëjnë prezantimin e gjetjeve. Ato të dhëna që janë specifike prezantohen dhe dërgohen në forma që garantojnë konfidencialitetin dhe etikën akademike. Raportet e hartuara si dhe masat që merren për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë, nuk u bëhen të ditur studentëve, të cilët janë një nga elementët përbërëse në mbledhjen e informacionit dhe nevojave për përmirësim në këtë program studimi. [Aneks. 8 Rregullore NJBSC] [Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor 2020 2021]
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimi i të dhënave të vlerësimit bëhet konform ligjeve për të dhënat personale si edhe duke respektuar privacinë kur është e nevojshme. Gjetjet bëhen publike nëpërmjet prezantimeve apo edhe sistemit online. Institucioni respekton etikën akademike për të mos cënuar të drejtat dhe personalitetin e asnjë anëtarit të stafit. [Aneks. 8 Rregullore NJBSC] [Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor 2020 2021] [Vizita e GVJ ne institucion - Takim me stafin akademik, administrativ dhe studentet]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Rishikimi i procesit të mësimdhënies, literaturës, kurrikules dhe infrastrukturës duhet të çojë në përfundime që synojnë

	<p>përmirësimin e cilësisë dhe motivimin e të gjitha palëve në funksion të atij qëllimi.</p> <p>Megjithatë, nuk ka një evidencë për planin e masave të hartuar dhe të ndjekur për adresimin e gjetjeve të evidentuara nga NJBSC në kuadër të rritjes së cilësisë.</p> <p>[Aneks. 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJBSC siguron në vazhdim efikasitetin e procedurave të mbledhjes së informacionit dhe vlerësimit të tyre dhe i përmirëson ato sipas gjetjeve. Monitorimi i vazhdueshëm dhe organizimi i aktiviteteve tjera plotësuese në funksion të vlerësimit të cilësisë i kanë dhënë një rëndësi të veçantë veprimtarisë së NJBSC.</p> <p>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</p> <p>[Aneks. 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet NJBSC organizon veprimtari të ndryshme në formën e takimeve dhe njoftimeve duke vënë theksin tek rëndësia e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit SHK. Të gjitha palët inkurajohen të bëhen pjesë e procesit pasi dhënia e mendimeve sa më objektive ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e ofruar në nivel programi.</p> <p>Megjithëse NJBSC organizon takime ndërgjegjësimi me studentët e institucionit, raportet e hartuara prej kësaj njësie duke përmbledhur pyetësorët e plotësuar nga studentët, këtyre të fundit nuk ju paraqiten.</p> <p>[Aneks. 37 NJBSC Raport Vjetor_2020 2021]</p> <p>[Aneks. 17 Raporti Vjetor POLIS 21-22]</p> <p>[Vizitu e GVJ ne institucion - Takim me stafin akademik, administrativ dhe studentet]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Pjesëmarrje në disa projekte ndërkombëtare dhe shkëmbime stafi për avancimin akademik;
2. Vlerësimi i rregullt i institucionit në tërësi dhe stafit akademik në veçanti nga studentët për këtë program studimi;
3. Shkëmbime në rritje të studentëve dhe stafit të këtij program studimi midis universiteteve partnere;
4. Angazhimi si staf akademik, specialist me përvojë në industri në fusha specifike të programit të studimit;
5. Angazhimi i studentëve të këtij programi studimi në projekte dhe konkurse të lidhura me fushën specifike të programit të studimit;
6. Infrastruktura bashkëkohore në lidhje me laboratorët dhe pajisjet e nevojshme në funksion të zhvillimit të detyrave praktike;

b. Pika të dobta:

1. Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për këtë program studimi ka një numër të ulët të stafit akademik PAE me formim specifik në fushën e këtij programi studimi;
2. Angazhimi në zhvillimin e leksioneve staf i kategorisë "Asistent Lektor";
3. Njohje e ulët e fushës akademike specifike të këtij programi studimi dhe ndikimi i kërkesave të punëdhënësve specifik në diktimin e ndryshimeve të mundshme në planin mësimor;
4. Mungesa e aktiviteteve laboratorike të dedikuara për lëndët e këtij programi studimi;
5. Literatura e detyruar e përdorur në lëndët e këtij program studimi nuk është e azhornuar në 5 vitet e fundit;

Rekomandime:

1. Të rritet numri i stafit të brendshëm (PAE) dhe me kualifikim specifik në fushën e programit të studimit;
2. Në zhvillimin e leksioneve të angazhohet staf akademik i kategorisë "Lektor" dhe jo "Asistent Lektor";
3. Të përmirësohet njohja specifike e fushës akademike të programit të studimit duke angazhuar staf akademik me përvojë akademike për shqyrtimin e modifikimeve të mundshme në planin mësimor dhe lëndët përkatëse;
4. Të saktësohen kreditet dhe orët e punëve laboratorike sipas specifikave të lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi;
5. Të azhurnohen plan-programet e lëndëve me literaturë bashkëkohore të 5 viteve të fundit, sidomos për një program të tillë studimi;

6. Institucioni të rrisë vetëdijen në përmirësimin e brendshëm të cilësisë duke garantuar që zyrat përkatëse të mbajnë dokumentacionet e brendshme konform akteve rregullatore institucionale si dhe të jenë të kontrolluara kur vihen në dispozicion jashtë institucionit;
7. Institucioni të hartojë plane masash konkrete për reduktimin e gjetjeve dhe jo konformiteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Computer Science"

a. Strengths:


1. Participation in several international projects and staff exchanges for academic advancement;
2. Increasing student and staff exchanges of this study program between partner universities;
3. Engagement as academic staff, specialist with industry experience in specific areas of the study program;
4. Engagement of students of this study program in projects and competitions related to the specific field of the study program;
5. Modern infrastructure in relation to the laboratories and equipment necessary for the development of practical tasks;

b. Weakness:

1. The department and the faculty, responsible for this study program has a low number of effective academic staff with specific academic competencies on related subjects of this study program;
2. Some of the lectures are taught by academic staff without the required qualifications. Academic staff of the "assistant lecturer" category and not of the "lecturer" category as required;
3. Low knowledge of the specific academic field of this study program and the influence of specific employer requirements in dictating possible changes in the curriculum;
4. Lack of laboratory activities dedicated to the subjects of this study program;
5. The compulsory literature used in the subjects of this study program is not updated with editions in the last 5 years;

Recommendations:



1. To increase the number of internal staff (PAE) and with specific qualification in the field of the study program;
2. Academic staff in the "Teacher" category and not "Assistant Lecturer" should be engaged in conducting the lectures;



3. Enhance the specific knowledge of the academic field of the study program by engaging academic staff with related academic experience specific to this field as to consider possible changes in the curriculum and relevant subjects;
4. To specify the credits and relative auditor hours of laboratory work according to the specifics subjects;
5. To update the course syllabuses with contemporary literature of the last 5 years, especially for such a study program;
6. The institution should increase awareness of internal quality improvement by guaranteeing that the relevant offices keep internal documentation in accordance with institutional regulatory acts and that they are controlled when they are made available outside the institution;
7. The institution should draw up concrete plans and follow up procedures training and reducing non-conformities in the context of quality improvement;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

